

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I TRETË
DISERTACION DOKTORATURE

Teza:

**“Refleksioni i zgjedhjeve parlamentare 2016 në ndërtimin e
kapaciteteve demokratike në RM”**

Mentori:

Prof. Dr. Etem Aziri

Kandidati:

Mr. Gjylten Ademi

Tetovë - 2019

Deklarata e ndershmërisë

Unë Gjylten Ademi, studente në studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj që ky punim doktore është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

Dhjetor, 2019

Tetovë

Gjylten Ademi

Mentor

Prof. dr. Etem Aziri
Universiteti i Evropës Juglindore

Komisioni

Prof. dr. Etem Aziri
Universiteti i Evropës Juglindore

Prof. dr. Hasan Jashari
Universiteti i Evropës Juglindore

Prof. dr. Zemri Elezi
Universiteti i Evropës Juglindore

Prof. dr. Agron Rustemi
Universiteti i Evropës Juglindore

Prof. dr. Alba Dumi
Universiteti Ismail Qemali Vlorë

Abstrakt

Tema që trajtohet në këtë punim disertacioni është më se e nevojshme dhe më se sfiduese për hulumtuesit të cilët merren me fenomenin e partive politike zgjedhjeve dhe modeleve zgjedhore. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 paraqesin kthesë në jetën plurale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Zgjedhjet u organizuan pas një sërë krizash politike dhe me të drejtë mundet të konstatohet se Maqedonia kaloi nga kriza sistemore në krizë të sistemit politik. Jo rastësisht këta zgjedhje paraqisnin shpresë të madhe si për qytetaret e rëndomtë ashtu dhe për elitat intelektuale dhe ekonomike në vend. Për fat të keq këtë logjikë nuk e ndoqën elitat politike të cilat që nga fillimi i jetës plurale ngërthejnë në vete një dozë të konsiderueshme të makiavelizmit negativ.

Zgjedhjet parlamentare të viti 2016 në aspektin formal dëshmuar korrektësi drejtësi dhe plotësim të minimumit të standardëve që nënkupton demokracia bashkëkohore, megjithatë periudha pas zgjedhjeve edhe një herë e dëshmoi egoizmin e tepruar të subjekteve politike garuese.

Një risi që sollën zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 është “ prishja e një kontrate xhentëllmene në princip antidemokratike se qeveria duhet formuar sipas principit fituesi me fituesin”. Principi “fituesi me fituesin” nënkupton formimin e ekzekutivit nga partia politike maqedonase dhe partia politike shqiptare që kanë siguruar më tepër vende në parlament. Prishja e kësaj kontrate antikushtetuese dhe antidemokratike, në qoftë se respektohet në të ardhmen do të reflekton pozitivisht në demokratizimin dhe profilizimin e partive politike, sepse koalicionet qeveritare nuk do të formohen në bazë të kuantumit apo numrit të deputetëve por në bazë të performancave ideologjike të subjekteve politike.

Një risi tjetër e këtyre zgjedhjeve qëndron në atë se përherë të parë shqiptarët etnik masovikisht u përcaktuan për vlerat e të majtës maqedone që është një mundësi e mirë që në të ardhmen partitë me performanca qytetare të kenë gjasa si të barabarta të garojnë me partitë me prefiks nacional.

Momenti i tretë është copëtimi i mëtutjeshëm i trungut shqiptar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ku numri i përgjithshëm i deputetëve shqiptar të Bashkimit Demokratik për Integrim dhe partive të vogla shqiptare rezultoi si i barabartë dhjetë me dhjetë.

Megjithatë periudha pas zgjedhjeve nuk stoliset me premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore gati se në asnjë aspekt të jetës shoqërore. Republika e Maqedonisë së Veriut edhe më tutje shumë më pak investon në ndërtimin e kapaciteteve demokratike, në barazinë nacionale, në ngritjen e standardit jetësor, dhe në përmbushjen e kriterëve për tu bërë anëtare e familjes së madhe evropiane jo si imponim politik ditorë por si performancë. Nga analiza empirike e bërë në lidhje me zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 dolën mbi sipërfaqe shumë konstatime të cilat duhet realizuar në të ardhmen në qoftë se ky shtet synon perspektivat euroatlantike dhe një qëndrueshmëri afatgjate socio-ekonomike dhe politike.

Fjalë kyç: Demokracia, Zgjedhjet, Partitë politike, Zgjedhjet parlamentare, Modelet zgjedhore.

Абстракт

Темата која е третирана во оваа докторска дисертација е повеќе од потребна и поголем предизвик за научниците кои се занимаваат со феноменот на политичките партии, изборите и изборните модели.

Парламентарните избори од 2016 претставуваат прсвртна точка во плуралниот живот на Република Северна Македонија. Изборите се организирани по низата политички кризи и со право може да се констатира дека Македонија помина ос ситематска криза во криза на политичкиот систем. Не случајно овие избори претставуваа голема надеж како за обичните граѓани така и за интелектуалните и економските елити во земјата. За жал оваа логика не ја следеа политичките елити кои од почетокот на плуралниот живот содржат во себе значителна доза на негативен макиавелизам.

Парламентарните избори од 2016 од формален аспект докажаа коректност, правда и исполнување на минимум стандарди што значи минимум на современа демократија но во пост изборниот период уште еднаш се докажа прекумерната себичност на конкурентните политички субјекти.

Една новина што донесоа парламентарните избори од 2016, е раскинувањето на еден центлменски договор во принцип антидемократски според кој владата треба да се формира според принципот победникот со победникот. Принципот „победникот со победникот“ подразбира формирање на извршната власт од страна на македонска политичка партија од една страна и албанска политичка партија кои имаат освоено најмногу пратенички мандати. Раскинувањето на овој антиуставен и антидемократски договор, ако се почитува во иднина ќе се рефлектира позитивно во демократизирањето и профилирањето на политичките партии, бидејќи владеачките коалиции нема да се прават според куантумот или бројот на пратениците, туку врз основа на идеолошките перформанси на политичките партии.

Друга новост од овие избори е дека за првпат етничките Албанци масовно се изјаснија за вредностите на македонската левица која е една добра можност за иднината на партиите граѓански ориентирани да имаат еднакви можности за

натпреварување со партиите со национален префикс.

Третиот момент е понатамошната фрагментација на албанското ткиво во Република Северна Македонија каде севкупниот број на албанските пратеници од ДУИ се изедначи со севкупниот број на помалите албански политички партии кој резултираше со десет према десет.

Сепак периодот после изборите не се украси со ветувањата дадени за време на изборната кампања речиси во ниту еден сегмент на социалниот живот.

Република Северна Македонија и понатаму многу малку инвестира во градењето на демократските капацитети, во националната еднаквост, во подигнувањето на животниот стандард, и во исполнувањето на критериумите да биде член на големото европско семејство не како дневно политичко наметнување туку како перформанс. Од емпириската анализа направена во врска со Парламентарните избори од 2016, излегоа на виделина многу констатации кои треба да се исполнат во иднина ако оваа држава има намера и се стреми кон еуроатлантските перспективи и долгорочна социо економска и политичка стабилност.

Клучни зборови; Демократија, Изборите, Политичките партии, Парламентарните избори, Изборните модели

Abstract

The topic we will address in this dissertation paper is more than necessary and very challenging for researchers dealing with the phenomenon of election political parties and electoral models. The 2016 parliamentary elections of the Republic of Northern Macedonia represent a turning point in the plural life. The elections were organized after a series of political crises and it can be rightly stated that Macedonia has switched from system crisis into political system crisis. Not by chance, these elections posed great hope for both ordinary citizens and the intellectual and economic elites in the country. Unfortunately, this logic was not followed by the political elites who, since the beginning of pluralistic life, represent an extensive dose of negative Machiavellianism.

In the formal aspect the 2016 parliamentary elections proved fairness and the fulfillment of the minimum standards that modern democracy implies, nonetheless the post-election period once again proved the excessive selfishness of the rival political entities.

A novelty brought about by the 2016 parliamentary elections is "the breaking of a gentleman's contract on the anti-democratic principle that the government must be formed on a winning principle winner to winner". The "winner-to-winner" principle means the formation of the executive by the Macedonian political party and the Albanian political party that have secured the highest number of seats in parliament.

Breaking this unconstitutional and anti-democratic contract, if respected in the future, will reflect and impact positively on the democratization and profiling of political parties, as government coalitions will not be formed on the basis of quantity or number of deputies but, on the basis of the ideological performances of the entities.

Another novelty of this election is that for the first time ever, ethnic Albanians were massively committed to the values of the Macedonian left, which is a good opportunity for future civic-run parties to be likely to compete with their parties equally to those with a national prefix.

The third impetus is the further dismantling of the Albanian trunk in the Republic of Northern Macedonia where the total number of Albanian deputies of the Democratic Union for Integration and small Albanian parties turned out to be to some extent equal, ten to ten

Nevertheless, the post-election period is not decorated with the promises made during the election campaign in almost any aspect of social life. The Republic of Northern Macedonia continues to invest far less in democratic capacity-building, national equality, raising living standards, nor meeting the criteria for becoming a member of the large European family, not as a daily political imposition but as a performance.

The empirical analysis of the 2016 parliamentary elections revealed many further results supposed to be achieved in the future if this country pursues Euro-Atlantic perspectives and long-term socio-economic and political sustainability.

Key words: Democracy, Elections, Political Parties, Parliamentary Elections, Electoral Models

Përmbajte e shkurtër

Kapitulli I

Demokracia pluralo partiake si vlerë bashkëkohore

Kapitulli II

Zgjedhjet si komponentë e rëndësishme në demokratizimin e shoqërive bashkëkohore

Kapitulli III

Zgjedhjet dhe demokracia në RM analizë krahasimore (me zgjedhjet paraprake ndër vite)

Kapitulli IV

Kushtet dhe rrethanat në vigjilje të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016

Kapitulli V

Analizë ose shpalosje e rezultateve të analizës empirike me qytetarë të komunave të Pollogut

Përmbajtja

Hyrje

1. Lënda e hulumtimit
2. Qëllimi i hulumtimit
3. Hipotezat
4. Metodologjia e hulumtimit
5. Rëndësia e punimit

Kapitulli I: Demokracia pluralo partiake si vlerë bashkëkohore

1. Kuptimi i demokracisë bashkëkohore
2. Kuptimi i pluralizmit politik
3. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në shoqëritë e zhvilluara
4. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në vendet në tranzicion një vështrim kronologjik i pluralizmit politik në Republikën e Maqedonisë

Kapitulli II: Zgjedhjet si komponentë e rëndësishme në demokratizimin e shoqërive bashkëkohore

1. Kuptimi i zgjedhjeve
2. Qasja teoriko-shkencore mbi zgjedhjet
3. Zhvillimi historik i zgjedhjeve
4. Llojet e zgjedhjeve
5. Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar
6. Zgjedhjet në demokracitë e vendeve në tranzicion

Kapitulli III: Zgjedhjet dhe demokracia në RM analizë krahasimore (me zgjedhjet paraprake ndër vite)

1. Kalimi nga sistemi monist në atë pluralist
2. Zgjedhjet dhe modeli zgjedhor në fillim të jetës pluralo politike
3. Ndryshimet në kodin zgjedhor si nevojë reale në kushtet e Republikës së Maqedonisë
4. Aspekti instrumentalist dhe funksionalist i zgjedhjeve në R.M.
5. Zhvillimi i zgjedhjeve dhe proceseve zgjedhore deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016

Kapitulli IV: Kushtet dhe rrethanat në vigjilje të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016

1. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016
2. Kriza ekonomike
3. Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në prag të zgjedhjeve
4. Thellimi i krizës së gjithëmbarshme dhe nevoja për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare 2016
5. Zgjedhjet parlamentare 2016 sfidë për tejkalimin e situatës së krijuar dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtim të Republikës së Maqedonisë drejtë Bashkimit Evropian dhe strukturave të Natos.

Kapitulli V: Analizë ose shpalosje e rezultateve të analizës empirike me qytetarë të komunave të Pollogut

1. Përshkrimi i metodës hulumtuese
2. Rezultatet e hulumtimit
3. Përfundime dhe rekomandime
4. Bibliografia
5. Shtojcë

Lista e Tabelave

Tabela 1- Kronologjia e zhvillimit të zgjedhjeve në jetën pluraliste të R.M.V-së ndër vite.
(Dalja në zgjedhje)

Tabela 2- Rezultatet e zgjedhjeve të para parlamentare të vitit 1990

Tabela 3- Rezultatet e zgjedhjeve të dyta parlamentare të vitit 1994

Tabela-4 Rezultatet e zgjedhjeve të treta parlamentare të vitit 1998

Tabela 5- Rezultatet zgjedhjeve të katërta parlamentare të vitit 2002

Tabela 6- Rezultati e zgjedhjeve të pesta parlamentare të vitit 2006

Tabela 7- Rezultatet e zgjedhjeve të gjashta parlamentare të vitit 2008

Tabela 8- Rezultatet e zgjedhjeve të shtata parlamentare të vitit 2011

Tabela 9- Rezultatet e zgjedhjeve të teta parlamentare të vitit 2014

Tabela 10- Rezultatet e zgjedhjeve të nënta parlamentare të vitit 2016

Lista e grafikonëve

Grafikoni 1- Struktura e grupmoshave e të anketuarve

Grafikoni 2- Struktura gjinore e të anketuarve

Grafikoni 3- Struktura demografike e të anketuarve

Grafikoni 4- Struktura etnike e të anketuarve

Grafikoni 5- Struktura arsimore e të anketuarve

Grafikoni 6- Statusi socio-ekonomik i të anketuarve

Grafikoni 7- Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake

Grafikoni 8- Qëndrimet e qytetarëve sa i përket nocionit të demokracisë

Grafikoni 9- Demokracia pluraliste dhe zhvillimi i kapaciteteve demokratike në vend

Grafikoni 10- Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion

Grafikoni 11- Zgjedhjet dhe zhvillimi demokratik i një vendi

Grafikoni 12- Identifikimi i zgjedhjeve me demokracinë

Grafikoni 13- Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar dhe zgjedhjet e vendeve në tranzicion

Grafikoni 14- Republika e Maqedonisë së Veriut dhe progresi në zgjedhje

Grafikoni 15- Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimi i modelit zgjedhor

Grafikoni 16- Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

Grafikoni 17- Kriza politike në vigjilje të vitit 2016 dhe fillimi i reformave demokratike

Grafikoni 18- Ndikimi i Zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend

Grafikoni 19- Kriza gjithëpërfshirëse, zgjedhjet parlamentare 2016 si dhe ndërtimi i kapaciteteve demokratike për integrim në strukturat euro-atlantike

Grafikoni 20- Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë si zgjidhje e vetme e mundshme

Pyetje të kryqëzuara

Grafikoni 21- Struktura arsimore & Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake

Grafikoni 22- Statusi socio-ekonomik & Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake

Grafikoni 23- Struktura etnike & Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion

Grafikoni 24- Struktura arsimore & Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion

Grafikoni 25- Struktura arsimore & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimi i modelit zgjedhorë

Grafikoni 26- Struktura e grupmoshave & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

Grafikoni 27- Struktura demografike & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

Grafikoni 28- Republika e Maqedonisë dhe ndryshimi i modelit zgjedhorë & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

Grafikoni 29- Struktura etnike & Ndikimi i Zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend

Grafikoni 30- Struktura etnike & Kriza gjithëpërfshirëse, zgjedhjet parlamentare 2016 si dhe ndërtimi i kapaciteteve demokratike për integrim në strukturat euro-atlantike

Grafikoni 31- Kriza politike në vigjilje të vitit 2016 dhe fillimi i reformave demokratike & Ndikimi i zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend

Grafikoni 32- Struktura etnike & Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë si zgjidhje e vetme e mundshme.

Përmbajtja

Contents

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE	1
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE	1
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ.....	1
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES.....	1
Abstrakt	4
Abstract.....	8
Përmbajtje e shkurtër	10
Hyrje.....	18
Lënda e hulumtimit	19
Qëllimet e hulumtimit	20
Hipotezat	21
Kapitulli I: Demokracia pluralo-partiake si vlerë bashkëkohore	23
1. Kuptimi i demokracisë bashkëkohore	24
1.1 Kuptimi i pluralizmit politik	36
1.2 Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në shoqëritë e zhvilluara.....	39
1.3. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në vendet në tranzicion një vështrim kronologjik i pluralizmit politik në Republikën e Maqedonisë	42
Kapitulli II : Zgjedhjet si komponentë e rëndësishme në demokratizimin e shoqërive bashkëkohore	50
2.Kuptimi i zgjedhjeve.....	51
2.1 Sistemet zgjedhore	53
2.2 Qasja teoriko - shkencore mbi zgjedhjet.....	54
2.3 Zhvillimi historik i zgjedhjeve.....	56
2.4 Llojet e zgjedhjeve	59
2.5 Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar.....	69
2.6 Zgjedhjet në demokracitë e vendeve në tranzicion.....	70
Kapitulli III: Zgjedhjet dhe demokracia në RM analizë krahasimore (me zgjedhjet paraprake ndër vite).....	72
3. Kalimi nga sistemi monist në atë pluralist	73
3.1 Zgjedhjet dhe modeli zgjedhor në fillim të jetës pluralo politike.....	74
3.2 Ndryshimet në kodin zgjedhor si nevojë reale në kushtet e Republikës së Maqedonisë....	79

3.3 Aspekti instrumentalist dhe funksionalist i zgjedhjeve në R.M.	83
3.4 Zhvillimi i zgjedhjeve dhe proceseve zgjedhore deri në zgjedhjet parlamentare 2016	85
3.5 Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare 1990/2016	91
Kapitulli IV: Kushtet dhe rrethanat në vigjilje të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016....	101
4. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016.....	102
4.1 Kriza ekonomike.....	113
4.2 Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në prag të zgjedhjeve.....	118
4.3 Thellimi i krizës së gjithëmbarshme dhe nevoja për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme	121
4.4 Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 sfidë për tejkalimin e situatës së krijuar dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtim të Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit European dhe strukturave të NATO-s	128
Kapitulli V: Analizë ose shpalosje e rezultateve të analizës empirike me qytetarë të komunave të Pollogut.....	131
5. Përshkrimi i metodës hulumtuese	132
5.1 Rezultatet e hulumtimit.....	133
5.2 Pyetje të kryqëzuara.....	153
5.3 Përfundime dhe rekomandime	165
5.4 Literatura	168
5.5 Shtojcë.....	172

Hyrje

Zgjedhjet paraqesin një vegël shumë të rëndësishme në ndërtimin (mosndërtimin) e demokracisë në një shoqëri të caktuar, gjegjësisht në korniza të një sistemi të caktuar politik. Zgjedhjet në asnjë mënyrë nuk e bëjnë demokracinë më “demokratike” por ndikojnë jashtëzakonisht shumë që ta bëjnë demokracinë të “mundshme.” Shiquar nga perspektiva e zhvillimit të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë, jo çdo herë zgjedhjet kanë pasur rëndësi jetike për qëndrueshmërinë dhe perspektivat e sistemit politik të këtij vendi me një periudhë të stërgjatur tranzicioni. Andaj zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 paraqitnin një sfidë për zhvillimin dhe perspektivat e Republikës së Maqedonisë si shtet dhe shoqëri. Jo rastësisht jemi përcaktuar për hulumtimin e problematikës në fjalë. Në rastin konkret do të hedhim vetëm disa argumente që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë e arsyetojnë një hulumtim të kësaj natyre.

E para: shiquar në përgjithësi zgjedhjet janë një proces ku qytetarët e një shteti për mes votës së lirë dhe në princip proceduarve demokratike bëjnë përzgjedhjen e elitave politike që do të udhëheqin me shtetin një periudhë të caktuar ashtu siç është e paraparë me ligjet dhe kushtetutën e vendit. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet parlamentare gjegjësisht deputetët e zgjedhur e ushtrojnë detyrën e tyre në një afat kohorë katërvjeçarë por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se mandati i tyre nuk mundet të përfundon edhe më herët siç është rasti me zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme.

E dyta: zgjedhjet parlamentare të viti 2016 sipas të gjithë analistëve ndërkombëtar dhe vendor nënkuptonin tejkalimin e krizës së thellë politike në vend, krizë kjo që rrezikonte ardhmërinë e shtetit e në veçanti perspektivat euroatlantike të tij.

E treta: zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 paraqitnin një test për nivelin e kapaciteteve demokratike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimin e mentalitetit kulturor të cementuar prej zgjedhjeve të para parlamentare e deri më vitin 2016.

E katërta: zgjedhjet parlamentare 2016 paraqisnin një shpresë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh grupmoshat, gjinitë,

përkatësinë etnike dhe konfesionale për një të ardhme të ndritshme për Maqedoninë e Veriut si shtet (shoqëri) dhe qytetarët e saj.

Duke u nisur nga konstatimi se në përgjithësi shiquar fort pak janë trajtuar zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë dhe fakti se zgjedhjet parlamentare 2016 kanë mbet në nivel të analizave shumë të zbehta mendojmë se një hulumtim i nivelit të një doktrate do të jetë i mirëseardhur për teorinë shkencën dhe praktikën e mira të këtij vendi, andaj duke shpresuar në cilësinë e lartë të punimit jemi të bindur se përcaktimi për këtë do të arsyetohet dhe do të miratohet edhe nga ana e këshillit mësimor shkencor të fakultetit.

Lënda e hulumtimit

Ashtu siç potencaum në fjalët hyrëse lëndë hulumtimi e kësaj teze të doktoraturës janë zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, konkretisht zgjedhjet e vitit 2016. Nga vetë konceptimi i temës shihet qartë se problematika në fjalë ngërthen në vete dy aspekte shumë të rëndësishme të cilat janë ngushtë të ndërlidhura dhe gërshetohen me njëra-tjetrën: zgjedhjet si instrument demokratik dhe ndërtimin e kapaciteteve demokratike si parakusht për perspektivat e qëndrueshme të RMV.

Tema imponon sqarimin e gjithë proceduarve dhe arsyeshmërinë e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare 2016 nga njëra anë dhe reflektimin e zgjedhjeve parlamentare 2016 në ndërtimin e kapaciteteve demokratike në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana tjetër. Nga kjo mund të tërhiqet një konkluzion shumë domethënës se sipas mendimit tonë R.M.V. vite të tëra është ballafaquar me mungesë të kapaciteteve të nevojshme demokratike që janë parakusht i nevojshëm edhe i domosdoshëm për ecjen apo për lëvizjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt strukturave euro atlantike.

Ndërtimi i kapaciteteve demokratike nuk do të trajtohet vetëm prej prizmit të inkuadrimit të Maqedonisë në Nato dhe BE por para se gjithash si nevojë reale për zhvillimin e favorshëm demokratik të këtij vendi që në instancë të fundit nënkupton prosperitet ekonomik marrëdhënie të relaksuara ndëretike dhe ndërkonfesionale, ndërtim të një shoqërie të mirëfilltë qytetare, shtet ligjor dhe mundësi të njëjta dhe të barabarta për të gjithë qytetarët e vendit.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet e këtij hulumtimi janë shumë dimensionale dhe në princip mund të reduktohen me sa vijon:

E para: hulumtimi do të paraqesë një kontribut modest shkencorë dhe teorik mbi zgjedhjet dhe proceset zgjedhore. Ky punim do të shërben si një bazë e mire për hulumtuesit tjerë të kësaj problematike.

E dyta: pritet që hulumtimi të ketë vlera të veçanta praktiko-aplikative, rezultatet e hulumtimit do të jenë në dispozicion për elitat politike, partitë politike dhe qytetarët e rëndomtë të cilët janë të interesuar të kuptojnë diçka më tepër për zgjedhjet dhe proceset zgjedhore e sidomos për zgjedhjet parlamentare të vitit 2016.

Hipotezat

Kjo temë doktrate do të bazohet në një hipotezë kryesore dhe disa hipoteza ndihmëse.

Hipoteza Kryesore:

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ndikuan dukshëm në ndërtimin e kapaciteteve demokratike në vend?

Hipoteza Ndihmëse:

Zgjedhjet parlamentare 2016 ndihmuan në relaksim të marrëdhënieve ndëretnike.

Zgjedhjet parlamentare 2016 ndikuan në harmonizimin e raporteve ndërkonfesionale.

Zgjedhjet parlamentare 2016 hapen shtigje për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ndikuan në uljen e nivelit të mitos dhe korrupsionit në vend.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 e kthyen besimin te institucionet dhe funksionalitetin e tyre në Republikën e Maqedonisë.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë përpilimit të punimit të doktoraturës do të përdoren metodat dhe teknikat bazë të studimit shkencorë: analiza dhe sinteza, induksioni dhe deduksioni, metoda historike, metoda komparative, metoda statistikore si dhe pyetësi si një nga teknikat bazë dhe më gjerësisht të përdorura të hulumtimit shkencorë.

Metoda /teknika bazë që do të përdoret gjatë këtij hulumtimi shkencorë për mbledhjen e të dhënave është anketa që do të bëhet me një gamë më të gjerë të qytetarëve, banorë të Pollogut. Do të anketohen rreth 515 qytetarë të etnive, grup moshave, gjinive dhe niveleve të ndryshme arsimore dhe statuseve sociale.

Variablat e varura dhe të pa varura

Në këtë kontekst si variabël e varur janë zgjedhjet

Variabël e pavarur janë votuesit dhe procesi zgjedhorë

Variabël e varur është organizimi politik në Republikën e Maqedonisë

Variabël e pavarur është elektorati

Rëndësia e punimit

Punimi vlerësojmë se do të ketë vlera të larta teoriko-shkencore dhe praktike. Shpresojmë ky punim të jep një kontribut modest në teorinë e zhvillimit të sistemit zgjedhorë dhe demokracisë dhe në të njëjtën kohë të jetë në shërbim të elitave politike, elitave intelektuale por dhe qytetarëve të rëndomtë.

Kapitulli I: Demokracia pluralo-partiake si vlerë bashkëkohore

1. Kuptimi i demokracisë bashkëkohore
2. Kuptimi i pluralizmit politik
3. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në shoqëritë e zhvilluara
4. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në vendet në tranzicion një vështrim kronologjik i pluralizmit politik në Republikën e Maqedonisë

1. Kuptimi i demokracisë bashkëkohore

Demokracia me siguri është ndër nocionet më të përdorura në ditët tona, këtë term me të madhe e përdorin teoricienët, shkencëtarët, politikanët, por edhe njerëzit e rëndomtë. Me këtë rast patjetër duhet të thuhet ajo se ky term shpeshherë është keqpërdorë për arritje të qëllimeve të caktuara.¹

Demokracinë mund ta definojmë në shumë mënyra. Kjo mund të jetë njëra ndër arsytet se pse ekzistojnë lloje të ndryshme të shteteve demokratike. Nuk ekziston një përshkrim standard i demokracisë dhe ky term është përdorur në shumë mënyra të ndryshme dhe ndonjëherë edhe në mënyrë kontradiktore. Megjithatë, për një shpjegim të përshtatshëm demokracia mund të përshkruhet si një qëllim (synim), apo si një model i përkryer që një sistem funksional politik duhet të plotësojë; dhe gjithashtu si një strukturë (tendencë) e institucioneve politike aktuale, praktikave apo proceseve që janë kërkuar në mënyrë që të përmbushen kriteret, brenda standardeve të vendosura nga rrethanat historike, kapacitetit (aftësisë) njerëzorë dhe fakteve tjera.²

Sigurisht, koncepti i demokracisë është i gjerë dhe i shumanshëm. Kjo ndodh, përveç të tjerash, edhe sepse demokracia sot merret gjerësisht si emër i një qytetërimi ose, më mirë të themi, emri i prodhimit politik përfundimtar (gjer tani) i qytetërimit perëndimor. Kështu pra, një autor i vetëm kryesor i demokracisë nuk ekziston. Teoria e demokracisë përbëhet më fort nga rrjedha kryesore e një debati që e ka burimin te Platoni dhe Aristoteli. Megjithatë, kjo rrjedhë kryesore debati i ka siguruar “demokracisë” identitetin themelor vetëm gjer në fund të Luftës së Dytë Botërore.³ Të përkufizosh demokracinë nuk është aspak e thjeshtë, aspak e lehtë. Është e vërtetë që ideja e demokracisë duhet të bëhet sa më e kapshme që të jetë e mundur, sepse komuniteti demokratik kërkon para se gjithash që parimet dhe mekanizmat e tij të kuptohen gjerësisht. Por nga thjeshtëzimi i tepërt mund edhe të vdesësh. E vetmja mënyrë për ti zgjidhur problemet është ti njohësh, ti dish cilat janë, thjeshtëzimi i shuan dhe kështu i rëndon.⁴

¹ Aziri, E. *Sociologjia*. Arbëria Design, (Tetovë, 2007, f. 319).

² Latifi, V. *Konceptet e demokracisë*. Academic press, (Shkup, 2009, f.15).

³ Sartori, G. *Edhe një herë për teorinë e demokracisë*. Dituria, (Tiranë, 2006, f. 17).

⁴ Sartori, G. *Ç’është demokracia*, Dituria, (Tiranë, 1998, f. 12).

Është pranuar gjerësisht në literaturën e shkencave politike se demokracia buron që nga koha e Greqisë së lashtë, më saktësisht në qytet-shtetin e Athinës. Themeluesit e saj konsiderohen politikanët Soloni dhe Klisteni. Filozofët si Platoni dhe Aristoteli ndër të parët e kanë ekzaminuar teorinë e demokracisë. Teoria e demokracisë është drejtim udhëheqës në shkencat politike që para 2500 viteve.

Për herë të parë fjalën demokraci e ka përdorur historiani grek Herodoti në shekullin e V para erës sonë. Prej asaj kohe ky term është përfshirë në fjalorin politik edhe pse ka qenë i harruar për shumë kohë. Mirëpo që atëherë e këtej ky nocion ka pasur kuptim të ndryshëm përgjatë kohës së ekzistimit. Ka korresponduar me kushte tërësisht të kundërta të jetës shoqërore dhe ideve të ndryshme. Për afërsisht në kohën e njëjtë kur ‘qeverisja e popullit’ është etabluar në Greqi, gjithashtu është shfaqur edhe në Romën e lashtë. Romakët sistemin e tyre politik nuk e kanë quajtur ‘demokraci’ por ‘republikë’. Në literaturën politike republika është diçka që i takon popullit.⁵

Vetë fjala demokraci rrjedh nga greqishtja. Në fakt shprehja “demokraci” në vete ngërthen fjalën “demos”, që do të thotë popull dhe “kratos” që do të thotë pushtet, gjegjësisht qeverisje. Domethënë, demokracia e ka kuptimin “ sundimit nga populli”, por mund të kuptohet edhe si “sundim i shumicës”.

Në qoftë se demokracinë e kuptojmë si “sundim nga populli”, atëherë parashtrohen pyetje se ç’nënkupton populli dhe cilin duhet ta sundojë ai? Në qoftë se demokracinë e kuptojmë si sundim të shumicës, atëherë për kushtet dhe rrethanat bashkëkohore të organizimit të shtetit dhe pushtetit ka një logjikë të qëndrueshme.⁶

Këto përkufizime tradicionale, nocionin e demokracisë e kufizojnë në sovranitetin popullor, përkatësisht në qeverisjen e popullit. Kjo përkon edhe me prejardhjen etimologjike të fjalës demokraci. Në doktrinat bashkëkohore politike dominojnë qasjet realiste për demokracinë, të cilat lënë anash parimin e “sovranitetit popullor” dhe në epiqendër vendosin qytetarin emancipimin politik të tij dhe pjesëmarrjen e tij të drejtpërdrejtë në ndërtimin e politikave publike dhe zgjedhjen e organeve përfaqësuese.⁷

⁵ Latifi, V. *Konceptet e demokracisë*. Academic press, (Shkup, 20090, f. 57).

⁶ Aziri, E. *Sociologjia*. Arbëria Design, (Tetovë, 2007, f. 319).

⁷ Bufi, Y. *Tempulli i demokracisë*. Ombra gvg, (Tiranë, 2010, f. 72).

Sado që thjeshtëzimi etimologjik i jep një spikatje të veçantë sovranitetit popullor, asnjë prej nesh nuk mendon deri në fund që demokracia është vetëm kaq: ajo që do sovrani popull.

Pra, duhet të jetë e qartë: kur themi se ka dy tipe demokracish, demokracia si ushtrim i drejtpërdrejtë i pushtetit, ose si sistem kufizimi dhe kontrolli i pushtetit, nuk e kemi fjalën aspak për sisteme të ndërskëmbyeshme. Nuk është çështja që vetëm se njerëzit e kohëve moderne kanë ditur të krijojnë një demokraci “vitale”, të aftë të funksionojë e të rrojë, por edhe që njerëzit modern zgjidhin problem që grekët nuk i zgjidhën dhe arrijnë vlera që ata nuk i njihnin.⁸

Sot, shumica e mendimtarëve kanë braktisur përkufizimin klasik të demokracisë, si sinonim të sovranitetit popullor dhe si sistem, që siguron dhe garanton qeverisjen e popullit. Tani gjithnjë e më shumë “sovraniteti popullor” po lëshon vendin “sovranitetit të qytetarit”, i cili në kushtet e ambientit demokratik lirisht merr vendime politike nëpërmjet rrugës së qeverisjes së shumicës. Ambient demokratik, supozon funksionimin e institucioneve demokratike, ku bëhet artikulumimi i interesave të qytetarëve dhe sintetizimi institucional, në një interes legjitim të shumicës. Ky proces politik i qeverisjes, duhet të bazohet në rregulla dhe procedura demokratike dhe në sundimin e ligjit në shoqëri.

Në themel të përqasjes bashkëkohore të demokracisë vihet dallimi midis demokracisë si një ideal i një bashkësie politike dhe demokracisë si një sistem qeverisjeje. E para është një qëllim i veprimit kolektiv, e dyta është një mjet për të arritur disa qëllime të përbashkëta.⁹

Sot shumica e atyre që flasin për standardet e demokracisë me vetëdije apo jo, ekskluzivisht mendojnë për standardet e qeverisjes politike në vendet perëndimore (në veçanti në treshen Angli, Francë dhe SHBA) në periudhën moderne, kurse në fakt demokracia ka një histori 2500 vjeçare, që nga polisët e Greqisë antike.

Lidhur me konceptin e demokracisë bashkëkohore, e cila është fryt i kapitalizmit industrial dhe që kushtëzohet nga zhvillimi ekonomik dhe ekzistimi i klasës së mesme, sikurse edhe për kulturën, ekzistojnë mbi treqind përkufizime. E përbashkët e gjithë këtyre fjalëve është theksimi i “administrimit popullor”.

⁸ Sartori, G. *Ç’është demokracia*. Dituria, (Tiranë, 1998, f. 124).

⁹ Bufi, Y. *Tempulli i demokracisë*. Ombra gvg, (Tiranë, 2010, f. 72).

Në pajtim me këtë demokracitë, sidomos ato perëndimore, bazohen në tre parime kryesore që e përcaktojnë karakterin e saj:

1) Sigurim i lirive të individëve dhe mbrojtja e tyre kushtetuese, d.m.th, *individualizimi*.

2) Sistemi parlamentar si institucion për mirëqenien e popullit (*delegimi apo përfaqësimi*).

3.) E drejta e votës krahas administrimit në pajtim me dëshirën e shumicës (*shumica*).¹⁰

Gjatë historisë vet nocioni demokraci ka përjetuar ndryshime të shumta pikërisht në pikëpamje të asaj se çka kuptojmë dhe çka duhet kuptuar me nocionin demos. Në këto shqyrtime sidomos dallohen pikëpamjet që janë dhënë në shoqërinë qytetare. Sipas konceptit formalist qytetar, por edhe sipas pikëpamjeve historike materialiste del se ajo është e drejtë formale e secilit qytetarë që të marrë pjesë në miratimin e vendimeve me interes të përbashkët shoqërorë.¹¹

Normalisht shpesh është parashtruar pyetja, përse shumicat duhet të sundojnë pakicat?

Të parin argument në favor të demokracisë në Greqinë e lashtë e përmend Tukiditi. Ai shkruan se termin si të atillë e ka shpreh Perikliu, njëri nga udhëheqësit demokratik të Athinës në vitin 430 para Krishtit. Perikui thoshte se demokracia lidhej me tolerancën, por nuk bënte fjalë për sundimin e shumicës. Platoni dhe Aristoteli ishin të dy kundër demokracisë, me atë që i pari e kundërshtonte plotësisht ndërsa i dyti kishte qëndrim më të përmbajtur dhe në instancë të fundit e arsyetonte duke i vu në pah edhe anët negative të saja. Platoni thoshte se demokracia kontrollin e qeverisjes e kalonte nga ata që dinin të qeverisnin tek demagogët populist, kurse Aristoteli thoshte se qeverisja nga populli në fakt donte të thoshte qeverisje nga të varfërit, nga të cilët mund të pritej që të shpronësonin të pasurit. Megjithatë, Aristoteli ishte i pari që përligji sundimin e shumicës, duke thënë se “më tepër duhet të jetë sovranë shumica se sa më të mirët, kur më të mirët janë të paktë.”¹²

Në Athinën antike ashtu si dihet, si pjesë aktive e politikë-bërjes, ishin të gjithë athinasit, me përjashtim të skllëvërve, të huajve, grave, dhe fëmijëve.

¹⁰ Pajaziti, A. *Fjalor i Sociologjisë*. Logos A, (Tetovë, 2009, f. 113).

¹¹ Rapi, Gj. *Sociologji*. (Prishtinë, 1997, f. 267).

¹² MECLAIN, I. *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press, Shtëpia e librit dhe komunikimit, (Tiranë, 2010, f.81).

Në qoftë se analizohet numri i përgjithshëm i të huajve, skllëvërve dhe grave dalin në sipërfaqe shumë dobësi të demokracisë athinase. Aristoteli skicon pesë lloje kushtetutash demokratike me shkallë dhe fusha të ndryshme të pjesëmarrjes në qeverisje. Ideja mbizotëruese e kushtetutës demokratike është liria, e cila në të vërtetë është një koncept i caktuar i drejtësisë dhe pikërisht, gëzimi i një barazie aritmetike ndërmjet qytetarëve.¹³

Në kushte dhe rrethana të organizimit të shtetit dhe shoqërisë historikisht shiquar, nocioni demokraci nuk ka gëzuar çdo herë përkrahje, pra shpesh herë ai “vishej” me konotacione negative. Një nga mendimtarët më të mëdhenj të mesjetës Thomas Aquinas e cilësonte demokracinë së bashku me tiraninë dhe oligarkinë si forma të këqija të qeverisjes. Pra, është fjala për një periudhë kohore ku demokracia dhe partitë politike nuk ishin pjesë e jetës shoqëroro-politike. Në periudhën e feudalizmit as që mundet të flitet për demokracinë si nocion dhe si praktikë e të qeverisurit.

Demokracia si formë qeverisje u riaktualizua pas shkatërrimit të rendit feudal dhe paraqitjes së kapitalizmit si rend shoqërorë, i cili si në kuptimin e institucioneve, ashtu edhe në kuptimin e politikave publike dallonte nga formacionet e mëparshme shoqëroro-politike. Si rezultat i zhvillimit të jetës shoqërore dhe politike në kapitalizëm, në radhë të parë në sferën e respektimit të të drejtave të lirive individuale e kolektive ku veçohet përhapja graduale e të drejtës së votës tek masat e gjëra popullore, u shfaqen edhe partitë politike që luanin rolin e subjekteve ndërmjetësues mes qytetarëve dhe shtetit në proceset e politikëbërjes.¹⁴

Megjithatë edhe në kushtet e reja që imponoi kapitalizmi gjatë fazave të zhvillimit të tij demokracia si formë qeverisje nuk u bë e përkryer. Kjo mund të konstatohet edhe në përkufizimet e shumta të shkencëtarëve, teoricienëve, politikanëve dhe burrështetasve që kanë lënë gjurmë në jetën shoqëroro-politike të shumë shoqërive bashkë-kohore. Si emërues i përbashkët i këtyre përkufizimeve theksojmë se demokracia nuk paraqet një formë të përkryer ideale të qeverisjes, ndërsa ajo duhet ndërtuar e rindërtuar me shumë kujdes dhe përkushtim.

¹³ Cameron, L. McDonald. *Teoria Politike Perëndimore*. Ideart, (Tiranë, 2006, f. 130).

¹⁴ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 184).

Megjithatë ka edhe personalitete të njohura të jetës politiko-shoqërore që e idealizojnë demokracinë si formë e qeverisjes. Njëri nga ata është edhe Lincolni.

Abraham Lincoln në Getisburg në vitin 1864, në mesin e Luftës Civile Amerikane u shpreh se, demokracia nënkupton “qeveri të popullit, nga populli dhe për popullin”, në ç’rast ai bën ekzagjerimin e vlerave të demokracisë. Megjithatë pjesa më e madhe e përkufizimeve tjera mbartin rezerva të caktuara, duke lënë të kuptohet se demokracia nuk është “diçka e përkryer”, por formë qeverisje e cila duhet gjithmonë të plotësohet me elemente të rinj në përputhje me kushtet dhe rrethanat në të cilat zhvillohen shoqëritë njerëzore.¹⁵

Për dallim nga Linkoln një nga kryeministrat më karizmatik të Britanisë së Madhe, Winston Churchill në vitin 1947 do të shprehet se “demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, përveç të gjitha formave tjera që janë eksperimentuar herë pas herë”. Nga ana tjetër, Bernard Cric shprehet se “demokracia është ndoshta fjala më e pakuptimtë në botën e punëve publike”.

Koncepti i mosekzistencës së demokracisë ideale nuk është i pa kontestueshëm. Demokracia ideale ekziston vetëm në mendjet e individëve të caktuar, të cilët shpresojnë dhe luftojnë për të përmirësuar secilin nga sistemet politike që janë pjesë përbërëse e shoqërive të tyre, por jo rrallë herë edhe sistemet politike të tjerëve. Nga këndvështrimi praktik, demokracia është një regjim kërkues nga secili individ e qytetarë i shoqërisë, edhe pse demokracia e plotë është e pa arritshme, iniciativat për përsosjen e demokracisë nuk mungojnë dhe as do të mungojnë në të ardhmen.¹⁶

Procesi i demokratizimit zakonisht kalon nëpër tre faza kryesore:

- Liberalizimi
- Demokratizimi dhe
- Konsolidimi. (Graeme, 200:8)¹⁷

Liberalizimi modifikon para se gjithash lidhjet reciproke mes shtetit dhe shoqërisë civile kurse demokratizimi ngërthen brenda vetes liberalizimin dhe ndryshimet e lidhjeve reciproke mes shtetit dhe shoqërisë politike. Thelbi konsolidimit demokratik kërkon me

¹⁵ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhor*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 184).

¹⁶ Aziri. *Po aty*, f. 184.

¹⁷ Latifi, V. *Politikologjia*. Akademik Press, (Shkup, 2008, f. 504)

arritjen e shkallës më të lartë të legjitimitetit të demokracisë si në gjerësi ashtu edhe në thellësi.¹⁸

Llojet dhe Format e demokracisë

Në politikologjinë bashkëkohore kryesisht dallohen tre lloje të regjimeve demokratike (Kushtetuese parlamentare): *parlamentare, presidenciale dhe gjysmë presidenciale*

Regjimet Parlamentare përkojnë me monarkitë parlamentare dhe republikat parlamentare. Sot në Evropë ekzistojnë rreth 10 shtete të cilat mund të radhiten në monarki parlamentare: Britania e Madhe, Spanja, Belgjika, Holanda, Danimarka, Suedia, Norvegjia, Luksenburg, etj. Republikat parlamentare tipike janë: Gjermania, Italia, Greqia, Izraeli, etj.

Regjimi presidencial historikisht paraqitet dhe zhvillohet si formë e qeverisjes në SHBA, ku presidenti shtetit ka ingerenca të mandatarit/ kryeministrit dhe presidentit njëkohësisht.

*Regjimet gjysëm presidenciale: Franca, Finlanda, Austria, Portugalia, Irlanda, Islanda etj.*¹⁹

Ekzistojnë dy forma të demokracisë, demokracia e *drejtpërdrejtë* dhe demokracia e *tërthortë, indirekte*.

Demokracia e drejtpërdrejtë, bazohet në qeverisjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe popullit në pushtetin shtetërorë. Esenca e saj më së miri shprehet në parimin se “sovrانيتeti buron nga populli dhe i takon atij”. Demokracia e drejtpërdrejtë është karakteristike për Athinën e vjetër. Sot, format më të njohura të realizimit të saj janë: referendumi, plebishiti, iniciativa popullore, tubimet e zgjedhësve dhe format e tjera të deklarimit personal të qytetarëve.²⁰ *Demokracia indirekte* është forma bazë e të gjitha shoqërive demokratike sot.

Sa i përket *demokracisë direkte* vlen të nënvizohet se nuk ka pasur ndonjë diskutim serioz rreth demokracisë athinase si një model i mundshëm deri në kohët tona. Parashtrahet pyetja a është ajo e mundshme si një alternativë e realizueshme e demokracisë përfaqësuese në një kohë kur teknologjia e kompjuterit ka hequr pengesat për

¹⁸ Latifi, V. *Politikologjia*. Akademik Press, (Shkup, 2008, f. 504).

¹⁹ Latifi. *Po aty*, f, 494.

²⁰ Buñi. *Po aty*, f, 89.

pjesëmarrjen shkallë gjerë në vendimmarrje.²¹ Demokracia direkte, në thelb nënkupton paraqitjen embrionale të demokracisë, kur në mungesë të shoqërisë së organizuar dhe institucioneve politike, populli dhe qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë, marrin vendime politike. Me zhvillimin e shoqërisë dhe paraqitjen e institucioneve politike, që kufizuan pushtetin absolut, paraqiten organet përfaqësuese dhe institucionet e tjera politike, përmes të cilave qytetarët artikulojnë vullnetin e tyre politik dhe ushtrojnë qeverisjen me pushtetin. Pas zbulimit të parlamentarizmit, demokracia e drejtpërdrejt zëvendësohet me atë përfaqësuese, e cila sot përbën modelin dominues në shumë shtete.²²

Demokracia e tërthortë (përfaqësuese), është formë e qeverisjes ku populli zgjedh një numër përfaqësuesish që marrin vendime në emër të tij.²³ Demokracia përfaqësuese është një formë e kufizuar dhe e tërthortë demokratike. Ajo është e kufizuar në atë që pjesëmarrja popullore është e rrallë dhe e shkurtër, duke u kufizuar në veprimin e votimit çdo disa vjet. Është e tërthortë në atë që publiku nuk e ushtron vetë pushtetin; ai thjesht zgjedh ata të cilët do të sundojnë në emër të tij; kjo formë e sundimit është demokratike vetëm për sa kohë përfaqësimi vendos një lidhje të besueshme dhe të dobishme mes qeverisë dhe të qeverisurve. Kjo ndonjëherë shprehet në nocionin e mandatit zgjedhor.²⁴

Babai i demokracisë moderne, Zhak Zhak Ruso, kishte rezerva të caktuara ndaj demokracisë parlamentare. Ai si një kritik i pa lodhshëm i praktikës zgjedhore angleze në “Kontratën Shoqërore” do të thotë: “Populli anglez beson për vete se është i lirë por shumë mashtrohet; ai është i lirë vetëm gjatë kohës së zgjedhjes së anëtarëve të parlamentit. Në atë moment kur ata zgjidhen populli bie në robëri dhe nuk paraqet asgjë”.

Në fakt Rusoi, i cili angazhohej për një formë radikale të demokracisë, thoshte se demokracia e vërtetë as që ka ekzistuar e as që do të ekzistojë ndonjë herë.²⁵ Por ai ishte i vetmi që e thoshte këtë.²⁶

Pasuesit e *demokracisë së konkurrencës* kërkojnë shumë pak nga popullsia. Ata thonë se aktiviteti i vetëm politik i shtetasit është të zgjedhë midis elitave (partive) që janë

²¹ IAN MECLAIN . *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press, (Tiranë, 2001, f. 86).

²² Buçi. *Po aty*, f. 88.

²³ Pajaziti. *Po aty*, f. 114.

²⁴ Heywood, A. *Politika*. Brezi 81’, (Prishtinë, 2008, f. 68).

²⁵ Aziri, E. *Sociologjia*. Arbëria Design, (Tetovë, 2007, f. 333).

²⁶ IAN MECLAIN . *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press, (Tiranë, 2001, f. 83).

në garë më njëra tjetrën, që do të qeverisin për ta dhe që ndoshta do ti ndërrojnë në zgjedhjet e ardhshme.²⁷

Shumpteri thoshte: “ Sistemi demokratik është një strukturë e tillë institucionale për marrjen e vendimeve politike në të cilën individët e fitojnë pushtetin e marrjes së vendimeve përmes luftës konkurruese për votat e popullit”.²⁸ Ai ishte gjithashtu pasues i demokracisë së përfaqësuar. Ai mendonte se bërthama e demokracisë ishte që të gjithë, me bazë të barabartë (një person një votë) duhet të caktojnë drejtuesit nëpërmjet zgjedhjeve ose hedhjes poshtë të elitave (partive) që paraqiten në zgjedhje. Ashtu si ndërmarrjet që konkurrojnë për blerës ashtu edhe partitë duhet të konkurrojnë për votën e zgjedhësit. Për këtë arsye kjo formë e demokracisë u quajt demokraci e konkurrencës. Ashtu si në treg qytetarët janë të lirë të përdorin “Kapitalin e tyre, votën, ashtu si mendojnë se është më e arsyeshme.”²⁹ Demokracia sipas Schumpterit është sundim i politikanëve e jo i popullit. Politikanët janë “tregtarë votash” njësoj si aksionet në bursë.³⁰

Është e vërtetë se çdo formë e demokracisë nuk është përfaqësuese, por gjithashtu është e vërtetë edhe se çdo shtet përfaqësues nuk është demokratik vetëm për shkak se është përfaqësues.

Demokracia përfaqësuese me të gjitha trajtat e veta është e vetmja formë e demokracisë bashkëkohore. Ajo ka edhe anët pozitive por ka edhe mangësi të caktuara.³¹ Pikat e forta të demokracisë përfaqësuese përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- Ofron një formë praktike demokracie (pjesëmarrja e drejtpërdrejtë popullore arrihet vetëm në bashkësi të vogla).
- Ia heq qytetarëve të zakonshëm barrën e vendimmarrjes, duke bërë të mundur një ndarje punësh në politikë.
- Lejon qeverinë të vihet në duart e atyre që kanë arsimim më të mirë, dije më të lartë dhe përvojë më të madhe.
- Mban qëndrueshmëri duke i larguar qytetarët e zakonshëm nga politika, pra duke i nxitur ata ta pranojnë kompromisin.

²⁷ Kval-Mellbye-Tarnoy. *Politika dhe Demokracia*. Onufri, (Tiranë, 2006, f. 23).

²⁸ Fromm, E. *Shoqëria e shëndoshë*. Fan Noli, (Tiranë, 2012, f.191).

²⁹ Tarnoy. *Po aty*, f. 27.

³⁰ Jashari, H. *Ese të filozofisë politike*. Arbëria Design, (Tetovë, 2010, f. 67).

³¹ Aziri, E. *Po aty*, f. 334.

Ajo çka i jep votimit frymën demokratike, gjithsesi, është që duke qenë se zgjedhjet janë konkurruese, ato ia mundësojnë publikut ‘ti dënojë mashtruesit’ dhe ti bëjë publikisht më të përgjegjshëm politikanët.³²

Neimen (1998) flet edhe për *demokracinë diskutabile*, e cila përmirëson defektet e demokracisë përfaqësuese.

David Held flet për *demokracitë direkte, liberale njëpartiake*.³³ Ai gjithashtu shfaq edhe variante si: *autonomi demokratike* dhe *demokraci kosmopolitane*. Varianti demokracisë kosmopolitane është skicuar nëpërmjet pesë sferave ku sistemet regjionale dhe globale janë duke sfiduar autoritetin sovran dhe formal të shteteve demokratike nacionale: ekonomi botërore, organizatat internacionale, ligjet internacionale, ambient dhe kultura.

Tipologji dhe perspektiva të tilla janë të prezantuara në shkallën e modeleve dhe të teorive. Është çështje tjetër se si qëndrojnë punët në realitet, qartë se aty ka një hapësirë të madhe ndërmjet praktikës së përditshme dhe teorisë së modeleve bashkëkohore të demokracisë. Përderisa ne nuk do të rishikojmë realitetin duhet gjithashtu të vëzhgojmë se çka historia e ideve na tregon për mendimet tona bashkëkohore për demokracinë. Në këtë aspekt nuk është e vështirë të shohim se pas periudhës post-moderniste, e cila ishte e përmbushur plot me konfuzione, ne jemi duke hyrë në një fazë të re me rilindje të ndriçimit të mendjes.³⁴

Demokracia Parlamentare

Kur flitet sot për demokracinë më pak mendohet për pushtetin e popullit, kurse theksi vihet, te metodat e të qeverisurit, në mënyrë të veçanta të zgjedhjes së çështjeve dhe situatave konfliktuale, pa dhunë, ose te qëndrimi tolerant i shumicës ndaj pakicës, ose te kanalizimi i konflikteve në procedura legale, p.sh. përmes parlamentit.³⁵

Demokracia parlamentare, e quajtur shpesh demokracia përfaqësuese, si formë kryesore e demokracisë së tërthortë paraqet modelin dominues të sistemeve bashkëkohore politike. Thelbi i saj, konsiston në realizimin e vullnetit të shumicës së qytetarëve,

³² Heywood. *Po aty*, f. 68.

³³ Pajaziti. *Po aty*, f. 114.

³⁴ Latifi, *Po aty*, f. 496.

³⁵ Agani, F. *Demokracia, Kombi, Vetëvendosja*. Dugagjini, (Prishtinë, 2002, f. 217).

nëpërmjet institucioneve dhe trupave përfaqësues të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Pra, sovraniteti dhe qeverisja e popullit, këtu nuk bëhet drejtpërdrejtë nga populli, por nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura nga populli dhe të fuqizuara me mandatin për qeverisjen e shtetit.³⁶

Demokracia dhe parlamentarizimi, janë të lidhura aq ngushtë ndërmjet tyre sa që praktikisht pa njëra-tjetrën, nuk mund të rezistojnë dhe funksionojnë. Një ndërsjellje të tillë shpreh postulati se *parlamenti duhet të jetë tempulli i demokracisë*. Në kuptimin më të gjerë, demokracia nënkupton parlamentarizimin dhe pluralizmin, si proces politik, përmes të cilave artikullohet vullneti politik i qytetarëve. Nuk ka sistem demokratik, aty ku nuk kufizohet pushteti dhe ku mungon kontrolli politik mbi të. Po ashtu, sistemi demokratik është i paimagjinueshëm pa sistemin pluralist, i cili, u mundëson qytetarëve shprehjen e interesave të tyre politike në luftën politike e institucionale për realizimin e tyre. Roli aktiv i qytetarëve në sistemin parlamentar, e sidomos të drejtat e tyre për të zgjedhur organet përfaqësuese dhe për ti dhënë atyre mandat për qeverisje, në thelb paraqet strumbullarin e demokracisë. Parlamentarizimi, krahas sovranitetit popullor, shtetit të së drejtës dhe qytetarit të lirë, përbën elementin themelorë të çdo sistemi dhe rendi demokratik.³⁷

Elementet e demokracisë-

Teoria bashkëkohore politike i përcakton këto elemente themelore të saj:

- Sovranitetin popullor
- Qeverisja e së drejtës, përkatësisht shteti ligjor
- Ndarjen dhe kufizimin e pushtetit shtetëror
- Zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe pluraliste
- Sigurimin dhe garantimin e të drejtave të qytetarëve
- Pluralizmin politik dhe ekonomik
- Përgjegjësinë politike
- Procedura demokratike e marrjes së vendimeve
- Kultura dhe toleranca politike³⁸

³⁶ Buçi, Y. *Tempulli i demokracisë*. Ombra gvg, (Tiranë, 2010, f. 89).

³⁷ Buçi, *Po aty*, f. 70.

³⁸ Bajrami, A. *Parlamentarizmi*. Kolegji Fama, (Prishtinë, 2010, f. 46).

Ndoshta do të ishte mirë që demokracia të kufizohej thjesht me sundimin e shumicës, toleranca, garantimi i të drejtave etj të trajtoheshin si parakushte për demokracinë jo si element përbërës të vendeve demokratike.³⁹ Mirëpo elementet e sipërpermendura në shoqëritë bashkëkohore veprojnë si të gërshetuar dhe ato e plotësojnë njëri-tjetrin. Niveli i efektshmërisë së komponentëve në fjalë ndryshon nga shoqëria në shoqëri. Ajo drejtpërdrejt varet nga kushtet dhe rrethanat shoqëro-ekonomike në të cilat zhvillohet një vend. Pra demokracia nuk duhet kuptuar si një institucion politik ideal, si diçka e përkryer, por përkundrazi si një proces që zhvillohet, plotësohet dhe ndërtohet në vazhdimësi. Kjo që u tha bëhet më e qartë në qoftë se i hedhim një shikim kritik zhvillimit historik të demokracisë, por gjithsesi edhe nëse bëjmë një krahasim ndërmjet shoqërive konkrete që sot janë të pagëzuara si “shoqëri me demokraci të zhvilluar” dhe shoqërive që gjenden në një shkallë më të ulët të zhvillimit të tyre.⁴⁰

Në kuadrin e demokracisë parlamentare duhet të dallojmë *demokracinë mazhoritare* dhe atë *konsensuale*

Demokracia mazhoritare bazohet në konceptin e qeverisjes së shumicës. Ajo nënkupton një mazhorancë të qëndrueshme parlamentare, e cila zgjedh qeverinë dhe realizon programin qeveritar të qeverisjes. Kjo demokraci është tipike për sistemet parlamentare dypartiake, ku vlen parimi fituesi merr të gjitha, humbësi kalon në opozitë dhe nuk merr pjesë në qeveri. Modeli tipik i qeverisë mazhoritare është sistemi britanik dhe ai amerikan i qeverisjes, i bazuar në sistemin dypartiak me mazhorancë parlamentare dhe opozitë të fortë. Veçori tjetër e demokracisë mazhoritare është sistemi mazhoritar elektoral që siguron legjitimitetin e plotë të përfaqësuesve politik dhe lidhjen e tyre të drejtpërdrejt me popullin, përkatësisht trupin elektoral. Të zgjedhurit sipas sistemit mazhoritar duhet të mbrojnë interesat publike të zgjedhësve të tyre, para interesave partiake nga të cilat ata vijnë.⁴¹

³⁹ IAN MECLAIN . *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press, (Tiranë, 2001, f, 83).

⁴⁰ Aziri. *Po aty*, f.321.

⁴¹ Bufi. *Po aty*, f. 91.

Demokracia konsensuale funksionon në shoqëritë heterogjene politike, me një spektër të gjerë të diversiteteve politike. Në këtë shoqëri mungon një profilizim i qartë politik dhe një sistem i qeverisjes së shumicës parlamentare. Qeverisja politike reflekton kompromiset e domosdoshme politike, për të ndërtuar konsensusin e nevojshëm politik, i cili siguron qeverisjen e shumicës. Demokracia konsensuale imponon nevojën e ndërtimit të koalicioneve parlamentare dhe qeveritare, si formë e bashkimit të disa alternativave politike në një program qeveritar, që reflekton në shumicën parlamentare. Kjo formë e demokracisë, jo rrallë zbatohet si formë plotësuese e demokracisë mazhoritare dhe shpesh përgjegjësinë e regjimit politik në pushtet, për të siguruar qeverisjen e mirë dhe për të ndërtuar kompromiset e nevojshme me opozitën parlamentare, sidomos në marrjen e vendimeve me interes të përgjithshëm.⁴²

1.1 Kuptimi i pluralizmit politik

Së pari, pluralizmi duhet konceptuar si besim në vlera. Një vizion i botës që edhe sot e kësaj dite mbetet tipik perëndimor. Kujdes: jo demokracia antike që ishte dhe ajo monolite. Është demokracia liberale ajo që është strukturuar mbi diversitetin. Jemi ne, jo grekët, që kemi zbuluar se si ndërtohet një rend politik përmes shumëllojshmërisë dhe dallimeve. Kush e zbuloi pluralizmin? Askush në veçanti. Meqë ideja lindi në kohën e Reformës, është e natyrshme që vështrimi të ngulitet te reformatorët dhe, sidomos, te sektet puritan.⁴³

Liberalizimi politik i rekomandon parimet e tij si një mënyrë e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve drejt në një shoqëri pluraliste; ajo nuk pret që qytetarët e lirë dhe të barabartë të pajtohen në një koncept gjithëpërfshirës. Në vend të kësaj, liberalizimi politik përcakton një konsensuz ndërthurës në mes të pluralizmit të arsyeshëm. Si vetë liberalizmi, liberalizmi politik është një tërësi konceptesh që qëllim të përbashkët kanë të gjejnë elemente të mirëfillta të bashkëpunimit shoqërorë midis anëtarëve të lirë dhe të barabartë të një shoqërie demokratike.⁴⁴

⁴² Bajrami. *Po aty*, f. 58.

⁴³ Latifi, V. *Teoritë e shkencave politike*. Academic Press, (Shkup, 2007, f. 154.)

⁴⁴ Latifi. *Po aty*, f. 154.

Një përkufizim që nisët nga pluraliteti dhe diversiteti i alternativave politike dhe qeverisë thotë: demokracia jeton nga mosmarrëveshjet, nga diskutimet për gjetjen e rrugës së vërtetë. Për këtë arsye pjesë përbërëse e saj është dhe respektimi mendimit të tjerëve. (Richard Von Weizsacker).⁴⁵

Idetë e Weberit dhe Schumpeterit ndikuan fuqimisht tek teoriticienët pluralistë të demokracisë moderne. *Teoritë pluraliste* u zhvilluan veçanërisht mbi bazën e studimeve të politikës amerikane, por konkluzionet e tyre – kur janë të vërteta – kanë zbatim të gjerë. Pluralistët pranojnë se qytetarët e veçantë mund të kenë pak ose aspak ndikim në marrjen e vendimeve politike. Por ata argumentojnë se prirjet drejt centralizimit të pushtetit në duart e zyrtarëve qeveritarë janë të kufizuara nga ekzistenca e grupeve me interesa të ndryshme. Grupet ose fraksionet me interesa konkurruese kanë rëndësi jetike për demokracinë sepse ato ndajnë pushtetin, duke ulur kështu ndikimin ekskluziv të një grupi ose klase të vetme.⁴⁶

Sipas pluralistëve, politikat qeveritare në demokraci ndikohen nga procese të vazhdueshme tratativash ndërmjet grupeve që përfaqësojnë interesa të ndryshme – organizata biznesi sindikata grupe ekonomike, organizata ambientaliste, grupe fetare e kështu me radhë. Një rend politik është demokratik kur ekziston balancë midis interesave konkurruese dhe të gjithë këto ndikojnë në politikë por pa sunduar mekanizmat aktuale të qeverisjes. Zgjedhjet gjithashtu ndikohen nga kjo situatë sepse që të arrihet një bazë mbështetëse e mjaftueshme për të pretenduar qeverisjen partitë duhet të jenë përgjegjëse ndaj grupeve me interesa të shumta të ndryshme. Argumentohet se SHBA është shoqëria më pluraliste industriale dhe për këtë edhe më demokratikja. Konkurrenca ndërmjet grupeve me interesa të ndryshme shfaqet jo vetëm në nivel kombëtarë por edhe brenda shteteve dhe në politikën e komuniteteve lokale.⁴⁷

Demokracitë konsiderohen pak a shume pluraliste. Një demokraci pluraliste karakterizohet nga shumëllojshmëria e partive, mediave dhe organizatave të lira (të pavarura). Në këtë mënyrë nga individit shpërthejnë lirisht pikëpamje, interesa vlera dhe në këtë mënyrë i jepet mundësia për tu dëgjuar nga sistemi politik.

⁴⁵ Buñi. *Po aty*, f. 71.

⁴⁶ Giddens, A. *Sociologjia*. Çabej, (Tiranë, 1997, f. 322).

⁴⁷ Giddens. *Po aty*, f. 322.

Partitë, mediat dhe organizatat e shumta e kundërshtojnë përqendrimin e madh të pushtetit në qeveri. Shkeljet dhe shpërdorimet zbulohen më kollaj kur ka shumë ruajtës nëpër këmbë dhe ata kanë liri veprimi.⁴⁸

Funksionimi i sistemeve pluraliste partiake është një ndër karakteristikat e demokracisë bashkëkohore politike. Partitë politike janë institucioni më i kritikuar politik në historikun e politikologjisë. Historiani romak Tit Livij në kohën e tij shkruan në mënyrë profetike: “beteja mes partive është dhe do të jetë një mjerim shumë më i madh për popullin se sa lufta, uria, epidemitë apo çdo katastrofë tjetër njerëzore”.

Udhëheqja demokratike bazohet në parimin e shumicës, por ky parim duhet të jetë në varshmëri me marrëdhënien e drejtë me pakicën. Sipas Arthur Schlesinger-it autor i librit “1000 ditë të Xhon Kenedi-së në shtëpinë e Bardhë” opozita është esenca e demokracisë.⁴⁹

Demokracia plurale mund të kuptohet edhe si poliarki në të cilën grupe të ndryshme në një proces të hapur kanë konkurrencë për pjesëmarrje në pushtet dhe në treg. Ky proces udhëhiqet nga ana e popullit në atë mënyrë që zgjidhet mes ofertave të cilat i fiton. Në fushën politike sistemi shumëpartiak kujdeset për ofertën e alternativave. Zgjedhja në shtetin partiak në masë të madhe është orientuar kah ajo, cilat nga qeveritë e ardhshme do të fitojnë përparësi nga ana e zgjedhësve.

Zgjedhjet politike janë instrument kryesor për qeverisjen demokratike me demokraci përfaqësuese. Në shtetet partiake, votimi i votuesve nuk përmban vetëm dëshmi për besim politik për deputetët të cilët duhet të zgjidhen, por vendimi për program konkret politik dhe ekip qeveritar i cili duhet të emërtohet. Zgjedhjet kanë dhe komponentë „reale plebishitare” dhe „plebishitare personale”.⁵⁰

⁴⁸ Tranoy. *Po aty*, f. 21.

⁴⁹ Latifi, V. *Politikologji*. Academic Press, (Shkup, 2008, f. 490).

⁵⁰ Cipelius, C. *Teoria e përgjithshme për shtetin*. Ars Lamaniana, (Shkup, 2012, f. 154 - 163).

1.2 Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në shoqëritë e zhvilluara

Parë në prizmin historik dhe duke marrë për bazë qëndrimet e pjesës më të madhe të studiuesve të partive politike, është më se e qartë se demokracia dhe partitë politike nuk lindën në po të njëjtën periudhë kohore. Demokracinë si formë qeverisjeje e hasim fillimisht në polisët greke dhe Athinën e vjetër, ndërsa partitë politike në kuptimin e sotëm të fjalës u paraqitën në shekullin e XIX-të. Pra demokracia dhe partitë politike veprojnë të gërshetuara në kushtet e demokracisë përfaqësuese.⁵¹

Demokracia të gjitha grupeve të mundura dhe shoqata të cilat shpejtojnë kah ndikimi politik ose social, ju jep mundësi për të krijuar dhe për tu futur në konkurrencë të ndërsjellë për fuqi dhe ndikim. Këtë mundësi për fitim, ndikim dhe pushtet në shtet nuk e kanë vetëm partitë politike, të cilat në mënyrë legjitime tentojnë të kenë në duart e tyre organin më të lartë shtetërorë, pra parlamentin dhe qeverinë. Edhe shoqatat e punëdhënësve, sindikatave, kishave dhe bashkësive ideologjike fitojnë dhe e përdorin mundësinë për të përfituar mbështetës dhe të kenë ndikim mbi jetën ekonomike dhe sociale, si dhe mbi pushtetin shtetërorë. Mes interesave të kundërshtuara dhe qëndrimeve të përfaqësuara në shoqëri duhet të ekziston kompromis.⁵²

Ndryshimet në Evropën Komuniste

Ndodhitë e fund shekullit të kaluar paraqisnin një fenomen jo të qartë dhe jo aq të kuptueshëm si për elitat shkencore ashtu dhe për elitat politike të asaj kohe. Vërehej një dozë e madhe e frikës se mos vallë një formë jo demokratike do të zëvendësohet me një formë ende më të vrazhdë të qeverisjes me shtetet në fjalë. Edhe emrat më të mëdhenj të shkencës dhe teorisë në një farë mënyre ishin të befasuar nga dinamika intensiteti dhe revolucionariteti i ndodhive në Evropën qendrore dhe juglindore. Fransis Fukujama shprehej se shkatërrimi i komunizmit ndodhi në një formë plotësisht të paparashikuar.⁵³

⁵¹ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 183).

⁵² Cipelius, *Po aty*, f. 188.

⁵³ Kasapović, M. *Demokratska tranzicija i političke stranke*. (Vol. 34 No. 5, 1997, f. 1).

Më shkurt e thënë shkatërrimi i komunizmit rrënjësisht ndryshoi modelet e deriatëhershme të interpretimit të politikës dhe zhvillimit të sistemeve shoqërore-politike duke parashtruar nevojën e gjetjes të qasjeve të reja dhe modeleve të reja analitike. Kështu që, në përgjithësi politikologët, filozofët dhe sociologët dakordohen se gjatë hulumtimit të proceseve shoqërore dhe politike në Evropën lindore në fund të viteve të tetëdhjeta dhe fillim të viteve të nëntëdhjeta mund të dallohen dy qasje të ndryshme kronologjike metodologjike dhe dy forma të interpretimit, të ashtuquajtura teoritë e “revolucionit demokratik” dhe teoritë e “tranzicionit demokratik”.⁵⁴

Vlen të potencohet se ndryshimet që e kapluan Evropën Komuniste nuk patën intensitet dhe dinamikë të njëjtë tek të gjitha shtetet, por idetë revolucionare zhvilloheshin në mënyrë zinxhirore duke provokuar dhe konflikte serioze në mes forcave konservatore që detyrimisht angazhoheshin për status quo dhe forcave për ndryshime që dita në ditë bëheshin më të organizuara dhe më kuptimplotë.

Ajo që mbetet përfundimisht e saktë dhe e pakontestueshme dhe që vlen të potencojmë në veçanti është fakti se dhjetëvjeçari i parafundit i shekullit të 20 - të e shënoi fundin e luftës së ftohtë që e rrezikonte paqen botërore dhe i afirmoi dhe institucionalizoi vlerat e demokracisë liberale që deri atëherë ishin një praktikë e avancuar vetëm e shteteve të Evropës perëndimore. Në këtë dhjetëvjeçar përfundimisht u vërtetua se ideologjia Marksiste ngërthente në vete kundërthënie të cilat në një moment ishte vështirë të kapërcehen. Vetë praktika e ish shteteve socialiste decenie me radhë dëshmoi se qëndrimi mohues i Marksit ndaj demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut nuk kishte baza reale dhe se pa këto dy vlera të cilat në të gjitha aspektet mund të trajtohen si fundamentale është i pamundur zhvillimi dhe perspektiva e shteteve moderne bashkëkohore.⁵⁵

Shikuar nga aspekti kronologjik në pranverë dhe vjeshtë të vitit 1989 popujt e Hungarisë, Polonisë, Gjermanisë Lindore, Çekosllovakisë dhe Bullgarisë pa luftë nëpërmjet rrugës paqësore bënë ndryshime rrënjësore të sistemeve të tyre politike. Ata u përcaktuan për pluralizëm politik dhe partiak, demokratizim të mirëfilltë dhe ekonominë e tregut si mundësi e vetme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të mëtutjeshëm.

⁵⁴ Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, 2004, f. 11).

⁵⁵ Aziri. *Po aty*, f. 11.

E gjithë kjo do të kishte qenë vështirë e realizueshme pa ndodhitë në ish BRSS që solli edhe deri te bashkimi i dy Gjermanive dhe shpartallimi i paktit të Varshavës. Në përgjithësi shikuar ndodhitë si në BRSS ashtu dhe në vendet e tjera që kultivonin ideologjinë Marksiste si ideologji dominonte dhe të vetme ishin rezultat i një krize të gjatë dhe të thellë ekonomike politike kulturore etj.

Megjithatë patjetër duhet theksuar se shkatërrimi i rendit socialist në Evropë ishte një proces mjaftë i ndërlikuar i përcjellur edhe me konflikte dhe me plotë viktima. Lëvizjet revolucionare të vitit 1989 ashtu siç potencon me të drejtë Etem Aziri e përfshijnë hapësirën gjeografike prej Baltikut e deri në Gadishullin Ballkanik. Këtyre ndryshimeve për fat të keq u paraprijnë ndodhitë e përgjakshme në Rumani.⁵⁶

Stiven Bouers shkaqet e revolucionit në fund të viteve '80 i sublimoi në tre-katër pika:

E para, pamundësia e garniturave udhëheqëse të gjejnë zgjidhje të mundshme për krizën më të re shoqërore dhe ekonomiko politike që i kishte përfshirë shtetet socialiste.

E dyta, mos suksesi i regjimeve të ish shteteve komuniste në Evropën Qendrore të krijojnë gjendjen e legjitimitetit.

E treta, forma represive e qeverisjes.

E katërta, kriza shumë e rëndë ekonomike që solli deri në atë që qytetarët e këtyre shteteve një periudhë më të gjatë kohore të ballafaqohen edhe me mungesën e artikujve ushqimorë dhe artikujve të tjerë të nevojshëm për jetën e përditshme.⁵⁷

⁵⁶ Shih: Aziri, f.12/21.

⁵⁷ Stiven Boueres, *Револуцијаво Источна Европа*, Programi i tretë i Rdios së Maqedonisë,(nr 47-48, f.53-54).

1.3. Zhvillimi i demokracisë dhe pluralizmi në vendet në tranzicion një vështrim kronologjik i pluralizmit politik në Republikën e Maqedonisë

Mungesa e përvojës demokratike ishte tipari dhe sfida kryesore për klasën e re politike shqiptare të viteve të 90, e cila paraqitej tërësisht e ndarë në synimet, konceptet, vizionin dhe mentalitetin e saj ndaj politikës si profesion dhe përgjegjësi. Pjesa më e madhe e atyre politikanëve që u inauguruan në vitet e para të demokracisë në partitë e opozitës, ishin idealist në vizionin e tyre për të ndryshuar gjendjen në funksion të një të ardhmeje më të mirë. Ata mëshironin në vetvete kontradiktën më të madhe etike dhe kulturore të kohës: shumica e tyre vinin nga qarqet akademike, nuk kishin përvojë politike dhe rrezatonin diferencë të madhe mes ideve të tyre teorike dhe shansëve për realizim partiak.⁵⁸

Lindja e pluralizmit partiak në ish-RSFJ

Kur bisedohet për ish-RSFJ-në patjetër të konstatohet se në fazën më të hershme të zhvillimit të saj, më ekmakt thënë deri në krizën informbiro (1948) ishte lejuar një lloj pluralizmi partiak, në fakt ishte i lejuar veprimi i disa partive politike të cilët gjatë luftës së dytë botërore nuk kishin bashkëpunuar me okupatorët.

Në këtë rast në veçanti duhet nënvizuar se zëvendësimi i sistemit njëpartiak me atë shumëpartiak në ish-RSFJ ishte rrjedhojë e një krize permanente që e ndiqte Jugosllavinë Socialiste prej themelimit të saj dhe deri në shkatërrimin definitiv që teoritikisht dhe praktikisht përfundoi me krijimin e Kosovës si shtet të mëvetësishëm. Në principe dhe pse kriza ishte gjithëpërfshirëse duhet përsëri veçuar dy segmente që e determinonin krizën, aspektin politik të krizës Jugosllave dhe aspektin ekonomik të saj.

Kriza ekonomike manifestoi me ngecje në aspektin e zhvillimit teknik teknologjik, inflacion të vazhdueshëm dhe rritje permanente të papunësisë. Një zgjedhje të mirëfilltë për tejkalimin e krizës së rëndë ekonomike në vend nuk ofroi as ekipi i Sergej Krajgherit me programin e quajtur “program afatgjatë i stabilizimit ekonomik”.⁵⁹

Programi në fjalë nuk i dha rezultatet e pritura kështu që në vitin 1989 inflacioni arriti deri në 2000% si rrjedhojë e saj ndodhi edhe rrënia e qeverisë së Branko Mikuliqit që

⁵⁸ Pango, Y. *Pakti i Stabilitetit*. ISHSN, (Tiranë, 2000).

⁵⁹ Billanxhiq, D. *Kthesat historike në zhvillimin e Jugosllavisë*. (Prishtinë, 1987, f. 84).

në rrethanat e atëhershme nënkuptonte një krizë të madhe të sistemit dhe fillimin e mbarimit të ekonomisë së planifikuar, gjendjen ekonomike edhe përpos ambicieve të shprehura nuk ia doli ta stabilizonte as premieri i fundit i Jugosllavisë Ante Marković.

Sa i përket krizës politike mund të ndahet në dy periudha kohore, kriza politike gjatë qeverisjes së Josip Broz Titos dhe kriza politike pas vdekjes së tij. Sa i takon periudhës së parë duhet pasur parasysh rastet në vijim: rasti i Millovan Gjillasit, krizën e ndërlidhur me Aleksandër Rankovićin, demonstratat studentore, lëvizjen masive në Kroaci, letrën e Titos dhe pastrimin e llogarive me liberalët serb, boshnjak dhe maqedonas dhe të ashtuquajturën aferë me rrugët.

Pas vdekjes së Titos në hapësirën jugosllave u ngjallën nacionalizma si rrymë e kohës. Në pranverë të vitit 1981 shpërthyen demonstratat studentore në Kosovë që në fakt paraqisnin fillimin e mbarimit të RSFJ-së; këto demonstrata nuk ishin të drejtuara kundër asnjë populli në Jugosllavi por në frymën e kushtetutës të vitit 1974 insistonin në avancimin e statusit politiko-juridik të Kosovës, që në fakt nënkuptonte barazi reale e jo fiktive të Kosovës brenda kornizave të shtetit ekzistues. Duhet bërë qartë e ditur se demonstratat e studentëve kosovarë dhe gjithë ajo që ndodhte me Kosovën dhe rreth saj nuk ishte shkak i provokimit të krizës politike pas vdekjes së Titos por pasojë e saj.

Për këtë periudhë është me rëndësi të përmendet kongresi i 14-të i jashtëzakonshëm i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, nga shkakut se ky kongres shënoi eliminimin e dominancës së LKJ-së dhe paralajmërimin e mundësive për një zhvillim më ndryshe të shtetit.⁶⁰

Si rezultat i krizës shoqërore politike në gjysmën e dytë të viteve të 80-ta avash avash filloi të lançohet ideja e pluralizmit politik ndryshe nga ajo që nënkuptonte socializmi vetëqeverisës deri në atë kohë, fillimisht ideja nuk ishte qartë e përkufizuar sepse një gjë të atillë e pamundësonte LKJ dhe pozita monopoliste e saj.

Në kuptimin e kësaj që u potencua fillimisht u paraqitën partitë opozitare në Republikat veriore Slloveni dhe Kroaci, e më pastaj vala e pluralizmit politiko-partiak e përfshiu tërë territorin e ish RSFJ-së.⁶¹

⁶⁰ Më gjerësisht shih: Aziri, f. 54-60.

⁶¹ Aziri. *Po aty*, f. 54-60.

Pluralizmi politik dhe pozita e shqiptarëve të RM-së deri në konfliktin vitit 2001

Shkapërderdhja e RSFJ-së solli shumë risi në jetën politike të popujve që jetonin në kufijtë e atij shteti multietnik, multifetar dhe multikulturor, por jo edhe për shqiptarët të cilët edhe për nga numri ishin popull i tretë pas serbëve dhe kroatëve. Në fakt e vetmja risi për to ishte ndarja e shqiptarëve nëpër shtetet e posa formuara me shumicë sllave.

Një pjesë e shqiptarëve mbetën në kufijtë e Serbisë, një pjesë në kufijtë e Malit të Zi dhe pjesa e tretë në kufijtë e Maqedonisë.⁶²

Shpallja dhe miratimi i Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 krijuan pritje shumë të larta të qytetarëve në aspektin e ndryshimeve sistematike, pluralizmin politik dhe demokratizimin, ekonominë e tregut dhe ekonominë personale, të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, ndërtimin e shtetit juridik dhe social. Si dhe në shumë vende të tjera në tranzicion kjo u reflektua në politizimin e lartë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë në periudhën fillestare zhvillimore, në aspektin e ngritjes së vetëdijes për rolin e qytetarëve në politikë, udhëheqjen dhe pushtetin në komunitet, si edhe në aspektin e kërkesave për ndryshime të shpejta në zhvillim, të pozitës sociale, standardit të jetesës. Megjithatë u tregua gjithashtu se një pjesë e këtyre pritjeve ishin joreale për shkak të bazës së ulët fillestare të zhvillimit të tranzicional si dhe rrethanave dramatike të brendshme dhe ndërkombëtare, në të cilat lëvizte zhvillimi postsocialist.⁶³

Maqedonia e cila fitoi pavarësinë pa luftë dhe pa konflikte nuk tregoi (së paku në fillim) një gatishmëri dhe sinjeritet për ndërtimin e një shteti qytetarë që do ta respektonte multietnicitetin, multikonfesionalitetin dhe multikulturalizmin. Ndonëse pas formimit të partive opozitare të qytetarët e rëndomtë krijuan pritje të larta, kjo nuk ndodhi. Elita politike, si ajo e vjetra ashtu edhe në formimin e sipër, demokracinë, lirinë dhe barazinë do ta interpretojnë dhe keqinterpretojnë, do ta ç'vlerësojnë dhe do ta dhunojnë, të vetëdijshëm se një ditë më herët ose më vonë veprimet e tilla mund të sjellin deri te eskalimi dhe konfliktet e hapura ndëretnike në vend.⁶⁴

Ç'është e vërteta kundërthëniet që shiheshin shumë qartë prej fillimit ishin të llojllojshme dhe shumëdimensionale. Këtë para se gjithash e pasqyronte kthjelltë gama e

⁶² Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2004).

⁶³ Mircev, D. *Ndërmarrjet Participizim dhe Elitizim*. (Universiteti Fon) f. 52. "Instituti për demokraci dhe Zhvillim", Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja Politike në Maqedoni, (Skena Politike e Maqedonisë 1990-2010)

⁶⁴ Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2004)

partive politike dhe ideologjitë e tyre. Në qoftë se gjithë asaj i shtohet edhe mungesa e kulturës demokratike, situata bëhet edhe më e qartë. Kundërthënie më të shprehura vëreheshin ndërmjet ideologjisë tani më të demoduar të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë dhe partive tjera që paraqitnin një vazhdimësi të sistemit monist e partive të posa formuara dhe pa profilizuara ashtu siç duket nga ana tjetër. Kësaj gjithsesi duhet shtuar edhe kundërthëniet ndërmjet partive politike të bllokut maqedonas dhe partive politike të shqiptarëve që nuk ishte asgjë tjetër veçse një formë tjetër e sofistikuar e kundërthënieve ndërnacionale.

Shteti nuk ishte i përgatitur për sfidat e reja. Vlerat nga e kaluara e kishin humbur kuptimin, kurse vlerat e reja ndërtoheshin shumë ngadalë. Qysh në fazat më të hershme erdhi në shprehje etnocentrizmi i tepruar maqedonas. Shumica e elitës maqedonase nuk e kuptonin si vlerë shoqërore, por si vlerë nacionale. Këtë e dëshmojnë tendencat shumë të fuqishme që si qëllim e kishin moslejimin e formimit të partive politike të etniteteve të tjera.⁶⁵

Megjithatë forcat intelektuale dhe politike shqiptare ishin deri në fund këmbëngulëse në atë se partitë e popullatës jo sllave e në veçanti të shqiptarëve jo se do ta pengojnë zhvillimin demokratik të Maqedonisë, por përkundrazi ato do të jenë një ndihmesë për demokratizimin e shoqërisë maqedonase në përgjithësi. Shqiptarët e Maqedonisë organizimin partiak e kuptuan si luftë të ideve dhe programeve që nënkuptonin afirmimin e të veçantës në të mirë të përgjithshmes. Për fat të keq shumica e elitës maqedonase nuk ka pasur qëndrim korrekt ndaj pluralizmit dhe demokratizimit të vendit.

Një dekadë të tërë maqedonasit dhe shqiptarët u munduan brenda dhe jashtë bashkësive të tyre ta bindnin njëri-tjetrin se cila prej dy bashkësive etnike më të mëdha ka të drejtë. E gjithë kjo nënkuptonte harxhim të kotë të energjisë, lodhje, mosbesim dhe gjendje pasigurie. Maqedonia duhej ta paguante haraçin ose ndryshe thënë çmimin e mos krijimit të kushteve për një integrim të mirëfilltë të shqiptarëve në shoqërinë maqedonase gjatë kohës së monizmit. Partitë politike Maqedonase dëshironin qysh në fillim qartë tua vënë me dije shqiptarëve se ky shtet thirret Maqedoni, se shqiptarët edhe më tutje do të

⁶⁵ Aziri, E. *Shpirti i konsensusit dhe integrimi në një shoqëri multietnike*. Ndarja e pushtetit dhe zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Friedrich-Ebert-Stiftung, (Shkup, 2008, f. 53).

jenë të huaj në trojet e veta etnike dhe se të drejt e tyre edhe më tutje do të varen nga dëshira dhe vullneti i partive politike maqedonase dhe populli maqedonas.⁶⁶

Nga ana tjetër partitë politike shqiptare bënë të qartë se në të ardhmen nuk do të lejojnë që shqiptarët të mbeten “qiraxhi në shtëpitë e tyre”.⁶⁷ Nisur nga kjo që u tha, nuk është e vështirë të konkludohet se dhjetëvjeçari i parë i jetës plurale në Maqedoni cilësohet me tendencën e dominimit dhe pozicionimit.

Për fat të keq shpejt pas zgjedhjeve të para pluraliste u formuan raporte disfunktionale në rrafshin politik që nënkuptonin tendencën institucionale dhe jointitucionale të dominimit nga pala maqedonase dhe tendencën e pozicionimit partiak (por jo dhe nacional) të shqiptarëve që në prapavijë do të lind forca jolegale dhe jolegjitime të cilat me një intensitet të fuqishëm dolën në sipërfaqe në vitin e fundit të shekullit të kaluar. Si një alternativë e fuqishme e organizimit politik legal të shqiptarëve. Fatkeqësisht, realiteti ka treguar që filozofia e të menduarit në Maqedoni ndryshon tepër ngadalë.

Edhe më tutje ndërtohen raporte të dominimit nacional maqedonas dhe pozicionimit partiak shqiptar që lë hapësirë në një të ardhme më të afërt e të largët të përsëritet historia.⁶⁸

Ecuria e zhvillimit të pluralizmit politik në Maqedoni në periudhën para konfliktet të vitit 2001 i ngërthente në vete karakteristikat vijuese:

Lufta politike në mes “shumicës së vogël” dhe “pakicës së madhe”. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2002, Maqedonia është shtet me popullatë të ndryshme. Regjistrimi tregon që në Maqedoni jetojnë: 1.297.981 maqedonas, 509.083 shqiptarë, 77.959 turq, 53.879 romë, 9.695 vlleh, 35.939 serbë dhe 17.018 boshnjak.⁶⁹

Mosrespektimi ekstrem për të drejtat legjitime të popullatës shqiptare në Maqedoni (Pas Pavarësisë së Maqedonisë, popullata shqiptare nuk ka pasur të drejtë për arsim në gjuhën amtare dhe numri i shqiptarëve në institucionet shtetërore është simbolik, veçanërisht në polici dhe ushtri).

⁶⁶ Aziri. *Po aty*.

⁶⁷ Aziri. *Po aty*, f. 53.

⁶⁸ Aziri, E. *Shpirti i konsensusit dhe integrimi në një shoqëri multietnike*. Ndarja e pushtetit dhe zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Friedrich-Ebert-Stiftung, (Shkup, 2008, f. 53).

⁶⁹ Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, 2004)

Diskriminim institucional i popullatës shqiptare. Ngjarjet tragjike ku si rezultat i dhunës shtetërore do të humbin jetën dhjetra qytetarë me prejardhje etnike shqiptare etj. (Në ngjarjet e Bit Pazarit, Reçicës, Ladorishtit dhe Gostivarit kanë humbur jetën dhjetëra shqiptarë me prejardhje etnike shqiptarë, kurse disa qindra janë torturuar nga policia maqedonase).

Momentet të lartpërmendura ishin shkak dhe nxitës kryesorë të konfliktit të armatosur të vitit 2001 që përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.⁷⁰

Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni

Lindja e partive të para shqiptare në Maqedoni ndodhi në rrethana shumë të ndërlikuara ekonomike dhe politiko-shoqërore. Gjithsesi nuk duhet harruar edhe periudhën kohore prej demonstratave të studentëve kosovarë e deri në paraqitjen e pluralizmit partiak.

Në këtë periudhë kohore dhjetëvjeçare u bë diskriminimi më i ashpër institucional kundër shqiptarëve që u manifestua përmes diferencimeve ideo-politike, burgosjeve dhe torturave të llojllojshme. Paraqitja e partive politike tek shqiptarët nuk guxon të trajtohet si një çështje teknike, thjeshtë vetëm si rezultat i ndryshimeve në ish Federatën Jugosllave. Ajo që vlen të veçohet është fakti se shqiptarët organizimin politiko-partiak për dallim nga maqedonasit e kuptuan si luftë të ideve dhe programeve që nënkuptonte afirmimin e të veçantës në të mirë të përgjithshmes. Megjithatë lindjet e pluralizmit shqiptarë në të gjitha aspektet ishin më të mundimshme se sa te të tjerët, ata ballafaqoheshin me konservatorizmin maqedonas si në kuptimin e shtetit ashtu edhe në kuptimin e kombit. Elita politike maqedonase e ngushtuar nga rrethanat e krijuara në fillim mundoheshin shqiptarëve tua imponojnë një organizim politik të dozuar, të kontrolluar edhe nga brenda edhe nga jashtë nga vetë maqedonasit.⁷¹

Me kalimin e kohës siç duket zbuluan metoda shumë të sofistikuar të cilat sollën deri aty që partitë shqiptare vetë tua japin kontrollin e plotë elitave politike maqedonase si

⁷⁰ Aziri, E. *Shpirti i konsensusit dhe integrimi në një shoqëri multietnike*. Ndarja e pushtetit dhe zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Friedrich-Ebert-Stiftung, (Shkup, 2008, f. 53).

⁷¹ Më gjërësisht shih: Aziri. f. 66-82.

kundërvlerë e kolltuqeve ministrorë dhe privilegjeve tjera që ka mundësi që ti ofrojë vetëm shteti dhe pushteti.

Dy partitë e para politike që i shprehnin interesat e popullatës shqiptare në Maqedoni ishin Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partia Demokratike Popullore (PDP). PPD u formua më 15 prill 1990 dhe për një kohë të shkurtër depërtoi në të gjitha poret e shoqërisë shqiptare në Maqedoni dhe diasporë. Në atë periudhë mbisundonte ideja se një parti politike është e mjaftueshme për shprehjen e interesave të shqiptarëve në Maqedoni, pra vlente maksima dy parti politike janë shumë ndërsa një e mjaftueshme. Megjithatë pas dy muajve mjedisi plural shqiptarëve në Maqedoni e përqafoi edhe partinë e dytë PDP-në, kjo parti u themelua me 23 qershor të vitit 1990. Në lidhje me formimin e PDP-së qarkullojnë shumë thashetheme të cilat vështir mund të verifikohen sepse përmbajnë në vete një dozë të madhe të subjektivizmit.⁷²

Disa thonë se PDP u formua nga individ që nuk e gjetën veten në PPD, disa të tjerë pohojnë se PDP-ja u formua nga shërbimet e shtetit që të shkaktohet një përçarje brenda shqiptarëve, të tretët pohojnë se partia u formua si alternativë në qoftë se pushteti do të ndërpriste aktivitetet e PPD-së.

Si do qoftë paraqitja e PDP-së e ndryshoi filozofinë e të rezonuarit politik tek shqiptarët e Maqedonisë. Maksima paraprake do të zëvendësohet me një të re që do të eksploatohet sidomos në qarqet intelektuale sipas së cilës për shqiptarët e Maqedonisë një parti politike është pak ndërsa tri parti politike janë shumë. Maksima dy parti jenë të mjaftueshme, kjo maksimë riaktualizohet kohëve të fundit nga lideri i partisë politike aktualisht më të madhe të shqiptarët.⁷³

Edhe përpos frikës nga paraqitja apo parcializimi i ambientit politik, status *quo*-ja nuk mundi të ruhej. Së shpejti ndodhi përçarja e Partisë për Prosperitet Demokratik si pasojë e secilës lindi Partia Popullore Demokratike, që tubonte pjesën më “ekstreme” të anëtarësisë së PPD-së e njohur me emra të llojllojshëm si “krahu atdhetar”, “krahu i fortë”, “thaçistët” etj. Këtë parti e udhëhoqi deri në formimin e Partisë Demokratike Shqiptare Arbën Xhaferi një personalitet mjaftë karizmatik për rrethanat shqiptare dhe ballkanike.⁷⁴

⁷² Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, 2004, f. 54-60).

⁷³ Aziri. *Po aty*, f. 54, 60.

⁷⁴ Aziri, E. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. LogosA, (Shkup, 2004, f. 54-60).

Pas zgjedhjeve të dyta vendore dhe dështimit të plotë të PDP-së çuditërisht ndodhi bashkimi i PPDSH-së dhe PDP-së dhe u formua partia e re e njohur për opinionin publik këtu dhe më gjerë si Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Edhe sot e kësaj dite është e vështirë që me kompetencë të sqarohet ky fuzionim edhe pse nga ajo që është thënë me rastin e bashkimit dhe që është shkruar mund të supozohet se këtë bashkim e ka nxitur çështja kombëtare, ideologjia nacionaliste. Një fakt sociologjik është se bashkimi real nuk u realizua: fuzionimi shpirtërorë i populloristëve dhe thaçistëve kurrë nuk ndodhi, nga ai bashkim nga radhët e Partisë Demokratike Popullore politikisht përfituan tre persona, kryetari nënkryetari dhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike Popullore të cilët po mos të ndodhte bashkimi aty për aty do të harroheshin.

Me formimin e Partisë Demokratike Shqiptare u rrumbullakësua procesi i pluralizmit partiak të shqiptarëve të Maqedonisë ose më mirë thënë, u përmbyll faza e parë e organizimit partiak të shqiptarëve të Maqedonisë.

Fillimin e mileniumit të tretë, për shqiptarët e Maqedonisë karakterizohet nga formimi i një subjekti të ri, Bashkimit Demokratik për Integrim, një parti hibride e formuar nga një pjesë e ish-ushtarëve të UÇK-së dhe strukturave të njërit variant të PPD-së të cilat kishin dhe kanë shkathtësi të veçantë që t'iu bashkëngjiten partive politike të cilat vijnë në pushtet. Kjo parti prej vitit 2002 e këndeje është partia dominante e shqiptarëve me një koherencë të theksuar të brendshme dhe një lider që veçohet me karizmë populiste.

Kalimthi të përmendim edhe dy partitë tjera me pak mëshomë relevante Levizjen Besa e cila pa mos e arritur rininë e vet të pjekurisë e përjetoi përçarjen dhe Aleancën për Shqiptarë një fraksion i dalur nga PDSH-ja.⁷⁵

⁷⁵ Emurlai, E. *Fillet e pluralizmit në Ish Shtetet Socialiste të Europës – Rasti i Maqedonisë*. Përmbledhje kumtesash të konferencës së katërt shkencore të FShSHB, *Fillet e pluralizmit Politik në Maqedoni dhe Post – Komunizmi*. SEEU, (Shkup, 2019, f. 212).

Kapitulli II : Zgjedhjet si komponentë e rëndësishme në demokratizimin e shoqërive bashkëkohore

1. Kuptimi i zgjedhjeve
2. Qasja teoriko-shkencore mbi zgjedhjet
3. Zhvillimi historik i zgjedhjeve
4. Llojet e zgjedhjeve
5. Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar
6. Zgjedhjet në demokracitë e vendeve në tranzicion

2. Kuptimi i zgjedhjeve

Abraham Linkoln ish Presidenti Amerikan ka thënë: “Detyra numër një e një qeverie është të krijojë shanset e barabarta që të gjithë qytetarët që mendojnë kundër saj, ta shprehin lirshëm vullnetin e tyre”.⁷⁶

Nuk di ndonjë shoqëri që të jetë e interesuar të ketë sundim të më të këqinjve. Kështu dallimi i demokracisë qëndron në parimin se askush nuk mund të shpallë vetën si “më të mirë” se kushdo tjetër; këtë duhet ta vendosin të tjerët. Pra duhet të jenë të tjerët ata që do ta veshin me pushtet, dhe metoda e përcaktimit të atyre që janë “më të vlerësuar” është pikërisht metoda e zgjedhjes së tyre, instrumenti elektoral. “Me zgjedh”, që vjen nga *eligere* shpreh idenë e një zgjedhje jo të rastit por duke përzgjedhur.⁷⁷ Pra, zgjedhjet janë konceptuar si një instrument përzgjedhjeje në kuptimin cilësor të këtij termi. Xon Stjuart Mill ende dëshmon faktin se, në fillim, edhe në demokracitë tona zgjedhjet ishin krijuar si një instrument sasior që duhej të bënte një përzgjedhje cilësore, sepse qëllimi i veprës së tij politike kryesore është pikërisht të hartojë një sistem qeverisjeje përfaqësuese në të cilin parlamenti do të kishte “ajkën e vendit”⁷⁸

Në shoqëritë bashkëkohore zgjedhjet dhe sistemi zgjedhorë luajnë rol mjaft të rëndësishëm në formimin e pushtetit shtetëror si dhe në jetën politike në përgjithësi. Zgjedhjet janë institucion i vjetër dhe në forma të caktuara hasen qysh në Greqinë Antike, por zgjedhjet demokratike paraqiten shumë më vonë. Ato korrespondojnë me demokracinë përfaqësuese qytetare dhe me postulatet e saj kryesore: zgjerimin e të drejtës së votës dhe zhvillimin e parlamentarizmit. Zgjedhjet paraqesin njërën nga format më të rëndësishme të legjitimitetit të pushtetit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën politike, do të thotë nëpërmjet zgjedhjeve qytetarëve u jepet mundësia që në mënyrë të tërthortë nëpërmjet përfaqësuesve të vet, gjegjësisht nëpërmjet opsioneve politike që i përkrahin, në njëfarë mënyre të jenë pjesëmarrës në realizimin e pushtetit.⁷⁹ Zgjedhjet janë formë e të vendosurit dhe mënyrë e zgjedhjes së përfaqësuesve, bartësve të funksioneve politike dhe pushtetit politik. Ato nënkuptojnë vendosjen sipas një procedure të lirë të vendosur me ligj.

⁷⁶ Linkoln, *Presidentët amerikan*, Botimi shqip, (Tiranë, 1996)

⁷⁷ Sartori, G. *Ç’është demokracia*. Dituria, (Tiranë, 1998, f. 77).

⁷⁸ Sartori, G. *Edhe një herë për teorinë e demokracisë*. Dituria, (Tiranë, 2006, f. 178).

⁷⁹ Aziri, E. *Sociologjia e Partive Politik*. Arbëria Design, (Tetovë, 2004, f. 117, 118).

Ekzistojnë qasje të ndryshme ndaj teorive zgjedhore. Sipas insturmentalistëve, zgjedhjet janë mjet për marrjen e pushtetit, ndërsa sipas funksionalistëve, ato paraqesin mënyrë për arritjen e një marrëveshjeje, pajtueshmërie shoqërore ose si instrument për krijimin e një baraspeshe ndërmjet shoqërisë dhe shtetit.

Sipas M. Diverzhe, zgjedhjet kanë një rëndësi të veçantë për demokracinë, ngase ai demokracinë e kuptoi si “formë të qeverisjes që realizohet nëpërmjet zgjedhjeve të drejta dhe të lira”. Për Sartorin kuptimi i zgjedhjeve nuk qëndron në atë që “demokracinë ta bëjnë demokratike” por ta bëjnë të mundshme, gjegjësisht “të bëjnë përzgjedhjen e udhëheqjes dhe jo ta maksimizojnë demokracinë. Zgjedhjet mund të jenë demokratike dhe jo demokratike, kompetative dhe jo kompetative, të drejta dhe jo të drejta, direkte dhe indirekte, të shumicës, proporcionale dhe të përziera, presidenciale dhe parlamentare, vendore dhe të përgjithshme etj.⁸⁰

V. Goati duke analizuar rolin dhe rëndësinë e zgjedhjeve thotë se: ato janë mekanizëm për transformimin e llojeve të ndryshme të pushtetit shoqëror në pushtetin legjitim politik.

Zgjedhjet e lira dhe demokratike që legjitimojnë pushtetin politik, i nënshtrohen një procedure të paraparë me ligj. Normat ligjore e krijojnë sistemin zgjedhor që në të vërtetë nuk është asgjë tjetër përveç se pjesë e sistemit politik në kuptimin më të gjerë. Sistemi zgjedhor mund të përcaktohet si “përmbledhje normash dhe procedurash që aplikohen gjatë zgjedhjes së bartësve të funksioneve të caktuara të pushtetit politik”⁸¹. Në përgjithësi sistemi zgjedhor ka rëndësi të madhe për partitë politike si protagoniste kryesore në zgjedhjet elektorale, por njëherit ka rëndësi edhe për votuesit dhe politikanët si aspirues politikë. Shikuar nga ky aspekt, çdo herë ka tendenca që forca të caktuara shoqërore të mundohen sistemin zgjedhorë t’ua përshtatin nevojave të veta, domethënë të lihet hapësirë për manipulime në procesin zgjedhor. Ka mjaft të drejtë Sartori kur thotë se sistemi zgjedhor është “Instrument politik manipulues më konkret”. Prandaj është vështirë të flitet për sistem zgjedhor ideal. Sisteme të tilla nuk ekzistojnë askund në botë dhe me siguri nuk do të ekzistojnë edhe në të ardhmen.⁸²

⁸⁰ Aziri, E. *Sociologjia e Partive Politike*. Arbëria Design, (Tetovë, 2004, f. 117,118).

⁸¹ Shih: Aziri. *Po aty*, f.117, 118.

⁸² Aziri. *Po aty*, f. 117,118.

2.1 Sistemet zgjedhore

Zgjedhjet konsiderohen zemra e sistemit politik sepse nëpërmjet tyre qytetarët zgjedhin dhe kontrollojnë qeverinë e tyre. Zgjedhjet shihen pothuaj si demokracia në praktikë sepse materializojnë parimin e përfaqësimit. Zgjedhjet në vetvete mund të mos jenë një kusht i mjaftueshëm për përfaqësimin politik, por nuk ka dyshim se ato janë një kusht i domosdoshëm. Proçesi i zgjedhjeve realizohet nëpërmjet rregullave, të cilat janë mjaft të ndryshme dhe të shumëllojta. Nga mënyra se si kombinohen këto rregulla, kemi sistemet zgjedhore që dallojnë më shumë ose më pakë mes veti. Sistemi zgjedhor është i përbërë nga një tërësi rregullash që pranohen në një demokraci përfaqësuese për të transformuar preferencat e zgjedhësve në vota dhe votat në vende të parlamentit. Një sistem zgjedhor është i përbërë nga dy elementë kryesorë: sistemi i votimit dhe formulat zgjedhore. Formulat zgjedhore përbëjnë mekanizmin që transformon votat e dhëna nga trupi elektoral në vende të parlamentit. Dallohen përgjithësisht tre grupe të mëdha të sistemeve të votimit: *Mënyra e votimit mazhoritar*, *Mënyra e votimit proporcional* sidhe *Mënyra e votimeve të përziera*.⁸³

Arend Lajphart dy sistemet elementare zgjedhore i lidh me “ modelin e demokracisë së shumicës” dhe modelin e “ demokracisë konsesuale”. Sipas autorit në fjalë sistem zgjedhor tipik i i demokracisë së shumicës është “sistemi pluralist” ose i “shumicës”, ndërsa demokracia konsesuale identifikohet me “sistemin proporcional”. Dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy sistemeve zgjedhore sipas Lajphartit qëndron në ate se sistemi i shumicës zbaton parimin “ fituesi i merr të gjitha”. Pra kandidati që ka mbështetjen e numrit më të madh të votuesve zgjidhet, duke u transformuar në përfaqësues të votuesve të tij ndërsa votuesit e tjerë mbetën të pa përfaqësuar. Një sistem i tillë nuk u jep mundësi partive më të vogla të përfaqësohen në institucionin ligjvënës. Si rezultat i kësaj lindën sistemet proporcionale, si domosdoshmëri për të plotësuar dy dobësitë prej të cilëve vuante sistemi i shumicës. Së pari të sigurojnë vende në parlament dhe për partitë më të vogla dhe së dytë ti minimizoj shkuarjen dëm të votave të elektoratit.⁸⁴ Përveç kësaj në praktik përfshihet edhe kategoria e të ashtuquajturave sisteme të përziera, një kategori riziduale e cila përfshin fushëveprime

⁸³ Buçi, Y. *Tempulli i demokracisë*. Ombra gvg, (Tiranë, 2010, f. 183,184).

⁸⁴ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 426-428)

të shumë-llojshme. Një çështje tjetër që meriton vëmendje është shkalla e proporcionalitetit brenda vetë sistemeve proporcionale. Në qoftë se në një shtet ku aplikohen zgjedhjet proporcionale, territori i vendit ndahet në zona më të vogla elektorale, pa marrë parasysh nëse është marrë në konsideratë një numër i barabartë votuesish për çdo zonë elektorale të jetë i barabartë ka gjasa që të shfaqet fenomenin disproporcionalitetit ndërmjet votave të hedhura në kutitë votuese dhe mandateve të fituara. Në qoftë se mandatet ndahen në mënyrë proporcionale por mungon përfaqësimi i mirëfilltë proporcional, parashtrohet çështja e proporcionalitetit të sistemit proporcional. Pa dyshim kur janë në pyetje sistemet zgjedhore shumë gjëra mbeten të pa qarta, sidomos për personat që nuk janë të specializuar në këtë materie.⁸⁵

2.2 Qasja teoriko - shkencore mbi zgjedhjet

Në qoftë se ka një fushë në të cilën teoria e demokracisë ka dëshmi të forta dhe të shumta, kjo është fusha e opinionit publik dhe e sjelljes elektorale. ⁸⁶ Zgjedhjet janë parakusht i domosdoshëm që të përcaktohet një sistem si demokratik, por demokracia e vërtetë është diçka më tepër se aritmetika e thjeshtë zgjedhore. Në historinë e njerëzimit ka raste të diktatorëve dhe tiranëve të cilët janë zgjedhur në mënyrë tërësisht të rregullt nga elektorati, por në fakt kanë zbatuar sistem diktatorial e jo demokratik (p.sh. Hitleri në Gjermani, Fukimori në Peru, Aristidi në Haiti, etj.)⁸⁷ Nuk duhet harruar se diktatorët më të mëdhenj të shekullit XX, Hitleri, Musolini, Stalini, Millosheviqi, Sadam Huseini, Mubaraku etj, u zgjodhën me vota të lira të elektoratit. Kur faktori ndërkombëtarë kërkon nga këta president që ta demokratizojnë shoqërinë, përgjigja është identike: mos vallë dëshironi që në pushtet të vijnë ekstremistët?. Sistemi demokratik nuk mund të reduktohet vetëm në mënyrën e organizimit të zgjedhjeve. Demokracia, pa konceptin e shoqërisë së hapur pa sistemin e vlerave që garanton respektimin e të drejtave të njeriut, pa funksionimin e shtetit ligjor, pa transparencë në veprimin e institucioneve, pa respektimin e ndarjes së pushtetit në atë ekzekutiv ligjvënës dhe gjyqësor, pa respektimin e autonomisë së tyre, pa decentralizim të pushtetit, pa kontrollin intern të veprimtarisë së aparatit shtetërorë, pa

⁸⁵ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 426-428).

⁸⁶ Sartori, G. *Edhe një herë për teorinë e demokracisë*. Dituria, (Tiranë, 2006, f. 139).

⁸⁷ Latifi, V. *Politikologjia*. Academic Press, (Shkup, 2008, f. 490).

kontrollin civil të forcave të armatosura, pa pjekuri morale etj vështirë se mund të quhet e tillë.⁸⁸ Zgjedhje quhet dalja e njerëzve të moshës madhore në votime për të zgjedhur përfaqësuesit e vet politik dhe shtetëror. Zgjedhjet mund të jenë, siç po quhen edhe në shtypin tonë, të lira dhe demokratike, por mund të mos jenë as të lira, as demokratike. Në komunizëm janë mbajtur shpesh zgjedhje së paku krye çdo katër vjetësh, por ato nuk kanë qenë kurë zgjedhje as të lira, as demokratike. Popujt e kolonizuar popujt e pushtuar prej shteteve të huaja nuk mund të mbajnë zgjedhje që do të quheshin të lira dhe demokratike, sepse zgjedhjet e lira dhe demokratike nuk mund të mbahen nën pushtim. Sepse duke i quajtur të lira, deri sa gjendja jonë është në pushtim (rasti Kosovës nën pushtimin Serb), ne ia zëmë vetës gojën: pse ankohen ata që mund të mbajnë zgjedhje të lira, madje demokratike?! Për të pushtuarin liria dhe demokracia nuk janë njëmendësi, por synim.⁸⁹

Zgjedhjet kanë rëndësi të veçantë për çdo subjekt politik që merr pjesë në garat zgjedhore. Rezultatet zgjedhore i përcaktojnë pozicionet e partive politike ndaj shtetit. Nga ato varet a do të jetë partia në pozitë apo në opozitë ose në pozitë brenda një afati të caktuar kohor, i cili zakonisht nuk është më i gjatë se katër vjet. Zgjedhjet janë dukuri permanente dhe zakonisht për partitë politike mbarimi i njërit afat të zgjedhjeve paraqet fillim të zgjedhjeve të ardhshme. Partitë politike serioze çdoherë jetojnë nën “ethet zgjedhore”, aq më shumë nëse merret parasysht edhe dukuria e zgjedhjeve të parakohshme, që nuk është dukuri e panjohur për teorinë dhe praktikën e veprimit të partive politike.⁹⁰

Politikën e papërgjegjshme në shumë raste zgjedhësit e sanksionojnë në zgjedhjet e ardhshme. Garantimi i zgjedhjeve korrekte, të lira dhe demokratike është vlerë që shumë vështirë mund të realizohet me përpjekshmëri, sidomos në shoqëritë pa ndonjë traditë pluralo-partiake, ku zgjedhjet e marrin karakterin e luftës makiaveliste për pushtet. Ç’është e vërteta, keqpërdorimet zgjedhore nuk janë të pranishme vetëm në shtetet pa traditë demokratike, por për fat të keq dukuritë ngjashme hasim edhe në shtetet të cilat konsiderohen si pararojë e demokracisë botërore. Dallimi qëndron vetëm në mënyrat dhe metodat e keqpërdorimit të procesit zgjedhor, ndërsa pasojat janë të ngjashme apo përafërsisht të ngjashme.⁹¹

⁸⁸Xhaferi, A. *Kombi, Identiteti, Shteti*. Dugagjini. (Pejë, 2017, f.165).

⁸⁹Qosja, R. *Fjalor Demokartik*. Tonea. (Tiranë, 1997, f. 532).

⁹⁰Aziri, E, *Sociologjia e partive politike*. Arbëria Design, (Tetovë, 2004, f. 126)

⁹¹Aziri. *Po aty*.

2.3 Zhvillimi historik i zgjedhjeve

John Stuart Mill ishte një mendimtarë i rëndësishëm brenda liberalizmit politik në vitet 1800. Ai nënvizoi se pushteti duhet të jetë i shpërndarë dhe parlamenti i zgjedhur nga populli duhet të marrë një rol qendrorë në sistemin e qeverisjes. Ai thoshte se të gjithë, edhe gratë e punëtorët duhet të kenë të drejtë vote, por mendonte se ishte problematike mungesa e njohurive politike. Kjo do të zgjidhej, sipas tij, me propozimin që më të mësuarit të merrnin më shumë vota.⁹²

Shumica e shteteve njëkombëshe krijuan një sistem politik efektiv nëpërmjet veprimtarisë së monarkëve të cilët arritën të përqendrojnë gjithnjë e më shumë pushtetin në duart e tyre. Në shtetet sovraane shtetasit nuk gëzonin që në fillim të drejtat e pjesëmarrjes politike në të. Këto të drejta u arritën kryesisht nëpërmjet luftërave që kryesisht kufizonin pushtetin e monarkëve ose i përmbysën ata vazhdimisht – ndonjëherë me anën e procesit të revolucionit, si në rastin e Francës .

T. H. Marshall ka dalluar tre lloje të drejtash që shoqërojnë rritjen e qytetarisë (Marshall, 1973):⁹³ *Të drejtat civile* kanë të bëjnë me të drejtat ligjore të individëve. Lloji dytë i të drejtave qytetare ka të bëjë me të *drejtat politike*, si dhe lloji i tretë i të drejtave qytetare që përcakton Marshall janë *të drejtat sociale*.⁹⁴

Sa i përket llojit të dytë të të drejtave qytetare ka të bëjë me *të drejtat politike*, veçanërisht të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje dhe në funksione shtetërore. Megjithatë edhe këto të drejta nuk u fituan lehtë dhe shpejt. Arritja e të drejtës së plotë të votimit, madje edhe për të gjithë burrat, është relativisht e vonë, për të cilën është dashur luftë për të përballuar kundërshtimin e qeverive ndaj pranimi të parimit të së drejtës universale të votimit. Në shumicën e vendeve evropiane në fillim votimi ka qenë i kufizuar vetëm për qytetarët burra që zotëronin një pasuri të caktuar – gjë që në të vërtetë kufizonte nga e drejta e votimit një pakicë të ndjeshme. E drejta universale e votimit për burrat u arrit kryesisht në fillim të shekullit të kaluar. Grave iu desh të prisnin më gjatë. Në shumicën e vendeve perëndimore, votimi për gratë u arrit pjesërisht si rezultat i luftës së

⁹² Kal-Melbey-Tranoy, *Politika dhe demokracia*. Onufri, (Tiranë, 2006, f. 27).

⁹³ Giddens, A. *Sociologjia*. Çabej, (Tiranë, 1997, f. 301, 302).

⁹⁴ Giddens. *Po aty*, f. 302.

grave dhe pjesërisht si pasojë e angazhimit të grave në ekonominë zyrtare gjatë Luftës së Parë Botërore.

Ndërsa në Evropë po fitoheshin të drejtat politike dhe ligjore, në shumë pjesë të tjera të botës vazhdonte procesi i kolonializimit. Shumica e popullsisë i fitoi të drejtat politike dhe ligjore vetëm me zhdukjen e kolonializimit në shekullin e XX.⁹⁵ U desh edhe shumë kohë që të gjithë zyrtarët publik të bëheshin të zgjedhur, ndërsa të gjithë qytetarët zgjedhës. E drejta zgjedhore kudo ishte e mbyllur në disa kufi dhe nën varësinë e censit. Revolucioni i Amerikës shpërtheu. Dogma e sovranitetit të popullit doli nga komuna dhe e mori në dorë qeverisjen; të gjithë klasat iu nënshtruan asaj, njerëzit luftuan dhe ngadhënjyen në emrin e saj, ajo u bë ligj i ligjeve. Një ndryshim gati po aq i shpejtë u bë brenda shoqërisë, ligji i trashigimive së shpejti mposhti ndikimet lokale. Në momentin kur ky ndikim i ligjeve dhe i revolucionit zuri të binte në sy të gjithëve fitorja përfundimisht ia kishte mbajtur anën demokracisë. Pushteti ishte në të vërtetë në duart e saj. Madje as nuk ishte e lejuar më të luftohej kundër saj. Klasat e larta iu nënshtruan pa u ankuar. Për të votuar për ligjet më demokratike nxituan njerëzit, interesat e të cilëve ato ligje i dëmtonin më shumë. Në këtë mënyrë klasat e larta nuk i ngacmuan kundër vetes pasionet e popullit; ato vetë e përshpejtuan ngadhënjimin e rendit të ri. Kështu punë për tu habitur! Demokracia mori më shumë në shtetet ku arsitokracia i kishte rrënjët më të thella.

Shteti i Merilendit, të cilin e themeluan feudalët e mëdhenj, i pari shpalli të drejtën e votës për të gjithë, dhe përfshijë në tërë qeverisjen e vet format më demokratike.

Në Amerikë, parimi i sovranitetit të popullit nuk është i fshehur ose shterp, sikundër te disa popuj; ai njihet me doke, shpallet me ligje; ai përhapet lirshëm dhe arrin pa pengesa deri te rrjedhimet e tij të fundit. Në qoftë se është një vend i vetëm në botë ku mund të shpresohet se dogma e sovranitetit të popullit do të çmohet me vlerën e vetë të vërtetë, të studiohet se si zbatohet në çështjet shoqërore dhe të gjykohet për përparësitë dhe rreziqet e saj, ky vend është gjithsesi Amerika.⁹⁶ Në Angli parimi për zgjedhje të përgjithshme, prej vitit 1429 në principatat, të drejtën e votës e ka pasur vetëm ai i cili nga prona fiton të ardhura vjetore prej 40 shiling.

⁹⁵ Giddens, A. *Sociologjia*. Çabej, (Tiranë, 1997, f. 301, 302).

⁹⁶ Aleksis Dw Tokvild, *Mbi demokracinë në Amerikë*. Fryma, Dugagjini, (Pejë, 1998, f. 58).

E drejta zgjedhore ndërlidhej me kualifikime të ndryshme. Deri në fillim të reformave në të drejtën zgjedhore të cilat vendoseshin me ligjin e parë reformatore të vitit 1832, vetëm 5% nga popullata e mitur ka të drejtë vote. Parimi për zgjedhje të përgjithshme gradualisht realizohet me numër të madh të ligjeve reformatore, e drejta e pakufizuar zgjedhore së pari herë është vendosur në vitin 1928, ndërsa kualifikimi i fundit për gjendjen e pronës është larguar në vitin 1791 e cila e ka proklamuar të drejtën e të gjithë qytetarëve për bashkëpunim në krijimin e vullnetit të përgjithshëm. Deklarata për të drejta njerëzore dhe qytetare neni 6) parashikonte që tatimet ti paguajnë në shumë të caktuar dhe i përjashtonte shërbëtorët nga e drejta zgjedhore. Kushtetuta radikale demokratike nga viti 1793 i caktoi këto kufizime por nga shtetësia aktive vazhdimisht i përjashtonte gratë, neni 4, 23). Prej vitit 1848, e drejta e përgjithshme zgjedhore vlente për të gjithë qytetarët nga gjinia mashkullore të cilët janë më të vjetër se 21 vjeç. Gratë për herë të parë fituan të drejtën zgjedhore në vitin 1945.⁹⁷

Në SHBA nga fillimi kishte kualifikime për pronësi struktura e të cilës hierarki ishte e caktuar me 24 amandamente në vitin 1964, kufizimeve racore ishin drejtuar 15 amandamente deri në vitin 1870, përjashtimi i grave nga e drejta e votës u ndalua me 19 amandamente në vitin 1920.

Në Gjermani 1869 ishte garantuar e drejta aktive dhe pasive zgjedhore e të gjithë qytetarëve nga gjinia mashkullore të cilët kanë mbushur 25 vjet. Kjo dispozitë u pranua si ligj i Rajhut Gjerman në vitin 1871. Në kushtetutën e Vajmarkut të vitit 1919 ishte garantuar e drejta zgjedhore e të gjithë meshkujve dhe femrave mbi 20 vjeç. Në atë periudhë ishin përjashtuar disa shtresa të popullatës si mjet për luftë politike. Shembull për këtë është Kushtetuta e Republikës Ruse Socialiste Federale-Sovjetike (SRSFS) e vitit 1918 me të cilën ju ishte ndërprerë e drejta zgjedhore e armiqve të klasës borgjeze. Derisa përgjithshmëria e zgjedhjeve do të thotë se secili ka qasje deri te fleta votuese, *barazia* e zgjedhjeve do të thotë se secila votë ka peshë të njëjtë.⁹⁸

⁹⁷ Rajnholld Cipelius, *Teoria e përgjithshme për shtetin*. Ars Lamanian, (Shkup, 2012, f. 164).

⁹⁸ Cipelius. *Po aty*, f. 164.

2.4 Llojet e zgjedhjeve

Vetë natyra e sistemeve politike bashkëkohore imponon lloje të ndryshme të sistemeve zgjedhore. Ç'do herë si pikënisje merret natyra se si shfrytëzohet e drejta e përgjithshme e votës dhe nëse respektohen normat dhe standardet që e bëjnë votën e qytetarit të lirë dhe konkurruese. Në qoftë se nuk respektohen këta dy faktorë atëherë nuk mund të bisedohet për zgjedhje që sigurojnë legjitimitetin e të zgjedhurve dhe nënkuptohet, legjitimitetin e institucioneve përfaqësuese që formohen pas zgjedhjeve. Jo rrallë herë ndodh që subjektet politike në zgjedhje të mos mbajnë përgjegjësi për legjitimitetin e personave të zgjedhur ose thënë ndryshe për vullnetin e popullit që në të gjitha variantet e mundshme është sovran. Populli sovranitetin e tij e shpreh përmes zgjedhjeve, duke mbështetur një elitë të caktuar politike, e cila do të jetë udhëheqëse politike e një periudhe të caktuar kohore, të parashikuar sipas ligjeve në fuqi. Studiuesit dhe teoricientët, referuar këtyre karakteristikave, kanë klasifikuar tipologjinë e zgjedhjeve, të cilat si qëllim final pasqyrojnë karakterin e vërtetë të një regjimi politik.

Gjatë klasifikimit të zgjedhjeve autorë të ndryshëm nisen nga ajo që është thelbësore për sistemet politike dhe format e tyre. Në radhë të parë, pothuajse çdo herë merret në konsideratë niveli i demokratizimit, korrektësia, transparenca dhe zgjerimi i rregullativës zgjedhore, niveli i lirisë së qytetarëve gjatë pozicionimit të tyre për opsionet e ofruara nga subjektet garuese, si dhe natyra e vetë zgjedhjeve që nënkupton nëse janë zgjedhje vendore, të përgjithshme presidenciale etj.

Në këtë kuptim, studiuesit flasin për: zgjedhje demokratike dhe jo demokratike; zgjedhje konkurruese dhe jo konkurruese; zgjedhje të drejta dhe jo të drejta; direkte dhe indirekte; maxhoritare proporcionale ose të përziera; presidenciale, parlamentare të përgjithshme dhe vendore.

Kur diskutohet për zgjedhje në përgjithësi dhe klasifikimin e tyre nga teoricientët, analistët politikë dhe studiuesit kanë parasysh faktin se zgjedhjet mund të mos jenë kusht i mjaftueshëm për përfaqësim politik, por ato janë një kusht i nevojshëm. Kjo lidhet me faktin se në politikën bashkëkohore para se gjithash përfaqësimi ndërlidhet me zgjedhjet.

Që zgjedhjet ti shërbejnë qëllimit përfaqësues ato duhet të jenë konkurruese, të lira e të drejta dhe zhvillohen mbi bazën e të drejtës së përgjithshme të votës për të rriturit.⁹⁹ Kur bëhet fjalë për klasifikimin e zgjedhjeve si demokratike ose jo demokratike vlen të theksohet se në sistemet e ndryshme politike ekzistojnë standarde të ndryshme mbi demokracinë. Është gati e pamundur të thuhet me kompetencë të plotë se zgjedhjet ishin ose nuk ishin demokratike, pasi ndërmjet demokratikes dhe jo demokratikes ekziston shkallëzimi që jo çdo herë është i matshëm lehtësisht. Për shembull, në disa vende në tranzicion ku bën pjesë edhe Shqipëria zgjedhjet demokratike cilësohen si të tilla nëse rezultatet zgjedhore pranohen nga subjektet politike më të mëdha dhe votuesi nuk pengohet deri në momentin kur hedh fletën e votës në kutinë e votimit. Megjithatë, këtu parashtrohet pyetja; a i bëjnë zgjedhjet demokratike vetëm mospasja e konflikteve gjatë procesit zgjedhorë dhe mundësia që qytetari të hedh lirshëm fletëvotimin në kuti?! Si duhet të trajtohen një sërë procesesh që ndodhin pas perdes, ku për fat të keq përfshihen vetë institucionet shtetërore?!

Për të pasur qëndrim më korrekt ndaj kësaj çështje rikujtojmë tre personalitetet e shquara të jetës politike dhe shkencore, më gjerësisht qëndrimet e tyre ndaj demokracisë dhe zgjedhjeve. Është fjala për Maks Veberin, Çerçillin dhe Bernard Krikun.

Maks Veberi konstatonte se mjetet e partive politike për të arritur deri tek marrja e pushtetit mund të jenë krejtësisht të ndryshme prej dhunës së rëndomtë të cilit do lloj qoftë, deri tek kërkimi i votës me mjete të vrazhda ose subtile, blerja e votave, marrja e votës nëpërmjet oratorisë, nëpërmjet sugjestionëve, mashtrimeve deri tek taktikat e ashpra ose shumë dinake.¹⁰⁰

Në qoftë se nisemi nga ky qëndrim i Veberit për përcaktimin e demokracisë së procesit zgjedhorë atëherë vjen në shprehje të plotë qëndrimi i Bernard Krikut dhe Vilson Çerçilit. Kriku thotë se “demokracia është ndoshta fjala më e shumëllojshme në botën e çështjeve publike”, ndërsa Çerçill shprehet se demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, përveç gjitha formave që janë eksperimentuar herë pas herë”.¹⁰¹

⁹⁹ Heywood, A. *Politika*. Brezi 81’, (Prishtinë, f. 227).

¹⁰⁰ Aziri, E. *Partitë politike dhe Demokracia*, Logos A, (Shkup, 2004, f. 86).

¹⁰¹ Heywood. *Po aty*, f. 66-67.

Në qoftë se i analizojmë çështjet nga ky këndvështrim atëherë mund të flasim lirshëm për zgjedhjet demokratike dhe jo demokratike. Disa shoqëri nuk janë të vetëdijshme për nivelin e demokracisë së zgjedhjeve që zhvillohen në vendet e tyre para se të shfaqen me deklarata publike përfaqësuesit e ambasadave të shteteve me më shumë impakt ose përfaqësuesit e disa organizmave ndërkombëtare.¹⁰²

Për më shumë zgjedhjet konkurruese ose jo konkurruese janë shenjë njohje për demokracitë e zhvilluara. Garimi i mirëfilltë nëpërmjet subjekteve garuese i jep vlerën dhe kuptimin e vërtetë zgjedhjeve. Nga garim i bazuar në normativa ligjore për të cilat përkujdeset shteti i së drejtës varet perspektiva afatgjatë dhe funksionaliteti i mirëfilltë i një sistemi politik. Nëpërmjet mbajtjes së zgjedhjeve konkurruese lindin elita politike legjitime, të cilat si mbajtëse të tërthorta të sovranitetit të popullit, bëhen mbartëse të aktiviteteve politikbërëse deri në atë moment kur qytetarët do të vlerësojnë se duhet zëvendësuar me një elitë tjetër. Nuk përjashtohet mundësia që ndërrimi i elitave të bëhet edhe para afatit kohor të parashikuar me ligj dhe kushtetutë në rast të zgjedhjeve të parakohshme ose krizave të mëdha shoqërore që tejkalon kornizat e një elite politike, partisë ose një koalicioni parlamentar.

Edhe termi zgjedhje të drejta dhe jo të drejta mbart në vetvete shumë paqartësi, pasi zakonisht, në procesin zgjedhor ekzistojnë dy grupe që kanë qëndrime të kundërta ndaj po të njëjtit fenomen. Zgjedhjet trajtohen si të drejta nga subjektet politike fitimtare, ndërsa arsyetohen si zgjedhje të padrejta nga partitë që kanë rezultuar humbëse të zgjedhjeve. Të arrish deri tek e vërteta, jo çdo herë është proces i lehtë. Si do të jenë zgjedhjet e drejta, respektivisht jo të drejta, varet nga shumë faktorë, të cilët në shumicën e rasteve veprojnë si të gërshetuar.¹⁰³

Në këtë kontekst vlen të përmendet gatishmëria e shtetit për zhvillimin e zgjedhjeve të drejta, gatishmëria e subjekteve garuese, niveli i përgjithshëm i kulturës politike të votuesve etj. Sa u takon klasifikimeve të tjera, ato janë më shumë të karakterit teknik. Kur flasim për zgjedhjet direkte nënkuptohen zgjedhje ku qytetarët me të drejtë vote në mënyrë të drejtpërdrejtë zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët në bazë të ligjeve dhe

¹⁰² Saliaj, O. *Ndikimi i Zgjedhjeve dhe Sistemi Zgjedhor në Demokratizimin e Sistemit Politik të Republikës së Shqipërisë*. SEEU, (Tetovë, 2014, f. 42).

¹⁰³ Saliaj. *Po aty*, f. 42.

kushtetutës në fuqi formojnë institucionet më të rëndësishme të pushtetit, parlamentin, qeverinë etj.

Megjithatë praktika e shteteve bashkëkohore tregon raste të shumta ku institucionet e sistemit politik dhe mbartësit e funksioneve kyçe të autoriteteve shtetërore zgjidhen në mënyrë indirekte. Për shembull Senati i SHB-ve deri në vitin 1913 zgjidhej mes zgjedhjeve indirekte, ndërsa Senatin e Francës edhe sot e zgjedh një trup prej 100.000 elektorësh. Këtu vlen të përmenden edhe shumë presidentë të shteteve që zgjidhen nga parlamentet e shteteve të tyre, siç është rasti edhe me presidentin shqiptar.¹⁰⁴

Për sa i takon zgjedhjeve parlamentare, mazhoritare, proporcionale dhe të përziera është trajtuar pothuajse mjaftueshëm në këtë punim. Zgjedhjet presidenciale, parlamentare të përgjithshme dhe ata e vendore kanë specifikat e veta dhe dallojnë nga njëri vend tek një vend tjetër, në varësi të sistemit zgjedhorë që praktikohet. Llojet e zgjedhjeve nuk janë çështje të pa rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhorë. Nga lloji i zgjedhjeve vlerësohet niveli i praktikumit të vlerave demokratike në një shoqëri. Nga ana tjetër lloji i zgjedhjeve ndikon dukshëm në ndërtimin e kapaciteteve afatgjata që e bëjnë sistemin politik të qëndrueshëm dhe funksional.¹⁰⁵

Sistemi i zgjedhjeve është një ndër pjesët më të rëndësishme të së drejtës kushtetuese. Nëpërmjet zgjedhjeve shtetasit realizojnë një ndër të drejtat politike të veta me të cilin rast vjen në shprehje qenia e tyre politike. Sistemi i zgjedhjeve trajtohet në kuptimin e gjerë dhe atë të ngushtë. Në kuptimin e gjerë kuptojmë tërësinë e parimeve, të drejtave, garancive, aktiviteteve dhe punëve teknike të sanksionuara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera juridike, në bazë të cilave përcaktohet pjesëmarrja e shtetasve në organin përfaqësues të shtetit. Në kuptimin e ngushtë kuptojmë sistemin e ndarjes së mandateve e cila është çështje shumë e rëndësishme, sepse ajo shpall fituesit ose humbësit e zgjedhjeve të një subjekti politik.

¹⁰⁴ Saliaj. *Po aty*, f. 42

¹⁰⁵ Oreta Saliaj, *Ndikimi i Zgjedhjeve dhe Sistemi Zgjedhor në Demokratizimin e Sistemit Politik të Republikës së Shqipërisë*. SEEU, (Tetovë, 2014, f. 43).

Komponentë shumë e rëndësishme e zgjedhjeve është e drejta e zgjedhjeve e cila ka dy kuptime:

- Kuptimi objektiv

- Kuptimi subjektiv

Në kuptimin objektiv nënkuptojmë atë pjesë të së drejtës pozitive të shtetit apo sistemin e normave juridike me të cilin rregullohet zgjedhja e organeve të larta të shtetit. Këtu përcaktohet baza e elektoratit dhe rrethi i pjesëmarrësve në zgjedhje, të drejtat dhe detyrimet e partive politike, detyrat e organeve shtetërore për rregullshmërinë e zgjedhjeve etj. Në kuptimin subjektiv kuptojmë një nga të drejtat themelore të shtetasve në veprimtarinë e tyre politike, të drejtën për të zgjedh dhe të drejtën për tu zgjedhur.¹⁰⁶

Në demokraci ka lloje të ndryshme të zgjedhjeve, në varësi nga organi përfaqësues që zgjidhet, niveli i pushtetit, mënyra e zgjedhjes së organeve përfaqësuese dhe koha e mbajtjes.

- a. Në bazë të organit përfaqësues që zgjidhet kemi zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale;
- b. Sipas nivelit të organeve që zgjidhen kemi zgjedhjet lokale dhe ato qendrore;
- c. Sipas mënyrës së zgjedhjes kemi zgjedhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta;
- d. Në bazë të periudhës kohore janë të njohura: zgjedhjet e rregullta, të jashtëzakonshme dhe të parakohshme.¹⁰⁷

Zgjedhjet parlamentare

Me zgjedhjet parlamentare nënkuptohet tërësia e rregullave formale-juridike dhe procedurale, me të cilat përcaktohet mënyra e zgjedhjes dhe e konstituimit të organeve përfaqësuese. Rregullat procedurale për zgjedhjet parlamentare, rregullojnë procedurën e

¹⁰⁶ Bajrami, A. *E drejta kushtetuese – II*, fq. 1, Marrë nga: <http://valonhasani.do.am/EdrejtakushtetueseII.pdf>

¹⁰⁷ Bajrami, A. *Demokracia parlamentare*. (Prishtinë, 2005, botimi i katërt, f .175).

zgjedhjes së deputetëve, duke filluar që nga faza e kandidimit, e deri në zgjedhjet e tyre në funksion parlamentar. Këto rregulla janë të ndryshme prej shtetit në shtet. Ato zakonisht përcaktohen me ligje zgjedhore. Varësisht nga koha e mbajtjes, zgjedhjet mund të jenë të rregullta, të jashtëzakonshme dhe të parakohëshme.¹⁰⁸

Zgjedhjet e rregullta parlamentare

Këto zgjedhje mbahen pas skadimit të mandatit të rregullt parlamentar. Ato janë tipike për sistemet stabile, ku nuk shfaqen krizat parlamentare. Në praktikën parlamentare janë të njohura dy mënyra të zgjedhjeve të rregullta parlamentare:¹⁰⁹

1. *Mënyra e parë*, sipas së cilës pas skadimit të mandatit të parlamentit të vjetër zgjidhet parlamenti i ri në përbërje të plotë. Ana pozitive e këtij sistemi, është se, organi përfaqësues paraqitet gjatë gjithë kohës së mandatit me përbërje homogjene, kurse ana negative e tij konsiston në faktin se krijon zbrazëtitirë parlamentare deri në konstituimin e parlamentit të ri (kjo zbrazëtitirë cilësohet me një term latin si *capitasminutio-zhdukja e kreut*).

2. *Mënyra e dytë* e zgjedhjeve të rregullta parlamentare, nënkupton përtëritjen e pjesërishme të parlamentit ekzistues me anëtarë të ri. Në këto raste, nuk bëhet zgjedhja e tërë parlamentit, por përbërja ekzistuese e parlamentit ndryshon në atë mënyrë, që vetëm një pjesë të anëtarëve të tij i skadon mandati, dhe në vend të tyre zgjidhet një numër i deputetëve të ri. Ana pozitive e kësaj mënyre të përtëritjes së parlamentit, konsiston në sigurimin e vazhdimësisë dhe shmangien e zbrazëtitirës, apo *capitasminutio* (zhdukja e kreut) në punën e tij. Ana negative e këtij sistemi, është zhvillimi i shpeshtë dhe i pjesërishëm i zgjedhjeve të rregullta parlamentare.

Sistemi i parë i zgjedhjeve të rregullta parlamentare, që nënkupton zëvendësimin e plotë të përbërjes së vjetër të parlamentit me deputet të ri, është shumë më i përhapur dhe ai aplikohet në shumicën e shteteve parlamentare. Ndërkaq, sistemi i zgjedhjeve të pjesërishme parlamentare ka një aplikim mjaftë të kufizuar. Shembull më tipik i këtij sistemi është Senati amerikan, mandati i të cilit zgjat 6 vjet, por ku çdo 2 vjet përtërihet një

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Bajrami, A. *Demokracia parlamentare*. (Prishtinë, 2005, botimi i katërt, f. 176).

e treta e senatorëve, në të njëjtën kohë që zhvillohen edhe zgjedhjet për Dhomën Përfaqësuese, mandati i së cilës është shumë më i shkurtër, dy vjeçar. Këto zgjedhje të shpeshta krijojnë probleme për pushtetin ekzekutiv, sepse, zakonisht në zgjedhjet që bëhen vitin e dytë pas zgjedhjes së presidentit të SHBA-ve fiton partia kundërshtare, gjë që imponon nevojat e ndryshimeve të shpeshta kadrovike në pushtetin ekzekutiv dhe në Stejt Departamentin amerikan.¹¹⁰

Përpos dy sistemeve të caktuar të zgjedhjeve të rregullta, në teori është i njohur edhe rasti i zgjedhjes së deputetëve në parlament në bazë të trashëgimisë së funksionit. Këtë praktikë e hasim në parlamentin angles, ku një pjesë e anëtarëve të Dhomës së Lordëve ka mandat të përjetshëm dhe zëvendësohet në bazë të trashëgimisë së funksionit parlamentar.¹¹¹

Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare

Siç tregon edhe vetë emërtimi i këtyre zgjedhjeve, ato kanë karakter të jashtëzakonshëm. Mbajta e tyre bëhet si pasojë e paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare para skadimit të mandatit të rregullt. Arsye për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare, zakonisht merren ngjarjet e ndryshme politike të cilat shkaktojnë ndryshime të thella politike në një shtet.¹¹²

Faktorë të tjerë që kushtëzojnë nevojën e shpalljes së zgjedhjeve të jashtë zakonshme parlamentare, janë krizat parlamentare, të cilat kanë për pasojë bllokimin e punës së parlamentit, i cili për një kohë të gjatë nuk mund t'iu shtrojë funksionet e tij. Këto kriza parlamentare, janë pasojë e konflikteve të brendshme parlamentare midis partisë në pushtet dhe opozitës dhe obstrukcioneve tjera që bëjnë të pamundshëm punën e parlamentit. Në këso raste, kur kjo krizë zgjat një kohë relativisht të gjatë, me kërkesën dhe presionin e trupit elektoral vjen deri te shpallja e zgjedhjeve të jashtë zakonshme parlamentare.¹¹³

¹¹⁰ Bajrami, A. *Demokracia parlamentare*. (Prishtinë, 2005, botimi i katërt, f.176).

¹¹¹ *Po aty*.

¹¹² *Po aty*.

¹¹³ Bajrami, A. *Demokracia parlamentare*. (Prishtinë, 2005, botimi i katërt, f.167).

Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, në praktikë mbahen në shtetet që nuk kanë një stabilitet politik, ku ka ndërrime të shpeshta dhe konflikte politike dhe sociale, lufta etnike dhe civile, etj. Në këto shtete, janë të rralla rastet kur parlamentet mbarojnë mandatin e tyre të plotë parlamentar. Shembull tipik për këto janë zgjedhjet në ish-shtetet socialiste që gjenden në fazën e tranzicionit, ku zgjedhjet e jashtë zakonshme janë të shpeshta.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare

Për dallim nga zgjedhjet e jashtëzakonshme, zgjedhjet e parakohshme parlamentare nuk janë rezultat i shfaqjes së rrethanave të posaçme dhe të jashtëzakonshme, të cilat justifikojnë nevojën e zgjedhjes së organit përfaqësues. Shpallja e tyre është rezultat i ndërprerjes së mandatit të parlamentit ekzistues me vendim të posaçëm të një organi tjetër shtetëror. Kjo vjen në shprehje, në ato shtete në të cilat shefi i shtetit (monarku apo kryetari i republikës), ka të drejtë si pas kushtetutës, të marr vendim për shpërndarjen e parlamentit dhe shpalljen e zgjedhjeve, i hasim në disa shtete evropiane me qeverisje gjysmë presidenciale, ku shefi i shtetit ka të drejtë në kushtet e caktuara (më së shpeshti pas dorëheqjes apo vetëbesimit të qeverisë), të shpërndaj parlamentin dhe të shpall zgjedhjet e jashtëzakonshme.¹¹⁴

Parimet e zgjedhjeve demokratike parlamentare

Zgjedhjet parlamentare, për t'u cilësuar si legjitime dhe demokratike duhet të mbështeten në disa parime, të cilat mundësojnë dhe sigurojnë procedurën demokratike dhe krijimin e kushteve të barabarta për një luftë korrekte parlamentare të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje. Këto parime janë tregues i vërtetë, se a kanë zgjedhjet parlamentare karakter demokratik, dhe se, a janë zhvilluar në parim me rregullat ndërkombëtare që përcaktohen për tu pranuar legjitimiteti i tyre.¹¹⁵

¹¹⁴ *Po aty.*

¹¹⁵ Bajrami, A. *Demokracia parlamentare*. (Prishtinë, 2005, botimi i katërt, f. 168).

Si parime themelore të zgjedhjeve demokratike parlamentare janë:¹¹⁶

1. E drejta e zgjedhjes së përgjithshme
2. E drejta e barabartë e votës
3. Zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta
4. Votimi i fshehtë
5. Zgjedhjet shumë partiake
6. Shtypi dhe informimi i lire

1. *E drejta e zgjedhjeve të përgjithshme* është e lidhur me paraqitjen e institucioneve moderne përfaqësuese dhe është ndër të drejtat më të vjetra politike. E drejta e zgjedhjeve nënkupton disa të drejta si: të drejtën e shtetasve të zgjedhin përfaqësuesit e vet që njihet si e drejtë aktive, të drejtën e shtetasit që të zgjidhen për përfaqësues që njihet si e drejtë pasive, të drejtën e shtetasit që të kandidohet për përfaqësues dhe të drejtën e shtetasit për referendum për çështje madhore. Sot e drejta e zgjedhjeve të përgjithshme e emëruar si "e drejtë e votës së përgjithshme" paraqet një ndër parimet themelore të sistemit të zgjedhjeve. Me sistemin e zgjedhjeve të përgjithshme kuptojmë të drejtën e përgjithshme për të marrë pjesë në zgjedhje nëse e kanë mbushur moshën madhore, pa dallim race, besimi, seksi, përkatësie kombëtare, shkallë arsimimi, kulture, gjendje ekonomike etj. Për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.¹¹⁷

2. *E drejta e zgjedhjeve të barabarta*, kjo mund të emërtohet si "e drejtë e votës së barabartë" por edhe si "barazia e shtetasve në zgjedhje". Me këtë të drejtë kuptojmë fuqinë e votës së shtetasit. E drejta e zgjedhjes jo të barabartë dallon shtetasit për nga vlera e votës së tyre. Kjo e drejtë është bërë në dy mënyra: të haptë dhe të tërthortë. Mënyra e haptë e pabarazisë së votës është bërë përmes "votimit plural"-shumëzimit të votave.¹¹⁸

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Hasani, V. *Sistemi i zgjedhjeve*. Marrë nga: http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/910210014/Article-SISTEMI-I-ZGJEDHJEVE-nga-Valon-R-Hasani-.aspx

¹¹⁸ Hasani. *Po aty*.

3. *E drejta e zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.* Me të drejtën e zgjedhjeve të drejtpërdrejta nënkuptojmë të drejtën e shtetasit që si zgjedhës, për mes votimit të zgjedh vetë përfaqësuesit e vet pa ndërmjetës. Të drejtën e zgjedhjeve të tërthorta e kemi atëherë kur zgjedhësit zgjedhin ndërmjetësit e tyre, në vend të vet, për përfaqësues në organet përfaqësuese. Zgjedhjet e tilla mund të jenë dy ose më shumë shkallëshe.¹¹⁹

4. *Votimi i fshehtë dhe i hapët (publik)* – Votimi i hapët bëhet përmes akلامacionit (brohoritjes) apo me ngritjen e dorës. Kjo formë e votimit është jodemokratike, nga se mundëson kontrollin dhe presionin mbi zgjedhësit, dhe nuk i lejon ata të shprehin vullnetin e vet në zgjedhje. Votimi i fshehtë bëhet me hedhjen e kokrrave të gomës, figurave, shenjave etj, në kutin e votimit për të zgjedhur një kandidat. Sot në botë ky votim bëhet përmes fletëvotimeve në të cilat shënohet emri dhe mbi emri i kandidatit apo partisë politike.¹²⁰

5. *Sistemi i ndarjes së mandateve me rastin e zgjedhjeve* - Nga forma e ndarjes së mandateve, varet dhe vlera e vërtetë e votës së zgjedhësit. Në teorinë politike janë të njohura dy sisteme të ndarjes së mandateve:

- Sistemi i herësit
- Sistemi i D'Hondt-it (matematicient belg).

Sipas sistemit të herësit numri i tërësishëm i votave së pari pjesëtohet me numrin e përfaqësuesve që zgjidhen në njësinë zgjedhore. Numri i fituar paraqet herësin zgjedhor. Secilës listë të kandidatëve i ndahen atëherë mandate sa herë të pjesëtohet numri i votave që ka fituar lista me herësin zgjedhor. Zbatimi i këtij sistemi ka për qëllim ekzistimin e partive të vogla. Sistemi i D'Hondt-it ndarja e mandateve bëhet përmes operacionit matematikor i cili nënkupton shfrytëzimin e "ndarësit të përbashkët".¹²¹

¹¹⁹ Hasani. *Po aty*.

¹²⁰ Hasani, V. *Sistemi i zgjedhjeve*. Marrë nga: http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/910210014/Article-SISTEMI-I-ZGJEDHJEVE-nga-Valon-R-Hasani-.aspx

¹²¹ Hasani, V. *Po aty*.

- Ato që marrin për bazë parimet që përshkojnë sistemin e zgjedhjeve, këto sisteme i ndajnë në demokratike dhe jo demokratike ose përparimtare dhe reaksionare.

- Ato që marrin për bazë nivelin e përputhshmërisë si pjesë pozitive të një vendi, sistemet e zgjedhjeve i ndajnë në reale, formale dhe fiktive.¹²²

Sipas këtij sistemi mandatin e fiton kandidati, përkatësisht lista e kandidatëve e cila fiton shumicën e votave në një njësi zgjedhore. Sistemi i shumicës bazohet në shumicën absolute dhe atë relative, mund të zbatohet në njësi të mëdha ashtu edhe të vogla. Shumica absolute zbatohet atëherë kur në listë janë një ose dy kandidat. Shumica relative zbatohet nëse në lista janë më shumë se dy kandidat. Sistemi i përfaqësimit proporcional – në këtë sistem secila parti ose grup politik që merr pjesë në zgjedhje, fiton numrin e mandateve në përpjesëtim me numrin e votave që ka fituar në zgjedhje. Qëllimi i zbatimit të tij ka qenë, që edhe pakicës t'i mundësohet numri i caktuar i mandateve, por në baza proporcionale. Ndër sistemet që kanë pretenduar të siguroj në mandate për pakicën kanë qenë: sistemi i grumbullimit të votave, sistemi i minimumit zgjedhor dhe sistemi i votimit të kufizuar.¹²³

2.5 Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar

Nga e më lartë shënuara kuptohet qartë se zgjedhjet përveç normave mirë të definuara ngërthejnë edhe një nivel më të ulët ose më të lartë të dinamizmit. Shiquar nga aspekti historik i tyre zgjedhjet, mënyra e zbatimit të tyre ka pësuar ndryshime kualitative dhe kuantitative. Ndryshimet nga kjo sferë varen nga më shumë faktorë e parasegjithash nga niveli i kulturës politike, zhvillimi socio-politik i shoqërive konkrete, tradita, përbërja etnike, kulturore, konfesionale etj. Këtu qëndron edhe dallimi mes shteteve me demokraci të etabluar dhe shteteve me demokraci të zbehtë.

Shtetet me demokraci të zhvilluar dallojnë në kuptimin e organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve në shumë aspekte krahasuar me demokracitë në formim e sipër. Shtetet me demokraci të zhvilluar dallojnë nga shtetet tjera para se gjithash për nga metodologjia e

¹²² Hasani. *Po aty*.

¹²³ Hasani, V. *Sistemi i zgjedhjeve*. Marrë nga: http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/910210014/Article-SISTEMI-I-ZGJEDHJEVE-nga-Valon-R-Hasani-.aspx

organizimit të zgjedhjeve. Në SHBA dhe shtetet e zhvilluara evropo-perëndimore, forma klasike e organizimit të zgjedhjeve është zëvendësuar me forma shumë të avancuara të bazuara në teknologjitë e larta. Dallimet janë evidente edhe sa i përket financimit të subjekteve garuese, propagandës, agjitimit etj. Në këta shtete ka pak hapësirë për mënyrën makiaveliste të organizimit të zgjedhjeve. Subjektet garuese në përmasa të dukshme e vënë në pah interesin e individit dhe shoqërisë dhe fatin e saj.

2.6 Zgjedhjet në demokracitë e vendeve në tranzicion

Kritikat ndaj pushtetit të madh politik të partive politike kanë zënë vend në shumicën e raporteve ndërkombëtare. Mbi Shqipërinë, siç janë raportet vjetore të Komisionit Evropian, raportet periodike të OSBE-së dhe të Misioneve Vëzhguese Zgjedhore të ODIHR-it, raportet monitoruese dhe vlerësuese të Këshillit Evropian, si dhe raportet vjetore të Freedom House apo të Departamentit të Shtetit. Ky pushtet bëhet përgjegjës për bipolarizimin permanent dhe të dëmshëm, ecjen e ngadalshme të reformave integruuese si dhe për brishtësinë e veprimit të institucioneve kushtetuese të shtetit të së drejtës. Këtë e konfirmon edhe analiza e mëposhtme e OSBE-së sipas së cilës¹²⁴ “Që prej vitit 1991” politika në Shqipëri ka qenë tejet e polarizuar me dy partitë politike mbizotëruese PS dhe PD, që konkurronin për pushtet si në nivel kombëtar ashtu edhe atë lokal. Si rezultat i OSBE/ODIHR-I në Shqipëri që nga viti 1992, përgjithësisht nuk kanë arritur të përmbushin angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, edhe pse OSBE/ODIHR-i ka vërejtur përmirësime graduale. Megjithatë procesi ka qenë përgjithësisht konfliktual dhe i tejzgjatur, me pretendime për parregullsi dhe mashtrime, disa prej të cilëve janë dokumentuar nga komuniteti ndërkombëtar. Partia që nuk arrinte të fitonte zgjedhjet në nivel vendor apo kombëtar, përgjithësisht refuzonte të pranonte si legjitim rezultatin zgjedhjeve, duke iu drejtuar shpesh bojkotit të organeve të zgjedhura ose kërcënimeve me bojkot. Kjo atmosferë minoi besimin publik te zgjedhjet dhe tek institucionet demokratike.

¹²⁴ Krasniqi, A. (MBI) *Pushteti i Partive*. Gjergj Fishta, (Trianë, 2008, f. 217,218). (Raport përfundimtar OSBE/ODIHR: Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, 12 Tetor, 2003. 25 Janar, 2004, f. 4)

Përvoja e vendeve perëndimore ofron modelin e administrimit të procesit zgjedhorë nga individ profesionistë dhe me integritet, që zbatojnë ligjin dhe veprojnë jashtë ndikimit të partive politike. Këto parime kanë zënë vend në listën e rekomandimeve permanente të OSBE/ODIHR për zgjedhjet në Shqipëri. Tradicionalisht dy partitë e mëdha kanë pasur monopolin mbi komisionerët. Në këtë mënyrë, dhënia e pushtetit partive politike i deformon zgjedhjet dhe ia përçon vullnetin dhe sovranitetin e qytetarëve një elite të ngushtë politike që drejton partinë.¹²⁵

Analiza e zhvillimeve politike dhe e rolit të partive politike në raport me pushtetet kushtetuese në vend, ofron argument të shumta në mbështetje të tezës së 17 vjet pas fillimit të pluralizmit politik dhe 16 vjet pas zgjedhjeve të para shumëpartiake në Shqipëri, shoqëria shqiptare po ballafaqohet me sfidën e përcaktimit të pushtetit të partive politike. Partitë u bënë pjesë jetësore e pluralizmit dhe të garës politike, por në kundërshtim me aspiratën e vendit për demokraci efektive dhe të qëndrueshme; ato u imponuan edhe si faktor dominues i sistemit shtetërorë e kushtetues. Partitë promovuan vlerat e demokracisë dhe krijimin e një sistemi politik tërësisht të kundërt me modelin diktatorial të partisë – shtet. Por gjatë këtyre viteve ato shfaqen elemente të shumta të mentalitetit dhe sistemit të vjetër, përfshirë edhe tendencën e ruajtjes së monopolit politik mbi shtetin e shoqërinë. Fuqia e partive brenda një sistemi demokratik është fenomen global; por, në rastin shqiptar, në dallim nga modeli perëndimorë, “kundër kësaj prirje politizuese të shtetit, veprojnë mekanizma institucional rezistent, të cilat te ne ose janë ende të pazhvilluara ose rezultojnë fare të paqena.”¹²⁶

¹²⁵ Krasniqi, A. (MBI) *Pushteti i Partive*. Gjergj Fishta, (Tiranë, 2008, f, 217, 218).

¹²⁶ Fuga, A. *Republika e Dhjetë*. Panorama, (Tiranë, 2003).

Kapitulli III: Zgjedhjet dhe demokracia në RM analizë krahasimore (me zgjedhjet paraprake ndër vite)

1. Kalimi nga sistemi monist në atë pluralist
2. Zgjedhjet dhe modeli zgjedhor në fillim të jetës pluralo-politike
3. Ndryshimet në kodin zgjedhor si nevojë reale në kushtet e Republikës së Maqedonisë
4. Aspekti instrumentalist dhe funksionalist i zgjedhjeve në R.M.
5. Zhvillimi i zgjedhjeve dhe proceseve zgjedhore deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016
6. Refleksioni i zgjedhjeve në demokratizimin e R.M. deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016

3. Kalimi nga sistemi monist në atë pluralist

Kalimi nga monizmi në pluralizëm paraqet një periudhë plot me sfida për të gjitha ish shtetet komuniste përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Është fjala për një proces shoqërorë me plot kundërthënie dhe shumë rreziqe. Secili shtet ka historikun e vet. Ne në mënyrë telegrafike do ti përshkruajmë përvojat e Republikës së Maqedonisë së Veriut si pjesë konstituive e ish RSFJ-së.

Sa i përket Ish Federatës Jugosllave dhe RMV-së patjetër të nënvizohen krizat e një pas njëshme që kulminuan në fund shekullin e kaluar dhe e bënë të pamundshme funksionimin e shtetit në baza moniste. Normal se këtu duhet të merren parasysh edhe ndodhitë në ish shtetet tjera komuniste që llogariten si faktorë të jashtëm që ndikuan në zëvendësimin e sistemit monist me atë pluralo-partiak.

Kriza në këtë shtet ka qenë permanente dhe manifestohet si krizë ekonomike dhe krizë politike. Kriza e sistemit në ish Federatën Jugosllave u bë shumë e vrazhdë pas vdekjes së presidentit Tito dhe fillimit të demonstratave të studentëve kosovarë për barazi të qëndrueshme të njësive federative në korniza të Jugosllavisë titiste.

Kulmi i krizës ekonomike u shënuar me rënien e qeverisë së Branko Mikuliqit dhe zëvendësimin e saj me qeverinë e Ante Markoviqit ,një qeveri e vonuar. Kriza politike kulminoi me dështimin e Kongresit të 14 të jashtëzakonshëm të LKJ. Në këtë kongres u bë e qartë se LKJ e kishte humbur fuqinë e vet revolucionare dhe se pluralizmi politik paraqet domosdoshmëri për zhvillimin e më tutjeshëm me shtetin.

Idetë e pluralizimit të shoqërisë ndiqeshin edhe nga lëvizje të fuqishme nacionaliste të cilat sollën deri te shkapërderdhja e ish RSFJ-së dhe luftërat në Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë. Republika e Maqedonisë i shpëtoi konfliktit me Armatën Popullore të Jugosllavisë por edhe jo konfliktit të vitit 2001.

Sa i takon depërtimit të ideve pluraliste këtu, Kongresi i 10 i LKM-së ka një domethënie të posaçme. Në atë kongres u qartësua se stagnimi i Maqedonisë ndër decenie ka qenë si pasojë e zhvillimit monist të vendit.

Republika e Maqedonisë së Veriut në fillim cilësohej si një republikë konservatore mos themi e frikësuar. Andaj pluralizmi këtu ka specifikat e veta dhe u zhvillua në një gjendje shoqërore politike skajshmërisht të tensionuar.

3.1 Zgjedhjet dhe modeli zgjedhor në fillim të jetës pluralo politike

Pas legjitimitimit të sistemit shumë partiak në Maqedoninë e Veriut në vitin 1990, lindi nevoja e ndryshimit të strukturës rregullative zgjedhore të zbatuar deri në atë kohë dhe krijimi i mekanizmave zgjedhorë që do ti përgjigjeshin realitetit shumë partiak të shtetit, si dhe do të krijonin kushtet e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve korrekte, të lira dhe të drejtpërdrejta. Si rrjedhojë, sistemi i ri shoqërorë e politik impononte përpilimin e një rregullative të re zgjedhore, por për shkak të rolit dominues të Lidhjes Komuniste, haseshin vështirësi në ndërmarrjen e hapave radikal në këtë drejtim.¹²⁷

Lidhja Komuniste e Maqedonisë si parti dominuese nuk dëshironte ti largohej praktikës së deritanishme zgjedhore, e cila nga ana tjetër thjesht vetëm formalizonte legjitimitetin e përfaqësuesve politik. Në të tilla kushte zgjedhjet për votuesit ishin obliguese dhe nuk kuptoheshin si pjesë e të drejtave të patjetërsueshme të qytetarit. Megjithatë ambient i ri politik, të paktën në aspektin teorik, impononte mbajtjen e zgjedhjeve konkurruese, që do të siguronin raporte përgjegjësie ndërmjet qytetarëve dhe ushtruesve të pushtetit. Pra, në fillim të viteve nëntëdhjeta lindi nevoja, që paraqitej më tepër në formatin e domosdoshmërisë, për formulimin e një sistemi zgjedhorë që do të konsistonte në modelet e pranuar të demokracisë përfaqësuese.¹²⁸

Formulimi i sistemit të ri zgjedhorë u shoqërua me polemika të shumta si në qarqet shkencore ashtu edhe ndërmjet partive politike. LKM-ja e cila kishte strukturë organizative mjaft të fuqishme, insistonte me çdo kusht që në zgjedhjet e para shumë partiake të praktikohej sistemi zgjedhor i shumicës, ndërsa partitë opozitare alternative (cilësojmë se opozita dhe pozita në një sistem partiak legjitimohen vetëm pas zgjedhjeve të lira demokratike), këmbëngulnin në aplikimin e sistemit zgjedhorë proporcional, si sistem i cili do t'u mundësonte partive të posa formuara një “hyrje më të lehtë në parlament” dhe përfaqësim më të drejtë, e më parimor të trupit zgjedhorë në tërësi.

Pavarësisht kësaj, u vendos për praktikimin e sistemit zgjedhorë të shumicës dhe më saktësisht për variantin e shumicës absolute, që parashikonte dy raunde zgjedhore në qoftë se kandidati për deputet republikan nuk siguronte numrin e votave të parashikuara

¹²⁷ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 472).

¹²⁸ Aziri. *Po aty*, f. 473.

me ligj në raundin e parë. Referuar Ligjit Zgjedhorë të Republikës së Maqedonisë të vitit 1990 si përfaqësues i zgjedhur cilësohej ai kandidat që kishte përfaqësuar shumicën e votave nga zgjedhësit me të drejtë vote në njësinë zgjedhore përkatëse, me kusht që numri i votave të fituara të mos ishte më i vogël se 1/3 nga numri i votuesve të evidentuar në listën zgjedhore. Në qoftë se asnjë nga kandidatët nuk siguronte numrin e nevojshëm të votave, atëherë ripërsëriteshin zgjedhjet në një afat prej 14 ditësh, ose thënë ndryshe zhvillohej raundi i dytë i zgjedhjeve.¹²⁹ Të drejtën e pjesëmarrjes në raundin e dytë zgjedhor e dispononin vetëm kandidatët që kishin fituar së paku 7% të votave të elektoratit. Në qoftë se asnjë nga personat e kandiduar nuk siguronte minimumin e parashikuar me ligj, pra nuk siguronte 7% të votave në raundin e parë, atëherë në atë njësi zgjedhore përsëritej e tërë procedura zgjedhore. Në qoftë se në asnjë njësi zgjedhore asnjë prej kandidatëve nuk kishte siguruar minimumin e nevojshëm të votave për të shkuar në raundin e dytë, në këtë rast procedura zgjedhore ndryshonte dukshëm. Si kandidat i zgjedhur në zgjedhjet e përsëritura cilësohej kandidati i cili kishte fituar numrin më të madh të votave të zgjedhësve. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë fitonin një numër të barabartë votash, atëherë mandati i deputetit caktohej me anë të shortit.¹³⁰

Edhe pse në praktikë vështirë se mundë të ndodhin situata që çonin deri tek përsëritja e zgjedhjeve, për periudhën në fjalë një gjë e tillë teoritikisht ishte e mundshme. Për shembull, kjo mundë të ndodhte në qoftë se zgjedhjet i bojkotonte popullsia shqiptare në njësitë zgjedhore ku ajo përbënte shumicën absolute.

Nga ky model zgjedhor priteshin efekte pozitive, e para se gjithash grupimi i partive politike dhe krijimi i kushteve të nevojshme për një funksionim më efikas të parlamentit dhe qeveris, eliminim gradual të ndarjeve në baza kombëtare, fetare dhe të ngjashme, si dhe ofrimi i mundësive më të mira për fitore eventuale të kandidatëve të pavarur.¹³¹

Këta të fundit do të angazhoheshin në parlament në përpunimin e politikave që nuk përputheshin drejt për së drejti me politikën e partive politike dominuese, por për politikat që ishin më afër interesave të qytetarëve të zakonshëm. Si subjekt i sjelljeve në këtë koncept janë qytetarët si zgjedhës dhe si propozues të kandidatëve, kandidatët dhe partitë

¹²⁹ Aziri. *Po aty*, f. 472.

¹³⁰ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 472).

¹³¹ Aziri. *Po aty*, (Tetovë, 2015, f. 475).

politike, si dhe institucionet për realizimin e zgjedhjeve. Nënkuptohej, ndikimi i tyre është me intensitet të ndryshëm, në varësi të fazave të zhvillimit të procesit zgjedhor.

Për ndryshe, ashtu siç u tha e drejta e kandidimit nuk është e rezervuar vetëm për partitë politike si subjekte të organizuara. Të drejtën e kandidimit e kanë edhe qytetarët që nuk janë partiakisht të organizuar. Pa mos u futur në analiza më të thella se sa janë gjasat për një fitore eventuale të kandidatëve të pavarur në konkurrencën me partitë politike, vetë mundësia e një optionsi të tillë është indikator i demokratizimit në fazën e kandidimit.

Sipas ligjit zgjedhor në fjalë i tërë territori i Maqedonisë Veriut u nda në 120 njësi zgjedhore dhe sipas logjikës normative në çdo njësi zgjedhore zgjidhej vetëm një deputet. Edhe pse neni 18 i po të njëjtit ligj parashikonte që njësitë zgjedhore të kenë numër përafërsisht të njëjtë të votuesve, në praktik situatë ndryshonte. Kështu, sipas asaj që u vërtetua më vonë, disa njësi zgjedhore në Maqedoninë Lindore numëronin pothuajse 100% më pak votues krahasuar me njësitë zgjedhore në Maqedoninë Perëndimore, ku kryesisht është e përqendruar popullata shqiptare. Kjo dukuri e mosrespektimit të ligjit nga vetë ligjvënësi dhe partitë politike maqedonase ishte një prej arsyeve kryesore të mospajtimit të subjekteve politike shqiptare me ligjin zgjedhor dhe angazhimin e tyre për ndryshimin e tij.¹³²

Subjektet politike shqiptare shprehen mospajtimin e tyre me ligjin zgjedhor ndaj institucioneve të sistemit dhe faktorit ndërkombëtar, duke ofruar prova dhe argumente se ky ligj përveç dobësive të përgjithshme, ishte diskriminues dhe zhvlerësonte votën e lirë të shqiptarëve si kolektivitet kombëtar. Kështu ish Partia Demokratike Popullore në vitin 1993 i u drejtua Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Konferencës Paqësore për Ish-Jugosllavinë, Këshillit Evropian dhe OSBE-së me një letër ku mes tjerash thuhej: “Jemi kundër zgjedhjeve të bazuara në ligjin ekzistues mbi zgjedhjet, i cili për shqiptarët dhe jo maqedonasit në përgjithësi është tejet diskriminues”. Sa për ilustrim mjafton të përkujtojmë se në zgjedhjet e para shumë partiake të vitit 1990, të bazuar në ligjin e përmendur sa më lart, për një deputet shqiptar kanë votuar mesatarisht rreth 8.000 votues, ndërsa për një deputet maqedonas rreth 4.000 votues. Bashkësitë e tjera kombëtare jo maqedonase përveç romëve, mbetën pa asnjë deputet në parlamentin

¹³² Aziri. *Po aty*, f. 475.

republikan. Subjektet politike shqiptare bënë presion për ndryshimin e ligjit për njësitë zgjedhore, duke parashtruar kërkesën e aplikimit të sistemit zgjedhor proporcional ose të kombinuar, ku së paku 50% e deputetëve të zgjidheshin sipas sistemit proporcional.¹³³

Modeli zgjedhor i vitit 1990 nuk kënaqte aspak edhe ambiciet e një numri të konsiderueshëm të subjekteve politike maqedonase, por normalisht preokupimi parësor i tyre ishte që numri i deputetëve shqiptar në Parlamentin e Maqedonisë të përputhej çdo herë me qëllimet e llogaritjet e tyre, gjerësisht me strategjitë kombëtare maqedonase për periudhën në fjalë. Megjithatë, praktika politike, nevoja e përputhjes së ligjit zgjedhor me kushtetutën e re dhe trysnia nga jashtë, e detyruan Qeverinë maqedonase që në vitin 1993 të propozojë plotësimin e ligjit ekzistues zgjedhore dhe atë me procedurë të shkurtër. Kjo kërkesë e qeverisë u refuzua nga Parlamenti dhe një ligj iu është bashkangjitur një vit më vonë “pakos së përbashkët” të ligjeve të tjera zgjedhore.

Projekt ligji zgjedhor propozonte mbajtjen e zgjedhjeve sipas modelit zgjedhor të shumicës së kombinuar me elemente të sistemit proporcional. Në realitet, i gjithë territori shtetërorë do të mbetët i ndarë në 120 njësi zgjedhore, ku 20 deputetë do të zgjidhnin në mënyrë plotësuese sipas parimit proporcional, i cili korrespondonte me normat e vendosura në Kushtetutën e vitit 1991. Më specifikisht neni 62 i kushtetutës parashikonte që numri i deputetëve në Kuvend të jetë nga 120 deri 140 deputetë.¹³⁴

Pra ligji, i propozuar parashikonte dy risi në krahasim me ligjin e vitit 1990. Risia e parë është ajo që u tha më lart, ndërsa risia e dytë ishte se në raundin e dytë zgjedhorë ishte se nuk do të mund të garonin më shumë se dy kandidatë. Pra kishin të bënë me një procedurë që dallonte nga e mëparshmja. Në qoftë se asnjë nga kandidatët e mundshëm nuk fitonte në raundin e parë, gara zgjedhore vazhdonte në raundin e dytë vetëm me dy kandidatë që kishin marrë më shumë vota dhe jo të gjithë kandidatët që kishin siguruar së paku 7% të votave.

Kundër një propozimi të tillë ishin partia më e madhe opozitare maqedonase VMRO-DPMNE, PPD-ja dhe disa deputet të pavarur. Megjithatë motivet nuk ishin të njëjta ose identik. Mospajtueshmëria më e madhe kishte karakter kombëtar. VMRO-DPMNE dhe deputetët e pavarur maqedonas, si argument të vetëm kundër sistemit “pak të përzier”

¹³³ Aziri. *Po aty*, 475

¹³⁴ Shih: Aziri. *Po aty*, f. 476.

kishin “frikën” e homogjenizmit në baza kombëtare dhe jo stabilitet qeveritar. Nënkuptohet se argumente të tilla ishin të paqëndrueshëm, ndërsa arsye të vërteta ishin të një natyre krejt tjetër.¹³⁵

Qëndrimet e deputetëve shqiptar ishin pothuajse divergjente me ato të kolegëve maqedonas. Ata bënë thirrje për revidimin e njësive zgjedhore, që nënkuptonte numër të barabartë të votuesve në të gjitha njësitë zgjedhore. Për sa i takon modelit zgjedhor, propozimet e deputetëve ishin të ndara, një pjesë e deputetëve të PDP-së dhe disa deputetë të PPD-së bënë thirrje që 100 deputetët të zgjidheshin sipas modelit të shumicës dhe 40 sipas modelit proporcional. Vetëm një deputet i PDP-ë dhe disa deputet të PPD-së bënë thirrje që 70 deputet të zgjidheshin sipas sistemit të shumicës dhe 70 sipas modelit proporcional. Nga tërësia e ligjeve të propozuara deputetët ranë dakord vetëm për ligjin mbi zgjedhjen e Presidentit të vendit dhe ligjin për partitë politike. Kështu, zgjedhjet e dyta parlamentare u mbajtën sipas rregullativës së vjetër zgjedhore. Partia e cila përkrahu fuqishëm rregullativën ekzistuese zgjedhore, VMRO-DPMNE-ja, bojkotoi zgjedhjet në raundin e dytë, me pretekst se janë bërë falsifikime të shumta në raundin e parë zgjedhore.

136

¹³⁵ Aziri. *Po aty*. f. 476.

¹³⁶ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 477).

3.2 Ndryshimet në kodin zgjedhor si nevojë reale në kushtet e Republikës së Maqedonisë

Edhe pse zgjedhjet e dyta parlamentare u mbajtën sipas rregullativës së vjetër ligjore, modeli ekzistues zgjedhorë vazhdoi të ishte në qendër të kritikave të ashpra. Më në fund në vitin 1998 pati një përpjekje të aktorëve politikë për formulimin e projekt- ligjit zgjedhor, i cili do të mundësonte zgjedhjen e 80 deputetëve sipas sistemit të shumicës dhe 40 deputetë sipas sistemit proporcional. Sipas listës proporcionale, mandatet duhej të ndaheshin proporcionalisht në 12-15 njësi zgjedhore rajonale.¹³⁷

Pas shumë debateve dhe “pazareve” politike u pranua variant i sistemit zgjedhor të kombinuar, sipas të cilit 85 deputetë do të zgjidheshin sipas sistemit të shumicës dhe 35 deputetë sipas sistemit proporcional. Në bazë të nenit 85 të ligjit në fjalë si kandidat i zgjedhur cilësohej kandidati i cili kishte fituar shumicën e votave të elektoratit në njësinë zgjedhore përkatëse, me kusht që ky numër të mos ishte më i vogël se 1/3 e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën zgjedhore për atë njësi zgjedhore. Në qoftë se asnjë prej kandidatëve nuk fitonte numrin e nevojshëm të votave, pas 14 ditësh zhvillohej raundi i dytë i votimeve, në të cilin merrnin pjesë vetëm dy kandidatë të njësisë zgjedhore të cilët kishin fituar më shumë vota në raundin e parë zgjedhor. Kandidatët nuk kishin të drejtë të tërhiqeshin nga lista zgjedhore, ndërsa fituesi konsiderohej ai i cili do të fitonte më shumë vota të elektoratit për atë njësi zgjedhore. Në qoftë se të dy kandidatët fitonin numër të njëjtë të votave, që teoritikisht ishte e mundur, shorti përdorej si mekanizëm që vendoste se kush do ta përfaqësonte trupin zgjedhor të asaj njësie zgjedhore në parlament. Në këtë rast vlen të theksohet se ekziston një dallim i ngushtë ndërmjet legjitimitetit të deputetëve që zgjidheshin në raundin e parë dhe atyre që zgjidheshin në raundin e dytë.¹³⁸

Tridhjetë e pesë mandate të tjera ndaheshin sipas parimit të proporcionalitetit, ku tërë territori i Maqedonisë ishte një njësi zgjedhore. Në rastin konkret votuesit përcaktoheshin për njërën nga lista e partive politike, duke mos pasur mundësi të ndikonin në radhitjen e kandidatëve në listat zgjedhore. Aplikimi i sistemit proporcional për 3

¹³⁷ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 477).

¹³⁸ *Po aty*.

mandate të mbetura linte hapësirë për manipulim nga elita partiake. Meqenëse lista zgjedhore ishte e pandryshueshme, ajo ofronte mundësi për vendosjen e kryetarëve të partive dhe personave më me pozitë në parti në listën zgjedhore, me gjasa të mëdha që këto persona do të fitonin ulëse në parlament. Pavarësisht fenomeneve të hasura, sistemi proporcional ka anët e tij pozitive, me qëllim që personat që kanë fuqi vendimmarrëse të veprojnë me arsye dhe të jenë në shërbim të interesave të gjërave partiake.

Për shembull, në listat zgjedhore të sistemit proporcional, personat me fuqi vendimmarrëse në parti mund të emërojnë persona të aftë dhe me eksperiencë të gjatë politike, të cilët kur i nënshtrohen proceseve konkurruese brenda strukturave partiake për arsye të ndryshme nuk arrin të jenë të përzgjedhur. Sidoqoftë, në rastin konkret votuesit zgjedhin detyrimisht partinë dhe jo kandidatët. Nga ana tjetër kjo ndikon në minimizimin e vlerave të figurave dhe personaliteteve politike dhe jep shtysë avancimit të vlerave të partive politike si subjekte të organizuara. Si rezultat oligarkia ka përparësi karshi antarsisë së gjerë.¹³⁹

Ky model iu mundëson liderëve partiakë të radhiteshin të parët në listat zgjedhore, duke fituar lehtësisht edhe ulëse në parlament. Ndarja e mandateve të 35 deputetëve që zgjidheshin sipas modelit proporcional, ishte rregulluar me nenin 93 të ligjit për përzgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Maqedonisë të vitit 1998. Mandatet llogariteshin në bazë të formulës së “D’Hondit” dhe gjatë procedurës së përfitimit të mandateve sipas ligjit, merrnin parasysh vetëm listat e partive politike që siguronin prapësin e zgjedhor prej 5% nga numri i përgjithshëm i votave të fituara nga votuesit që kishin shfrytëzuar të drejtën e votës.¹⁴⁰

Menjëherë pas zgjedhjeve të treta parlamentare në të cilat u aplikua për herë të parë sistemi zgjedhor paralel, filluan të bëheshin analizat e para mbi efektet pozitive dhe negative të aplikimit të këtij sistemi. Kritikkat ndaj sistemit të kombinuar mazhoritar me elemente proporcionali ishin të shumta, do të thotë se çështja e modelit zgjedhor në mbetet aktuale gjatë tërë periudhës së tranzicionit. E gjithë kjo na bën me dije se procesi zgjedhor në përgjithësi dhe modeli zgjedhor në veçanti kanë një rëndësi të veçantë, si për qytetarët e një shteti ashtu edhe për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në garat zgjedhore. Prandaj, është

¹³⁹ Shih: Aziri f. 478.

¹⁴⁰ *Po aty*

më se e nevojshme një qasje me përgjegjësi shumë të madhe gjatë përpilimit të reformave zgjedhore, që nënkuptonin respektimin e qëndrimeve të gjithë faktorëve të interesuar, të cilët ndërlidhen me zgjedhjet dhe rregullativën zgjedhore. Pra, reformat zgjedhore, ligjet zgjedhore dhe sistemet zgjedhore nuk duhet të shikohen thjesht vetëm si çështje teknike, por shumë më shumë se kaq.

Në këtë kontekst duhet thënë se rregullativa zgjedhore e periudhës në fjalë nuk i kënaqte ambiciet dhe nevojat e praktikës pluraliste të Maqedonisë. Në vitin 1999 u bënë ndërhyrjet e para të ligjit të atëhershëm, gjegjësisht u bë ndryshimi dhe plotësimi i ligjit zgjedhorë të vitit 1998. Ashtu siç u cek edhe më lart, sistemi zgjedhor në Republikën e Maqedonisë nuk cilësohet as i përsosur dhe as i përkryer. Ligji zgjedhor në mënyrë permanente ka përjetuar ndryshime, zgjerime, tejkalim të parimeve të mëparshme, ndërtim të parimeve të reja e kështu me radhë. Forcat e reja shoqërore dhe sistemi politik detyrimisht kërkojnë qasje të re dhe vendosje të parimeve të reja të sistemit zgjedhor. Me fjalë të tjera, raportet e reja në shoqëri kërkojnë edhe sistem të ri zgjedhor. Ndryshimi i rregullativës zgjedhore është dukuri që ndjek sistemet zgjedhore bashkëkohore, duke lënë të kuptohet që nuk është vetëm karakteristikë e Maqedonisë, por dukuri që haset edhe në vendet tjera. Sistemi zgjedhor është i një rëndësie të veçantë pasi është indikator themelor në shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve.¹⁴¹

Pra, duke u nisur nga mangësitë që u shfaqen gjatë aplikimit të ligjit zgjedhorë të vitit 1998, si gjatë zgjedhjeve ashtu edhe pas tyre, si dhe rrjedhave aktuale shoqërore-politike, u paraqit nevoja e sjelljes së një ligji të ri zgjedhor, i cili do të dallojë në shumë dimensione nga ligji i mëparshëm. Kështu qeveria e RM-së në shtator të vitit 2001, i ofroi Kuvendit Republikan projekt ligjin që përmbante dy alternativa të mundshme. Sipas alternativës së parë numri prej 120 deputetësh të mbetej i pandryshuar dhe zgjedhja e tyre bëhej në bazë të sistemit proporcional ku i tërë territori i RM-së do të paraqiste një njësi zgjedhore.¹⁴² Sipas variantit të dytë 60 deputetë ose 50% nga numri i përgjithshëm të zgjidheshin sipas sistemit të shumicës dhe 60 të tjerë sipas atij proporcional, ndërsa tërë territori shtetërorë të përbënte një njësi të vetme zgjedhore.

¹⁴¹ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 479).

¹⁴² Aziri. *Po aty*, f. 478.

Sipas këtij propozimi në njësitë zgjedhore mund të kishte prej minus 7% deri më plus 7% përjashtim në raport me numrin mesatar të votuesve në njësitë zgjedhore. Si rrjedhojë ky projekt-ligj parashikonte si formë të mundshme aplikimin e sistemit zgjedhorë proporcional ose atë të përzier, por për dallim nga ligji zgjedhor i vitit 1998 ku vetëm 35 deputetë zgjidheshin sipas sistemit proporcional, sipas propozimit në fjalë numri i deputetëve të zgjedhur në bazë të proporcionit do të ishte 60 deputetë. Ky projekt-ligj nuk iu nënshtrua votimit në Parlamentin Republikan.¹⁴³

Megjithatë pas shumë debateve dhe polemikave, Kuvendi u përcaktua për një variant të tretë, për modelin proporcional, ku territori shtetërorë do të ndahej në gjashtë njësi zgjedhore me përafërsisht numër të njëjtë të zgjedhësve dhe secila prej tyre do të zgjedhë 20 deputetë. Ky variant u votua në kuvend. Në dallim nga projekt-ligji i fundit, variant tashmë i pranuar parashikon një tolerancë prej -3 deri në +3 tre % në raport me numrin mesatar të votuesve në njësinë zgjedhore. Rezultatet e zgjedhjeve të katërta parlamentare dëshmuuan qartë se ky model zgjedhor favorizon partitë e mëdha dhe të fuqishme në dëm të partive të vogla dhe kandidatëve të pavarur. Një dukuri e këtillë nuk mirëpritet në jetën pluralo partiake të Maqedonisë dhe nuk i shërben demokratizimit të mirëfilltë të saj në sferën e zgjedhjeve. Nga ana tjetër, ky model forcon skajshmërisht pozicionet e liderëve dhe bërthamave partiake, që do të reflektojë negativisht në demokracinë brendapartiake. Sa i takon organizimit politik të shqiptarëve, ky variant afirmon qëndrimin politik se për shqiptarët e Maqedonisë një parti politike është pak ndërsa tre janë shumë megjithatë një pjesë e politikanëve edhe më tej shprehin rezervat e tyre me pretendimin se ky model zgjedhor dëmton subjektin politik shqiptar.¹⁴⁴

Për faktorin politik shqiptar do të kishte qenë më e drejtë dhe në favor të tyre aplikimi i modelit proporcional, ku tërë territori i Maqedonisë do të përbënte një njësi të vetme zgjedhore. Edhe subjektet e tjera në Maqedoni paraqesin kohë pas kohe kritikën e tyre ndaj sistemit aktual. Së fundmi, rregullativa zgjedhore duhet të jetë në shërbim të votuesve, qytetarëve në përgjithësi dhe demokracisë, e jo e kundërta ku demokracia dhe votuesit vihen në shërbim të rregullativës zgjedhore. Praktika zgjedhore në Republikën e Maqedonisë brenda këtyre viteve të pluralizmit ka qenë mjaft dinamike, e kritikuar dhe

¹⁴³ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 480).

¹⁴⁴ *Po aty*.

shumë jo e mirëpritur në mesin e forcave politike, sidomos nga pjesa jo maqedonase e elektoratit zgjedhorë.¹⁴⁵

Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh se ligjet zgjedhore janë vetëm një segment që ndikon që zgjedhjet të jenë demokratike, të lira dhe korrekte. Nuk mund të ketë zgjedhje të lira demokratike korrekte pa përparimin e pozitës materiale të shoqërisë, ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kulturës politike në mesin e qytetarëve, funksionimin e shtetit ligjor etj.¹⁴⁶

3.3 Aspekti instrumentalist dhe funksionalist i zgjedhjeve në R. M.

Teoritikisht shiquar ekzistojnë më tepër qasje ndaj zgjedhjeve dhe sistemeve zgjedhore. Kjo flet qartë për rëndësinë e zgjedhjeve si një fenomen universal. Të gjitha format dhe veprimet gjatë zgjedhjeve patjetër më shumë ose më pak të përputhen me ndonjë qasje konkrete teorike, pasi që teoria dhe praktika paraqesin dy anë të po të njëjtës monedhë.

Kur flasim për aspektin instrumentalist dhe funksionalist të zgjedhjeve para së gjithash mendojmë në atë se me cilën filozofi të zgjedhjeve kanë më shumë ngjajshmëri zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qasjen instrumentaliste ose funksionaliste.

Sipas instrumentalistëve zgjedhjet thjesht trajtohen si një vegël për marrjen e pushtetit shtetërorë. Nga ana tjetër funksionalistët mendojnë se zgjedhjet si formë e deklarimit të qytetarëve paraqesin diçka më shumë se një instrument për marrjen e pushtetit, se ata mbajnë llogari edhe për funksionimin e sistemit politik si tërësi.

Në qoftë se nga këta dy aspekte analizohen zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej fillimit të jetës shumë partiake e kemi vështirë me një saktësi më të madhe ti vlerësojmë çështjet.

Shiquar pastër nga aspekti deklarativ i elitave garuese në zgjedhje krijohet përshtypje se subjektet garuese para se gjithash angazhohen për demokratizimin e vendit, dhe perspektivat afat gjatë të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹⁴⁵ Aziri, E. *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. SEEU, (Tetovë, 2015, f. 472).

¹⁴⁶ *Po aty*.

Nga kjo mundemi të futemi në grackën e partive politike dhe të sjellim përfundim të gabueshëm se në Republikën e Maqedonisë së Veriut zgjedhjet qëndrojnë në dimensionin e konceptit funksionalist.

Megjithatë diçka krejt tjetër flasin analizat e mirëfillta empirike por edhe deklaratat e faktorëve relevant ndërkombëtarë të cilët veç tjerash e masin edhe nivelin e demokracisë gjatë proceseve zgjedhore. Analizat empirike qartësojnë se subjektet politike në Republikën e Maqedonisë së veriut ngërthejnë në vete një dozë të lartë të „makiavelizmit negativ,, dhe se ata janë të interesuara ekskluzivisht për marrjen dhe ushtrimin e pushtetit shtetërorë.

Së fundi demokracia, demokracia partiake dhe zhvillimi i një sistemi politik varen nga më shumë faktorë. Sikurse duket sa u përket zgjedhjeve elitat politike por edhe votuesit si mbartës të sovranitetit shtetërorë duhet të mësojnë edhe shumëçka.

3.4 Zhvillimi i zgjedhjeve dhe proceseve zgjedhore deri në zgjedhjet parlamentare 2016

Edhe pse në fokus të interesimit tonë janë zgjedhjet parlamentare ajo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se informatat shtesë, ose informatat e plotësuara edhe me të dhëna nga zgjedhjet vendore dhe presidenciale e zbehin esencën e këtij punimi.

Një parametër tepër i rëndësishëm është dalshmëria e qytetarëve në zgjedhje. Mosdalja në zgjedhje në rrethana të Republikës së Maqedonisë së Veriut nënkupton edhe keqpërdorimet të procesit votues si dhe dhunimin e votës së lirë, gjegjësisht dhunimin e vullnetit të elektoratit. Në tabelën numër një japim një pasqyrë të zgjedhjeve në përgjithësi të organizuara në Republikën e Maqedonisë Veriut prej vitit 1991 e deri më vitin 2019-të.

Tabela1. Kronologjia e zhvillimit të zgjedhjeve në jetën pluraliste të R. M. V-së

Viti	Lloji i zgjedhjeve	Përqindja e votuesve
1991	Parlamentare	84,82%
1994	Parlamentare rrethi i pare & i dyte	72,29%. /57,83%
1994	Presidenciale	77,76%
1996	Lokale	60,28%
1998	Parlamentare	72,9%
1999	Presidenciale	65,23%
2002	Parlamentare	73,54%
2006	Parlamentare	55,98%
2008	Parakohshme parlamentare	57,06%
2009	Presidenciale/ Lokale	43%/57%
2011	Parakohshme parlamentare	63,5%
2013	Lokale	64,8%
2014	Presidenciale/Parlamentare	54%/63%
2016	Parlamentare	66,79%
2017	Lokale	59,51%
2019	Presidenciale	46.65%,

Dalja në zgjedhje në Republikën e Maqedonisë¹⁴⁷

¹⁴⁷ Ademi, Gj. *Zgjedhjet dhe apatia politike në Republikën e Maqedonisë*. Përmbledhje kumtesash të konferencës së katërt shkencore të FShSHB, Fillet e pluralizmit Politik në Maqedoni dhe Post – Komunizmi. SEEU, (Shkup, 2019, f. 220).

Mosshfrytëzimi i të drejtës së votës është vetëm një segment që ndërlikohet me apatinë politike. Megjithatë kjo është formë manifestuese. Zbulimi i shkaqeve dhe motiveve është proces tejet i ndërlikuar që kërkon angazhim më të madh e më serioz. Për fat të keq, kësaj dukurie që kërkon një punë kolektive ekipore, në Republikën e Maqedonisë tani për tani nuk i kushtohet vëmendja e duhur. Apatia politike në një farë mënyre shihet edhe nga përqindja e votuesve që marrin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, vendore dhe qendrore.

Në Republikën e Maqedonisë në këtë drejtim gjendja është si vijon: Në vitin 1991 nga gjithsej 1. 452. 071 votues në votim dolën 1.120. 866 persona ose 84, 82%.

Në zgjedhjet e dyta parlamentare kemi rënie të përqindjes së votuesve që shfrytëzuan të drejtën e votës për 7. 53%, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i votuesve prej 1. 487. 367 në votim dolën vetëm 1.051.665 ose 72,29%. Në vitin 1994 në rrethin e dyte në njësitë zgjedhore në të cilët kishte rizgjedhje në votim dolën vetëm 57, 83%. Kjo dëshmon për dy gjëra: Si e para, votuesit lodhen nga votimet e një pas njëshme dhe si e dyta ata nuk janë të përgatitur ti gëlltisnin lehtë kalkulimet dhe pazarllëqet e partive politike. Duhet të thuhet edhe ajo se në zgjedhjet presidenciale votuan 77, 76%, për diçka më tepër se në zgjedhjet parlamentare.

Në zgjedhjet vendore të vitit 1996 për këshilltarë komunal votuan nga 1. 423. 020 votues të regjistruar, 856. 236, pra 60, 17% ndërsa përqindja e qytetarëve që votuan për kryetarë të komunave qe 60, 28%. Ndërsa për rrethin e dytë në njësitë e qeverisjes vendore në votimet për kryetar votuan vetëm 50,84% të votuesve. Pra në zgjedhjet vendore të vitit 1996 vërehet rënie e madhe e interesimit për votim. Në qoftë se i analizojmë rrethanat dhe kushtet në të cilët u mbajtën zgjedhjet vendore të vitit 1996, me siguri do të vijmë në përfundim se mosinteresimi i votuesve para se gjithash është rezultat i klimës së përgjithshme politike, respektivisht rezultat i një apatie politike artificialisht të imponuar.¹⁴⁸

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998, që u mbajtën si pas sistemit të kombinuar, përsëri erdhi te një rritje e numrit të votuesve që shfrytëzuan të drejtën e votës, por përsëri përqindja e votuesve ishte nën nivelin e zgjedhjeve parlamentare të viteve 1990 dhe 1994. Kështu nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar i cili ishte 1. 572. 976 veta, për

¹⁴⁸ Aziri, E. *Partitë politike dhe demokracia*. Logos A, (Tetovë, 2004, f. 191-196).

listat proporcionale votuan 1. 146. 457 ose 72, 9%. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 në numrin e përgjithshëm të votuesve që e shfrytëzuan të drejtën e votës me siguri ka ndikuar edhe koalicioni parazgjedhorë i partive politike më me relevancë (për atë kohë), PDSH-së dhe PPD-së.

Në vitin 1999 në Republikën e Maqedonisë u mbajtën zgjedhjet presidenciale të cilët përsëri shënojnë rrënie të interesimit të votuesve. Nga numri i përgjithshëm prej 1. 610. 340 zgjedhësve, të drejtën e votës e shfrytëzuan 1. 050.449 ose 65, 23%. Këtë rënie të interesit para se gjithash duhet kuptuar si rezultat të një mosinteresimi për zgjedhjet presidenciale. Një numër i qytetarëve të etniteteve të ndryshme nuk sheh ndonjë interes të veçantë nga institucioni “kryetar shteti”. Kësaj duhet shtuar edhe acarimin e raporteve midis partnerëve që e përbënin koalicionin qeveritar.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 u mbajtën në një atmosferë mjaft të tendosur politike dhe shpirtërore. Megjithatë numri i qytetarëve që e shfrytëzuan të drejtën e votës ishte diçka më i madh se në zgjedhjet e parafundit. Nga numri i përgjithshëm të regjistruar (1.6 milion), të drejtën e votës e shfrytëzuan 1. 222. 711 qytetarë ose 73, 54%.¹⁴⁹ Ky ishte në fakt konkursi i parë zgjedhor i cili mbahet pas konfliktit ndër-etnik që rezultoi në kuadër të Marrëveshjes së Ohrit, e cila i dha fund krizës së vitit 2001. Si pasojë, zgjedhjet e vitit 2002 ishin vendimtare për stabilitetin e vendit, dhe kjo ndoshta shkaktoi një rritje në pjesëmarrjen e votuesve.¹⁵⁰

Në zgjedhjet parlamentare të 2006, nga gjithsej 1.741.449 votues, të drejtën e tyre për votim e shfrytëzuan 937.018 qytetar, apo 55.98%. Nga zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në vitin 2002, shohim se dalja në zgjedhje në mënyrë drastike ka rënë, edhe atë për rreth diku 18%. Kjo mund të ishte si pasojë e zgjedhjeve të njëpasnjëshme ku te trupi votues shihet një lodhje e madhe, nga se në periudhë dy vjeçare u mbajtën tre cikle zgjedhore.

Në vitin 2004 kishim zgjedhjet presidenciale, në vitin 2005 ato lokale kurse në 2006 zgjedhje parlamentare. Qeveria e formuar nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2006,

¹⁴⁹ Aziri, E. *Partitë politike dhe demokracia*, Logos A, (Tetovë, 2004, f. 191-196).

¹⁵⁰ Petričušić, A. *Democracy without Citizens: Inadequate Consolidation in Two Decades of the Western Balkans Democracy*. University of Zagreb, (Croatia, 2013), Marrë nga: https://bib.irb.hr/datoteka/645738.EQPAM-Antonija_Petricusic-Vol2No4October2013CCR.pdf

ndërmjet VMRO DPMNE-së dhe PDSH-së, pas vetëm 18 muaj qeverisje shpalli zgjedhje të parakohshme.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 kemi rritje të trupit votues, diku për 2%, apo rreth 37000 votues të cilët për herë të parë shfrytëzonin të drejtën e votës. Mirëpo edhe pse kishim rritje të trupit votues dalja në zgjedhje thuhet se ngeli e njëjtë si në zgjedhjet paraprake parlamentare të vitit 2006. Nga gjithsej 1.779.116 qytetar me të drejtë vote, 986.991 votues apo 57.06% e qytetarëve shfrytëzuan rastin që të jenë pjesë e dhënies së legjitimitetit ekzekutiv të ri në Republikën e Maqedonisë.

Mandati 5 vjeçar i Presidentit të shtetit si dhe kryetarëve dhe këshilltarëve komunal mbaronte diku në maj të vitit 2009, kështu që u vendos që në mars të vitit 2009 të mbahen bashkarisht rrethi i parë i zgjedhjeve për President dhe zgjedhjet për pushtetin lokal. Nga 1.792.082 qytetar me të drejtë vote, në zgjedhjet Presidenciale të vitit 2009, vetëm 764.039 qytetar votuan apo diku rreth 43%. Ky numër i vogël i qytetarëve që shfrytëzuan të drejtën e votës është si rezultat i asaj se shumica e shqiptarëve nuk dolën në vendvotime. Përzgjedhjet lokale, numri i qytetarëve që shfrytëzuan të drejtën e votës është shumë më i madh në krahasim me ato Presidenciale. Nga 1.792.082 qytetar me të drejtë vote, 1.019.241 apo rreth 57% votuan për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve komunal.

Në vitin 2011 sërish u shpërnda parlamenti para kohe dhe u organizuan zgjedhje të parakohshme parlamentare. Të paraqitur në listën zgjedhore me të drejtë vote ishin 1.821.122 qytetarë, dikur rreth 29000 më tepër se zgjedhjet e kaluara, mirëpo të drejtën e tyre e shfrytëzuan një numër shumë më i madh se sa në zgjedhjet lokale, 1.156.049 apo rreth 63.5%.

Përderisa në çdo cikël zgjedhor numri i trupit votues rritej nga 2% përafërsisht, në vitin 2013, gjatë organizimit të zgjedhjeve lokale dhe përpilimit të listës votuese u paraqit një fenomen i ri, numri i trupit votues u zvogëlua për rreth 78000 votues apo 4.5%. Nga 1.743.403 votues, të drejtën për të votuar e shfrytëzuan 1.129.840 votuar apo 64.8%. Dalja në këto zgjedhje ishte e njëjtë si në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, por ndryshim më i madh shumë interesant ishte zvogëlimi i numrit të trupit votues. Gjithashtu një fenomen tjetër interesant ishte se dikur rreth 40000 votues kanë marrë fletë votimet me përzgjedhjen e këshilltarëve komunal dhe jo përzgjedhjen e kryetarit të komunës. Numri i

votuesve që shfrytëzuan të drejtën e tyre për zgjedhjen e Këshillit të komunës, në nivel shteti është 1.167.768 apo 67%.

Nga viti 2006, asnjë strukturë qeveritare nuk e kreu mandatin e saj 4 vjeçar, nga se çdo herë shpërndahej parlamenti dhe shkohej në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Për vitin 2014 ishin të parapara zgjedhjet presidenciale të cilat duheshe të mbahen diku kah mesi i prillit. Mirëpo për shkak të mospranimit të propozimit të partnerit të koalicionit qeveritar nga blloku shqiptar për president konsensual nga partia në pushtet nga blloku politik maqedonas, Parlamenti sërish u shpërnda dhe bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale u caktuan edhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare për vitin 2014. Nga 1.780.128 qytetarë me të drejtë vote, 63% e tyre apo 1.120.744 dolën dhe dhanë legjitimitetin se kush do t'i udhëheq në 4 vitet e ardhshme.

Mirëpo dalja nuk ishte e njëjtë edhe për zgjedhjen e Presidentit të shtetit. Vetëm 54,38% apo 967.694 qytetarë dhanë votën e tyre për zgjedhjen e Presidentit.¹⁵¹ Ky dallim i madh në këto dy cikle zgjedhore vijnë si rezultat i bojkotit dhe thirrjes së partisë më të madhe në bllokun shqiptar që mos të votohet President i një anshëm. Edhe pse qartësisht negativ në dukje, abstenimi është një dukuri me përbërës të ndryshëm. Ekzistojnë shumë forma të abstenimit, me shkaqe dhe domethënie të ndryshme. Ky lloj abstenimi si në rastin e lartpërmendur është formë e ashtuquajtur abstenim luftarak. Ai manifestohet kur një formacion politik u jep ithtarëve të vet rekomandimin e hapur për të abstenuar në rast të një kërkesë elektorale të cilën ajo e kundërshton në parim ose mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve: zgjedhje të dështuara si të manipuluara ose referendum i denoncuar si kurth.

Abstenimi luftarak dallohet në mënyrë të qartë nga format e tjera të abstenimit, sepse ai përben, nëse mund ta quajmë kështu, një pjesëmarrje në zbrazëti. Duke mos qenë aspak shenja e një mungese angazhimi nga ana e atyre që e ndjekin, kjo këshillë manifeston, përkundrazi, vullnetin për ta bërë të dëgjohet një pikëpamje me një forcë të veçantë. Përveç kësaj, kjo lloj përçapje është, në parim, e lidhur me një konjunkturë krejt të veçantë. Kur kjo rrethanë kalon, atëherë forcat që kanë bërë thirrje për bojkot, në zgjedhje do t'u rikthehen praktikave më normale.¹⁵²

¹⁵¹Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet presidenciale 2014, Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>

¹⁵²Jean-Marie Denquin. *Hyrje në Shkenca Politike*. UET Press, (Tiranë, f.72).

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në listën zgjedhore sa i përket zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 në R. M. është 1.784.416, nga të cilat 1.191.852 votuan dhe ishin pjesëmarrës në procesin zgjedhorë, që do me thënë se kemi një pjesëmarrje prej 66.79%.¹⁵³

Ndërsa numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në listën zgjedhore sa i përket zgjedhjeve lokale të vitit 2017 në R,M është 1.814.644. Numri përgjithshëm i votuesve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e votës është 1.079.876. Përkthyer në përqindje dalja e votueseve që kanë votuar sa i përket këtyre zgjedhjeve është 59,51%.¹⁵⁴

Në zgjedhjet presidenciale të fundit kandidati i mbështetur nga LSDM, BDI dhe partnerë të tjerë të koalicionit, Stevo Pendarovski fitoi shumicën e votave në të dy rrethet e zgjedhjeve dhe arriti të fitojë zgjedhjet presidenciale në vitin 2019. Në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, 753.556 qytetarë dolën për të votuar, që është 41.68% nga gjithsej 1.808.131 qytetarë me të drejtë vote. Numri i përgjithshëm i votuesve që votuan në rrethin e dytë arriti në 46.65%, përkatësisht votuan gjithsej 843.508 nga gjithsej 1.808.131 votues të regjistruar. Edhe këto zgjedhje presidenciale kanë konfirmuar trendin e rënies së interesit të qytetarëve për pjesëmarrje në procesin zgjedhor.¹⁵⁵

Derisa në zgjedhjet e para presidenciale, të mbajtura në vitin 1994, kanë votuar 77.76% e votuesve në zgjedhjet në vitin 2014 dhe 2019 votuan rreth tridhjetë për qind më pak votues në krahasim me zgjedhjet e vitit 1994, përkatësisht 54,38% në vitin 2014 dhe 46.65% në vitin 2019 të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar. Ky trend i rënies, dhe vështirësitë e sigurimit të censurit e kërkuar prej 40% në rrethin e dytë, si dhe pasiguria politike në një rezultat të tillë, përsëri inicuan një debat në lidhje me atë nëse është e nevojshme që presidenti të zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, ose të zgjidhet nga Kuvendi.¹⁵⁶

¹⁵³ Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet parlamentare 2016. Marrë nga: <http://www.sec.mk/izbori-arhiva/>

¹⁵⁴ Ademi, Gj. *Zgjedhjet dhe apatia politike në Republikën e Maqedonisë*. Përmbledhje kumtesash të konferencës së katërt shkencore të FShSHB, Fillet e pluralizmit Politik në Maqedoni dhe Post – Komunizmi. SEEU, (Shkup, 2019, f. 224).

¹⁵⁵ Zgjedhjet Presidenciale 2019. Marrë nga: <https://rezultati.sec.mk/mk-MK/1/r>

¹⁵⁶ Botimi i dytë i plotësuar. *Manual për zgjedhjet presidenciale 2019 në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Fondacioni Konrad Adenauer Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup. Marrë nga: http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf

3.5 Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare 1990/2016

Zgjedhjet e para parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut u mbajtën në gjendje pasigurie, në një ambient ku mungonte edhe minimumi i kulturës pluralo-politike, në një gjendje ku tensionimet ndëretnike kishin arritur kulmin e tyre dhe më në fund në një gjendje ku varfëria dhe pasiguria socio-ekonomike vëreheshin me sy të rëndomtë. Edhe përpos kësaj politikisht mundej të identifikoheshin tendencat djathtiste dhe majtiste.

Tabela 2. Rezultatet e zgjedhjeve të para parlamentare të vitit 1990

Zgjedhjet e vitit 1990	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE	38
LKP-PTD	31
PPD	17
LFRM	11
PSM	4
PJ	2
PDP	1
Deputetë të pavarur	3
Koalicionet	
PPD/PDP	5
LFRM/ PRDP	6
PSM/LFRM/PRSDP	1
PERP/PSM	1
Gjithsej	120

P.S.¹⁵⁷

Këta zgjedhje u karakterizuan me një numër të konsiderueshëm të partive politike të cilët siguruan ulëse në parlamentin republikan. Si zakonisht beteja politike u zhvillua në dy drejtime, në aspektin ideorë ndërmjet forcave djathtiste që identifikoheshin me VMRO-DPMNE dhe forcave majtiste që identifikoheshin me SDSM. Aspekti tjetër i zgjedhjeve ishte aspekti etnik ku lufta politike zhvillohej ndërmjet partive maqedonase që më tepër mbanin llogari për dominancë se sa për ndërtimin e kapaciteteve demokratike institucionale dhe partive shqiptare që në këtë fazë angazhoheshin për të siguruar vend në nën qiellin pluralist të vendit. Edhe pse VMRO-DPMNE siguroi më shumë mandate (por jo edhe të

¹⁵⁷ Arhiva shtetërore zgjedhore . Marrë nga :<http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/>

mjaftueshme) nga të gjitha partitë garuese ajo nuk u bë pjesë e qeverisë së parë partiake e cila u formua pas dështimit të qeverisë së ekspertëve të udhëhequr nga kryeministri i parë, Nikolla Klusev. Dy partitë shqiptare së bashku siguruan 23 ulëse në parlamentin republikan dhe paraqitnin faktorë të rëndësishëm në jetën politike të vendit. Njëra nga ato, PPD u bë edhe pjesë e koalicionit qeverisës.

Tabela 3. Rezultatet e zgjedhjeve të dyta parlamentare të vitit 1994

Zgjedhjet e vitit 1994	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni “Lidhja për Maqedoni” (LSDM, PLM, PSM)	95
PPD	10
Kandidat të pavarur (Krahu i Arbën Xhaferit)	4
PDP	4
PDM	1
PCERM	1
PSDM	1
PDTM/PAD	1
Kandidat të pavarur	3
Gjithsej	120

P.S.¹⁵⁸

Zgjedhjet e dyta parlamentare sikurse që potencuam më lartë u mbajtën sipas po të njëjtit sistem zgjedhorë, edhe përpos shumë ankesave nga subjektet politike garuese të cilat secila nga këndvështrimi i vet i potenconin anët negative të sistemit në fjalë. Në këta zgjedhje erdhi në shprehje një pjekuri më e madhe politike. Në aspektin ideorë forcat majtiste fal bojkotimit të zgjedhjeve në qarkun e dytë nga VMRO-DPMNE shënuan rezultat shumë lartë zgjedhor. Aleanca për Maqedoni e udhëhequr nga SDSM siguroi 60 mandate të mjaftueshme që pa problem të formon qeverinë. Megjithatë SDSM për shkak të një „makijazhi politik,” në qeveri e inkadroi edhe PPD-në si parti shqiptare. Sa u takon partive shqiptare pa tjetër të përmendet se mes zgjedhjeve të para dhe të dyta parlamentare

¹⁵⁸ Shih: Aziri. *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. Logos A. (Shkup, f. 181).

ndodhën përçarjet të PPD dhe formimin e „krahut të fortë,, dhe „krahut të butë,, të kësaj partie. Si rrjedhojë ndodhi rënia e numrit të deputetëve shqiptarë në parlament. Në këta zgjedhje PPD siguroi 10 ulëse, PDP siguroi 4 ulëse dhe përfaqësuesit e krahut të fortë të PPD (Më vonë të regjistruar si PPDSH) fituan 4 ulëse, pra gjithsej 18.

Tabela 4. Rezultatet e zgjedhjeve të treta parlamentare të vitit 1998

Zgjedhjet e vitit 1998	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE	49
LSDM	27
PPD	14
AD	13
PDSH	11
PLD-PDM	4
PSM	1
LRM	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet e treta parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut u mbajtën si pas sistemit zgjedhor të kombinuar dhe atë 85 sipas sistemit mazhoritarë dhe 35 sipas sistemit proporcional. Nga këto zgjedhje ngadhënjyese doli VMRO-DPMNE në koalicion me AD-në. Në këta zgjedhje për herë të parë ndodhi një koalicion parazgjedhor mes partive politike shqiptare, PPD-PDSH, të cilat siguruan së bashku 24 deputet. Karshi këtyre ulëse siguruan 93 deputet maqedonas.

Tabela 5. Rezultatet zgjedhjeve të katërta parlamentare të vitit 2002

Zgjedhjet e vitit 2002	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni “Bashkë për Maqedoninë”	60
LSDM	43
PLD	12
PDM	2
PBRM	1
LDB	1
PDS	1
Koalicioni VMRO DPMNE/PL	33
VMRO DPMNE	27
PL	5
PLTM	1
BDI	16
PDSH	7
PPD	2
PDP	1
PSM	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet e vitit 2002 u organizuan dhe u mbajtën në një situatë të tensionuar. Gjithandej ndjehej era e barutit si pasojë e konfliktit të vitit 2001. U aplikua sistemi zgjedhor proporcional, dhe formula e D, Hondit. I tërë territori i shtetit u nda në 6 njësi zgjedhore. Sa i takon bllokut maqedonas fitoi koalicioni i udhëhequr nga SDSM. Në organizimin politik të shqiptarëve ndodhi një ndryshim i madh. Partia e re e po sa formuar BDI duke siguruar 16 ulëse në parlament e mori primatin ndaj PDSH që siguroi 7 ulëse dhe PPD 2 ulëse. Pas këtyre zgjedhje duhej të hapet një faqe e re në zhvillimin e sistemit politik të Republikës së Maqedonisë Veriut. Kjo faqe e re duhej të nënkuptonte barazi më të lartë mes qytetarëve, etniteteve, feve, kulturave e kështu me radhë. Për fat të keq ajo nuk ndodhi së paku jo me dinamikën që pritej. Edhe sot sistemi politik i vendit më shumë është i prirur të gjeneron kriza se sa demokraci.

Tabela 6. Rezultati e zgjedhjeve të pesta parlamentare të vitit 2006

Zgjedhjet e vitit 2006	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni “Për Maqedoni më të mirë” VMRO DPMNE	45 38
Koalicioni “Bashkë për Maqedoninë” LDSM	32 23
Koalicioni BDI/PPD BDI PPD	17 14 3
PDSH	11
PRSD	7
VMRO-PR	6
RDM	1
PAE	1
Gjithsej	120

P.S.¹⁵⁹

Në zgjedhjet parlamentare 2006 e djathta maqedonase u rimëkëmb dukshëm. Koalicioni „Për Maqedoni më të mirë„ siguroi 45 ulëse dhe të drejtën për formim të qeverisë. Partitë shqiptare, BDI, PDSH dhe PPD së bashku siguruan 28 ulëse. Parti ngadhënjyese në bllokun shqiptarë ishte BDI me 14 ulëse në parlament. Prej këtyre zgjedhjeve filloi të afirmohet principi „fituesi me fituesin„ një princip që është në kundërshtim me demokracinë por edhe antikushtetues. Sikurse duket këta zgjedhje paraqesin fillimin e ndërtimit të sistemit me parti sunduese në stilin „alla Maqedoni„. Ky princip e largonte shtetin edhe më shumë nga ndërtimi i kapaciteteve demokratike dhe demokracia e mirëfilltë. Sistemi filloi të gjeneron kriza serioze.

¹⁵⁹ *Zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë*. Publikuar nga Instituti Parlamentar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 11 Tetor, Shkup. Përgatitur nga Njësia për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar, Nëntor 2014. Marrë nga:
<https://www.sobranie.mk/content/%D0%9F%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B8%D1%82%D1%83%D1%82/%D0%9F%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%BD%D0%B8%20%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8-ALB.pdf>

Tabela 7. Rezultatet e zgjedhjeve të gjashta parlamentare të vitit 2008

Zgjedhjet e vitit 2008	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni “Për Maqedoni më të mirë”	63
VMRO DPMNE	53
PSM	3
LD	1
RDM	1
PDTM	1
PDS	1
PBRM	1
VMRO-Maqedonase	1
PAD	1
Koalicioni i udhëhëqur nga LSDM	27
	18
	4
	3
	1
	1
BDI	18
PDSH	11
PAE	1
Gjithsej	120

160

Kriza që thellohej dita më ditë solli deri te zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008. Këta zgjedhje duhej të luanin rolin e një „ventili”, që do ta çlironte vendin nga energjitë negative. Megjithatë konstalacioni i forcave politike nuk mundësonte diçka të atillë. VMRO-DPMNE edhe më shumë i përforcoi pozicionet e veta. E njëjta gjë ndodhi me kampusin politik shqiptarë. BDI me 18 vende në parlament e siguroi dominancën brenda shqiptarëve. Në këta zgjedhje pësoi partia më e vjetër shqiptare, PPD.

¹⁶⁰ Agushi, M. *Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Shqipërisë - Analizë Krahasuese*. (Disertacion Doktorature i pa publikuar), SEEU, (Tetovë, 20017, f. 86-97).

Tabela 8. Rezultatet e zgjedhjeve të shtata parlamentare të vitit 2011

Zgjedhjet e vitit 2011	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO DPMNE	56
VMRO DPMNE	47
PSM	3
LD	1
RDM	1
PDTM	1
PDS	1
VMRO-Maqedonase	1
PAD	
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	42
LDSM	29
PRSD	4
PAE	3
PL	1
LUNT	1
PEPR	1
PPSM	1
Te pavarur	2
BDI	14
PDSH	8
RDK	2
LBD	1
Gjithsej	123

Sikurse duket pas zgjedhjeve parlamentare 2008-të zgjedhjet e parakohshme u shëndërruan prej përjashtimit në rregull. Të parakohshme ishin edhe zgjedhjet e viti 2011-të. Në korpusin maqedonas nuk ndodhi asgjë spektakulare. VMRO-DPMNE i ruajti pozicionet. Te partitë shqiptare ndodhi një „dridhje,, që ata nuk i shqetësoi. BDI mbeti e para nga partitë shqiptare, ndërsa PDSH dukshëm u zbeh. Pa marrë parasysh lëvizjet partiake, Maqedonia e Veriut nuk trasonte siguri për një të ardhme më të mirë. Ajo gjendej larg integritimeve euro-atlantike në plan të jashtëm, ndërsa në plan të brendshëm lulëzonte mito dhe korupcioni.

Tabela 9. Rezultatet e zgjedhjeve të teta parlamentare të vitit 2014

Zgjedhjet e vitit 2014	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO DPMNE	61
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	34
BDI	19
PDSH	7
RDK	1
OPQM	1
Gjithsej	123

P.S.¹⁶¹

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 edhe më shumë i forcuan pozicionet dominuese të VMRO-DPMNE -së. Në kampusin shqiptarë me ulëse në parlament dukshëm avancon BDI ndërsa PDSH definitivisht e humbi relevancën politike.

¹⁶¹Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë Raport i përkohshëm 31 mars – 19 prill 2016 22 prill 2016. Marrë nga: <https://www.osce.org/sq/odihr/elections/fyrom/235706?download=true>

Tabela10. Rezultatet e zgjedhjeve të nënta parlamentare të vitit 2016

Zgjedhjet e vitit 2016	
Partitë politike dhe Koalicionet	Numri i mandateve të fituara
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO DPMNE “Për një Maqedoni më të Mirë”	51
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM “ Për Jetesë”	49
BDI	10
PDSH	2
Koalicioni “Aleanca për Shqiptaret” (LR PDSH, RDK, Uniteti)	3
BESA	5
Gjithsej	120

P.S.¹⁶²

Megjithatë pas këtyre zgjedhjeve Republika e Maqedonisë së Veriut do të ballafaqohet me krizë permanente që solli deri te zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtë zakonshme të vitit 20016.

Në këta zgjedhje ndodhi ajo që edhe pritej. Dallimi mes koalicionit djathtist dhe majtist ishte vetëm dy ulëse në favor të djathtistëve. Te blloku shqiptarë edhe më tutje BDI avancoi karshi partive tjera, por siguroi vetëm 10 ulëse. Ulëset tjera u takuan tre partive shqiptare më të vogla. Meqë dy koalicionet maqedonase gati se barazuan, formimi i qeverisë u bë një punë shumë e rëndë. Lojtari kryesor i pluralizmit u bë BDI në plan të brendshëm, por faktori ndërkombëtarë definitivisht i solli majtistët në qeveri. Nga qeveria Zaev pritjet ishin shumë të mëdha, të arriturat janë këta që i shohim.

¹⁶² Arhiva shtetërore zgjedhore. Marrë nga:

<http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/>%D0%9F%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8%2011%D1%82%D0%B8%20%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D0%B5%D0%BC%D0%B2%D1%80%D0%B8/5_%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BE%D0%B4%20%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D0%B4%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8%20%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B8%202016%20-%20%D0%94%D0%98%D0%9A.pdf

Sa i përket zgjedhjeve parlamentare 2016, OSBE/ODIHR, procesin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Maqedon, e ka vlerësuar kryesisht të rregullt, të administruar mirë dhe pa incidente të mëdha.

Në raportin e OSBE/ODIHR thuhet se: "Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit ishin një hap thelbësor në zgjidhjen e krizës të thellë politike dy vjeçare. Forcat kryesore politike ranë dakord për një varg ndryshimesh ligjore dhe institucionale për të siguruar një fushë ligjore për këto zgjedhje. Fushata ishte konkurruese, por u zhvillua në një mjedis të karakterizuar nga mosbesimi publik në institucione dhe në sistemin politik, si dhe akuzat për shtrëngimin e votuesve. Administrata zgjedhore sfidoi me përgatitjet për zgjedhjet dhe tejkaloi një numër të afateve. Dita e zgjedhjeve në përgjithësi u administrua mirë dhe vazhdoi pa incidente të mëdha".¹⁶³

Ndërsa Ambasadori amerikan në Shkup, Jess Baily, i ka përshëndetur konkluzat e dala nga OSBE ODIHR, duke nënvizuar se pajtohet se zgjedhjet e parakohshme në Maqedoni më 11 dhjetor u realizuan në formë komplementare dhe se kryesisht janë respektuar të drejtat e njeriut. *"I bëj thirrje qeverisë së ardhshme që të vazhdojë të punojë në ndërtimin e kapaciteteve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, me qëllim që të zgjidhen të gjitha çështjet juridike dhe procedurale". "Zgjedhjet më 11 dhjetor paraqesin hapin e parë që Maqedonia si shtet të ecë drejt tejkalimit të krizës politike. I inkurajojmë partitë politike të cilat do ta përbëjnë qeverinë e ardhshme të punojnë në formë konstruktive me opozitën për ta lëvizur Maqedoninë drejt strukturave euroatlantike, veçanërisht sa i përket sundimit të drejtësisë", ka theksuar ambasadori amerikan, Jess Baily.*¹⁶⁴

¹⁶³ Raporti përfundimtar : THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS, 11 December, 2016 OSCE/ODIHR, Election Observation Mission Final Report. Marrë nga: <https://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/302136?download=true>

¹⁶⁴ OSBE/ODIHR: Zgjedhjet në Maqedoni të administruara dhe pa incidente të mëdha. Marrë nga: <https://www.evropaclire.org/a/28171943.html>

Kapitulli IV: Kushtet dhe rrethanat në vigjilje të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016

1. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016
2. Kriza ekonomike
3. Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në prag të zgjedhjeve
4. Thellimi i krizës së gjithëmbarshme dhe nevoja për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare 2016
5. Zgjedhjet parlamentare 2016 sfidë për tejkalimin e situatës së krijuar dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtim të Republikës së Maqedonisë drejtë bashkimit Evropian dhe strukturave të Natos.

4. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016

Kriza politike e vitit 2015 në Maqedoni ka qenë e determinuar nga një sërë faktorësh, të cilët gjejnë shtrirje përgjatë më tepër se një dekade. Në fakt, në këtë vit, realisht është sipërfaqësuar gjithë ajo krizë sistemore e pranishme në gjithë jetën institucionale. Krizës politike i ka paraprirë një degjenerim i skajshëm i jetës institucionale dhe publike nga qeveria e ish kryeministrit Gruevski, i cili kishte ardhur në pushtet nëpërmjet një oferte kryesisht ekonomike.

Fillimisht, platforma qeverisëse e ish kryeministrit Gruevski kishte qenë e përqendruar te problemet ekonomike dhe ai kishte premtuar se do ta nxjerrë vendin nga kriza e thellë ekonomiko-sociale. Por, me kalimin e kohës, qeverisja e tij, dalëngadalë kaloi në një autoritarizëm të theksuar me tone të thella ideologjike. Ky transformim autoritar, sipas shumë analistëve dhe njohësve të rrethanave, kishte krijuar një ambient të përshtatshëm për instalimin e korrupsionit enorm në nivele të larta të qeverisjes.

Nga ideja për një qeverisje të ndryshme nga ajo paraprakja e udhëhequr nga LSDM-ja, qeveria e ish kryeministrit Gruevski të cilën e përbënin VMRO-DPMNE dhe BDI, po instalonte logjikën e shtetit-parti dhe logjikën e kontrollit të të gjitha resurseve shtetërore dhe institucionale nga një grup njerëzish afër tij, të cilët tashmë kishin marrë në duar gjithë institucionet e shtetit dhe të gjitha institucionet që konsiderohen si të pavarura nga politika, siç është rasti me gjykatat.

Ngritja e një inxhenjeringu të sofistikuar të propagandës me para nga buxheti i shtetit kishte krijuar kontrollin e mendimit publik si një mundësi për t'iu kundërvënë këtij pushteti që dita-ditës po fundosej në korrupsion dhe në keqbërje tjera. Tashmë është bërë publike dhe ka procese gjyqësore për pronarë mediash dhe aktorë tjerë medial, të cilët kishin marrë miliona euro për të përkrahur dhe për të propaganduar politikat e korruptuara të qeverisë së ish kryeministrit Gruevski. Fuqizimi autoritar i qeverisjes së Gruevskit kishte ardhur dalëngadalë nëpërmjet kontrollit dhe blerjes së mediave, por edhe keqpërdorimeve elektorale. Jo rastësisht, Maqedonia e Veriut, ishte futur në një cikël të pafundëm të zgjedhjeve të parakohshme, të cilat i siguronin pushtetit autoritar të Gruevskit jetëgjatësi, fuqizim dhe kontroll.

Edhe pse flitej për një keqpërdorim të skajshëm të pushtetit nga ana e opozitës, deri në momentin para shpërthimit të bombave të përgjimeve, nuk kishte ndonjë verifikim faktik të kësaj situate në shtet, për shkak se gati të gjitha mediat relevante në shtet kontrolloheshin nga pushteti. Vetëm pak media kishin arritur që shpalojnë para opinionit keqpërdorimin e pushtetit. Një ndër këto media ishte edhe televizioni nacional A1, i cili më pas në mënyrë brutale, me forca policore do të mbyllej.

Zërat kundër nuk e gjenin hapësirën e duhur të reflektimit në opinion, por edhe aferat që tregonin për korrupsionin e pushtetit shuheshin me forcën e kërcënimeve dhe shantazhit. Sipas të gjitha institucioneve ndërkombëtare dhe të vendit, siç janë Freedom House, Reporterët pa kufi, etj, gjendja e mediave në Maqedoninë përshkruhej e zyrtë, ndërsa liria e mediave kërcënohej gjatë tërë kohës nga forca e pushtetit.

Me një opozitë dhe me media të demonizuara nga pushteti ishte krijuar një atmosferë e përgjithshme e frikës dhe e heshtjes përpara një pushteti që po absorbonte gjithçka në emër të progresit. Prapa shumë projekteve që propagandoheshin si me interes për qytetarët fshiheshin raste të mëdha të korrupsionit. Një ndër këto projekte ishte edhe “Shkupi 2014”, prapa të cilit fshiheshin shuma milionëshe, të cilat më pas u vërtetuan si të paligjshme dhe të cilat kishin shkuar për të forcuar oligarkët e pushtetit.

Edhe gjatë asaj kohë ka pasur hulumtime gazetareske, të cilat kanë vërtetuar se prapa këtij projekti qëndrojnë keqpërdorime të njerëzve të pushtetit. Ky projekt, përveç korrupsionit, kishte krijuar edhe një atmosferë acaruese brenda dhe jashtë vendit me idenë e antiaktivizimit, që vlerësohej se ishte anakronike dhe një instrument për të mbuluar korrupsionin, por edhe për të krijuar tensione ndëretnike në shoqëri.

Pavarësisht nga kritikrat e shumta nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, pushteti autoritar i Gruevskit vazhdonte me logjikën partiake dhe të korruptuar, ashtu siç po dëshmohej nga opozita dhe nga disa media të pavarura që i kishin rënë në fije këtij korrupsioni dhe kësaj logjike qeverisjeje. Kjo qeveri e udhëhequr nga ish kryeministri Gruevski e kishte stigmatizuar dhe abstrahuar tërësisht opozitën dhe bashkë me këtë edhe mediat, të cilat ishin në duart e saj nëpërmjet financimeve korruptive.

E theksuam më lartë se Gruevski erdhi në pushtet si reformator, por me kalimin e kohës profili i tij si lider u degjenerua në një profil makiavelist, në një profil që uzurpoi gjithë funksionimin normal të shtetit, duke instaluar politika kontraverse.

Pikërisht, këtë rrugëtim politik të qeverisë së Gruevskit, por edhe shumë fenomene tjera që i paraprinë dhe e mundësuan krizën e vitit 2015 e analizon publicisti, Xhelal Neziri, në librin e tij “Kohë eklipsesh”. Neziri e analizon ardhjen në pushtet të Gruevskit dhe në të njëjtën kohë jep vlerësime mbi zhvillimet e mëpastajme që mundësuan degjenerim të përgjithshëm politik dhe të sistemit institucional.

Në vitin 2006, shprehet Neziri, sërisht pas një krize institucionale dhe një çarje serioze të LSDM-ja, VMRO-DPMNE erdhi në pushtet me qëllimin që ta demokratizojë vendin dhe ta zhvillojë ekonomisht. Sipas tij, liderit i kësaj partie dhe kryeministri i deridjeshëm Nikolla Gruevski shihej si politikan reformator që përfundimisht do ta bëjë Maqedoninë një shtet demokratik e funksional, me ekonomi të zhvilluar dhe të integruar në NATO dhe BE.

“Në vitin 2011, kur humbi shumicën e votuesve, ai nuk ishte i gatshëm për një rotacion demokratik të pushtetit. Në ato zgjedhje të parakohshme që i kërkoi opozita u përdorën të gjitha mjetet jodemokratike për të mbetur në pushtet, që nga mbyllja e mediave, manipulimi i zgjedhjeve e deri te kërcënimi apo shantazhi i biznesmenëve e votuesve. Ishte kjo një shenjë se kjo garniturë politike nuk ka ndërmend të lëshojë pushtetin dhe të respektojë vullnetin e qytetarëve, por do të bëjë çmos që të ketë një përkrahje të madhe në opinion, qoftë ajo edhe e rrejshme”¹⁶⁵.

Sipas Nezirit, kapja e institucioneve, sektorit privat, mediave dhe partizimi i skajshëm i tyre solli në zbehjen e zërit opozitar dhe një bindje e nënshtrim të qytetarit ndaj këtij sistemi të stërkequr. “U arrit që të qytetari i Maqedonisë të instalohet një frikë-respekt ndaj pushtetit, i cili i bëri jo të rëndësishme debatet për parimet e demokracisë, qeverisjen e mire, korrupsionin dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Reagimi i qytetarit ndaj shpërdorimit të pushtetit ishte i vakët ndërkohë që korrupsioni u shndërrua në një mënyrë normale e ushtrimit të po atij pushteti”¹⁶⁶.

Neziri thekson se korrupsioni i pushtetit u degëzua horizontalisht dhe vertikalisht me atë që zgjedhjet u shëndërruan në një mundësi përfitimi jo vetëm për grupe të ndryshme të interesit, por edhe për votuesin e thjeshtë. Te votuesi u arrit të vritet ideali dhe të

¹⁶⁵ Neziri, Xh. *Kohët e eklipseve*, (Tetovë, 2017, f. 6).

¹⁶⁶ Ibid

instalohet interesi konkret, apo korrupsioni, si motiv i pjesëmarrjes në proceset demokratike, vë në dukje ai.

Në shumë analiza, studime dhe trajtesa tjera mbi krizën politike të vitit 2015 në Maqedoni, reflektimet shkojnë diku thellë deri te koha e pavarësimit të Maqedonisë nga ish shteti i Jugosllavisë. Që nga themelimi Maqedoninë si shtet e kanë përcjellë kriza të shumta politike, të cilat më pas kanë marrë edhe karakterin e krizës ndëretnike. Kriza e vitit 2015 determinohet pikërisht nga kjo mosqëndrueshmëri politike, sidomos nga përplasjet e mëdha mes dy partive më të mëdha maqedonase, LSDM që tash është në pushtet dhe VMRO-DPMNE-së, një parti që ruan një ideologji nacionaliste në matrocën e vetë.

Pavarësisht nga këto përplasje politike, përjashtoj kohën e konfliktit të vitit 2001, që si krizë kishte një karakter krejtësisht tjetër, deri më vitin 2015 Maqedonia nuk kishte përjetuar një krizë kaq të thellë sistemore dhe institucionale. Shumë analistë dhe publicistë rrënjët e kësaj krize i shohin të forcimi i pushtetit të ish kryeministrit Nikolla Gruevski, që vinte nga radhët e partisë VMRO-DPMNE. Vendosja e një pushteti absolut nga ana e tij dhe partisë së tij, kishte krijuar një atmosferë të kontrollit të gjithëmbarshtëm të institucioneve demokratike, por edhe të procesit zgjedhor që degjenerohej me forma të ndryshme të blerjes dhe kushtëzimit të votave.

Sipas autores, Hristina Veljanova, kriza politike, e cila e përfshiu Maqedoninë viteve të fundit, kulminoi në vitin 2015 me “aferën e përgjimeve”. Ajo vë në dukje se kjo ishte baza për një sërë ngjarjesh dhe protesta masive të cilat në mënyrë plotësuese kontribuan në drejtim të destabilizimit të gjendjes edhe ashtu sensitive politike. “Nënshkrimi i Marrëveshjes së Përzahinos më 2 qershor dhe të Protokollit më 15 korrik 2015 patën për qëllim zgjidhjen e krizës politike. Marrëveshja u nënshkrua nga katër partitë më të mëdha politike – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), ndërkaq me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të Komisionit Evropian, të Parlamentit Evropian dhe SHBA”¹⁶⁷.

¹⁶⁷ Veljanova, V. *Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016*. Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – (Shkup, 2016, f. 6).

Kjo autore thekson se njëra nga masat e parashikuara me Marrëveshjen ishte edhe mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, fillimisht të caktuara për 24 prill 2016. Si pjesë e Marrëveshjes, më 11 nëntor 2015 u formua Qeveria kalimtare, ndërsa më 15 janar të vitit 2016 Kryeministri i atëhershëm Nikolla Gruevski dha dorëheqje. Në pozitën e Kryeministrit u caktua Sekretari i Përgjithshëm i VMRO-DPMNE, Emill Dimitriev, i cili në njëqind ditët deri në zgjedhje duhej të ishte në krye të Qeverisë. Megjithatë, në janar të vitit 2016, LSDM paralajmëroi se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ndërsa si shkak u theksua mospërbushja e kushteve të Marrëveshjes së Përzhinos, veçanërisht mosazhurnimi i Listët së Zgjedhësve dhe pjesa e reformave në media.

“Konform Marrëveshjes së Përzhinos, BE dhe SHBA datën 20 shkurt e caktuan si afat brenda të cilës do të vlerësohet se sa janë përmbushur kushtet e mbajtjes së zgjedhjeve të besueshme më 24 prill 2016. Midis kushteve të parashikuara ishte pastrimi i Listës së Zgjedhësve, reformat në media, ndarja e shtetit nga aktivitetet partiake. Pas skadimit të këtij afati, ambasadorët e BE dhe SHBA në Maqedoni para publikut dolën me qëndrim se edhe përkrah asaj që është arritur një progres i caktuar, megjithatë, nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve kredibile. Rrethanat e këtilla rezultuan me shtyrjen e zgjedhjeve dhe me ndryshimin e vendimit sipas të cilit Kuvendi duhej të shpërndahej më 18 janar të vitit 2016”¹⁶⁸.

Më datë 23 shkurt, vë në dukje Veljanova, Kuvendi e miratoi kërkesën e BDI-së për shtyrjen e shpërndarjes së Kuvendit, me ç’rast kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanoski, më 15 prill edhe zyrtarisht i ricaktoi zgjedhjet për 5 qershor të vitit 2016. Së këtejmi, data e caktuar e re duhej të ofronte kohë plotësuese për tejkalimin e sfidave ekzistuese, por, ngjarjet të cilat pasuan në mënyrë plotësuese e vështirësuan atmosferën politike. Para ricaktimit zyrtar të zgjedhjeve, më 9 prill, LSDM dhe 17 parti më të vogla politike e nënshkruan platformën për Maqedoni Demokratike me të cilën përsëri u theksuan parakushtet e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta, të ndershme dhe demokratike, megjithatë u paralajmërua edhe bojkotimi i zgjedhjeve.

¹⁶⁸ Ibid

Disa ditë pas kësaj, Presidenti Gjorge Ivanov mori vendim t'u bëjë abolicion 56 personave prej të cilëve një pjesë politikanë të lartë nga pushteti dhe opozita të përfshirë në aferën e përgjimit. Vendimi shkaktoi një sërë protestash dhe kundër-protestash në periudhën në vijim.

Në këtë kronologji të ndodhive mbi krizën politike të vitit 2015 në Maqedoni, autorja Veljanova detajisht e përshkruan gjithë sfondin që solli deri te zgjedhjet e parakohshme. “Njëri grup i protestuesve të organizuar me iniciativën “Protestoj” kërkonin dorëheqje nga Presidenti dhe shtyrje të zgjedhjeve, ndërsa grupi tjetër, i bashkuar nga LQMM (Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë) e mbështesnin qëndrimin e Qeverisë dhe idenë për mbajtjen e zgjedhjeve më datë 5 qershor. Në periudhën që pasoi, dy partitë më të mëdha politike dhe nënshkruese të Marrëveshjes së Përzghinos edhe më tutje kishin divergjenca në qëndrimet e tyre lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të cilat u ricaktuan për 5 qershor të vitit 2016. VMRO-DPMNE e mbante qëndrim se zgjedhjet e parakohshme janë çelësi për dalje nga kriza e gjatë politike. LSDM konsideronte se është i nevojshëm zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Përzghinos, si garanci e vetme për mbajtjen e zgjedhjeve të ndershme dhe kredibile”¹⁶⁹.

Meqë kushtet e Marrëveshjes nuk u plotësuan, LSDM e mbajti qëndrimin e vet për t'i bojkotuar zgjedhjet, ndërsa BDI dhe PDSH dolën me qëndrim se janë të pranueshme vetëm zgjedhje inkluzive në të cilat do të merrnin pjesë të gjitha partitë politike. Pas përpjekjeve të pasuksesshme që partitë të arrijnë marrëveshje, thekson autorja, më 11 maj VMRO-DPMNE e vetmja nga katër partitë nënshkruese të Marrëveshjes së Përzghinos paraqiti lista të kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje. LSDM, BDI dhe PDSH u tërhoqën dhe nuk paraqitën lista të tyre.

Mundësia për mbajtjen e zgjedhjeve vetëm me një parti është në kundërtënie me vet konceptin e pluralizmit politik dhe pas kësaj më 16 maj erdhi kritika e Komisionit Evropian për mosekzistimin e kushteve minimale për mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme dhe demokratike më 5 qershor.

¹⁶⁹ Hristina Veljanova, *Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016*. Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – (Shkup, 2016, fq. 10).

Ngjarjet e këtilla kulminuan me nismën e BDI-së të paraqitur më 15 maj, e cila kishte për qëllim të rishikohet aspekti kushtetues i vendimit për shpërndarjen e Kuvendit, me ç'rast më 18 maj, Gjykata Kushtetuese miratoi masë të përkohshme për ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve zgjedhore deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Po atë ditë, kryetari i Kuvendit Veljanoski caktoi seancë, e thirrur për të bërë paraprake dhe pas kësaj pasoi ndryshimi i Kodit Zgjedhor, me të cilin 5 qershori u fshi si datë e zgjedhjeve. Një datë e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme nuk u caktua. Menjëherë pas kësaj, më 25 maj, Gjykata Kushtetuese e miratoi vendimin përfundimtar në lidhje me nismën e BDI-së, me të cilën shpërndarja e Kuvendit u shpall si jokushtetuese. Në Kuvend u kthye Qeveria në përbërjen si para Marrëveshjes së Përzghinos, me ç'rast kjo nënkuptonte kthim në pozitë fillestare dhe një valë të re të negociatave dhe përplasjeve ndërpartiake. "Pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016, muajt e ardhshëm kaluan në shenjën e negociatave të mëtutjeshme midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Republikën e Maqedonisë, me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të BE dhe SHBA në Maqedoni, me qëllim të daljes nga kriza politike dhe gjetjes së zgjidhjes për çështjet kontestuese. Në agjendë edhe më tutje ishin çështjet për pastrimin e Listës së Zgjedhësve, Qeverinë kalimtare dhe për reformimin e mediave, si kushte kryesore për zgjedhje të ndershme dhe demokratike"¹⁷⁰.

Sipas kësaj kronologjie të dhënë nga Veljanova, më datë 20 korrik, këto përpjekje rezultuan me sukses dhe me arritje të Marrëveshjes, të ashtuquajtur Përzghino 2 me të cilën, mes tjerash, ranë dakord të zgjidhet çështja me votuesit kontestues të Listës së Zgjedhësve, kthimin e ministrave dhe zëvendësministrave shtesë nga opozita në "Qeverinë kalimtare", formimin e autoritetit ad-hok i cili do të bëjë monitorim mbi mediat dhe raportimin në periudhën parazgjedhore, si dhe për çështjen e kompetencave të ministrit të Punëve të Brendshme. Pas votimit në Kuvend të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve, të cilët rezultuan nga Aneks Marrëveshja e fundit e Përzghinos (Përzghino 2), më 31 gusht u mbajt edhe një takim i liderëve në të cilin u konstatua se është plotësuar ajo për të cilën paraprakisht kanë rënë dakord dhe u caktua data për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor.

¹⁷⁰ Ibid

Kjo kronologji politike e përshkruar nga autorja Veljanova na jep për më tepër kalendarin e përpjekjeve për t'i dhënë fund krizës, e cila tashmë e kishte implikuar edhe faktorin ndërkombëtar. Por, interpretimet socio-politike të kësaj krize kanë qenë objekt vlerësimesh nga shumë autorë dhe aktorë tjerë të jetës publike.

Një ndër autorët që gjerësisht e ka pasqyruar, e ka trajtuar dhe analizuar gjithë kontekstin e krizës politike të vitit 2015 është edhe publicisti Xhelal Neziri. Tentimi për të rivendosur rendin demokratik në Maqedoni, vë në dukje ai, duket se po përballet me absurde politike të paregjistruara deri më tani.

“Operacioni i filluar në fillim të vitit 2015 nga lideri i LSDM-së opozitare maqedonase Zoran Zaev, me publikimin e materialeve komprometuese për qeverinë, pritej që të shkaktojë një tërmet të fuqishëm politik. Kjo nënkuptonte dorëheqjen e kryeministrit, qeveri kalimtare dhe organizim të zgjedhjeve kredibile dhe demokratike. Përmbajtja e materialeve që buruan nga një përgjim i paligjshëm, me indicie të qarta për korrupsion masiv, paralajmëronin një gjë të tillë”¹⁷¹.

Sipas këtij autori, nisur nga shembulli i Kroacisë dhe ai i Bullgarisë, Maqedonia dukej se ishte një rast ku ndryshimi dhe tranzicioni do të shkonte më kollaj.

Neziri vë në dukje se “kryeministri i atëhershëm kroat Ivo Sanader u detyrua të dorëhiqet pasi në maj të vitit 2009 në zyrën e tij papritmas u fut Jadranka Kosor, zëvendësja e tij në qeveri. Ajo mbante në dorë dosjen që argumentonte lidhjet e Sanaderit me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sanader ishte i bindur se publikimi i mundshëm i tyre do të shkaktoonte një llavë pakënaqësie që do ta shkrumbonte atë dhe partinë e tij. Nuk kishte rrugë tjetër përveç dorëheqjes dhe ballafaqimit me drejtësinë”.

Duke ia nënshtruar analizës së tij metodën e krahasimit, Neziri thekson se “Edhe Borisov u detyrua të dorëhiqet në shkurt të vitit 2013, pas erupsionit të protestave kundër çmimeve të larta të energjisë elektrike. Një qeveri teknike e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme, ndërsa partia e Borisovit doli fituese. Ai u rikthye në zyrën e kryeministrit por tani me një qasje miqësore ndaj Brukselit. Ai dha shenja se kishte kuptuar leksionin dhe nuk do të përsëriste gabimin që prodhoi protestat masive”.

¹⁷¹Neziri, Xh. *Kohë e eklipseve*, (Tetovë, 2017, f.19).

Ai pohon se vlerësimet për Maqedoninë dolën të gabuara. “Pritjet se dorëheqja e Gruevskit do të rezultojë menjëherë pas takimit të parë me Zaevin në kabinetin qeveritar, i mbajtur kah fundi i vitit 2014, dolën të pabazuara. Gruevski vazhdoi të ngelet kryeministër dhe pranoi sfidën e vështirë për ballafaqim publik me sekretet e pista të tij dhe bashkëpunëtorëve partiak apo në koalicionin qeverisës. Për dallim nga ish-kolegët e tij në Kroaci apo Bullgari, në 10-vitet qeverisje Gruevski kishte arritur të futë nën kontroll sistemin gjyqësor, prokurorinë, institucionet e sigurisë, trupat e pavarur, parlamentin, komunat dhe sferën mediale. Kjo i jepte një garanci se do të mund të neutralizojë goditjet nga aferat e mëdha korruptive që pritej të shpaloseshin nga opozita dhe të fitojë një kohë të mjaftueshme për t’u rikuperuar politikisht”¹⁷².

Neziri e analizon edhe momentin kur tashmë ish kryeministri Gruevski kishte filluar ta humb aurorën mbrojtëse të një politikani të ndershëm në kohën kur materialet e përgjuara po nxirrnin në pah anën e tij të vërtetë të kapjes së pushtetit. “Në fillim të vitit 2015, Zaev filloi të shpalosë anën e errët të politikanit, i cili kishte krijuar imazhin e një patrioti dhe politikani të sinqertë e punëtor, i nevojshëm për Maqedoninë. Bombat filluan ta zhveshin Gruevskin dhe partinë e tij nga petku i nacionalistit dhe të shpërfaqin një lukuni të uritur që prioritet kanë gjahun. Megjithatë, reagimet ishin të vakëta. Konferencat e shtypit që organizonte Zaevi, ku lëshoheshin audio-incizimet e përgjuara të qeveritarëve teksa përdhunojnë ligjet e vendit, filluan të krahasohen me telenovelat që ndiqeshin nga shumica e qytetarëve”¹⁷³. Sipas Nezirit, Gruevski vazhdonte të ngelet i parrezikuar, duke pësuar vetëm një rënie jo të konsiderueshme të rejtingut. “Prokuroria Publike planifikonte t’i vë në dry këto raste dhe të procesuojë vetëm ato kundër opozitës, policia të neutralizojë protestat, gjykatat të shqiptojnë dënime të gatuara në zyrat partiake kurse mediat proqeveritare të krijojnë një opinion iluzor mbi faktet e gjalla për korrupsionin masiv. Të gjitha motorët e mekanizmit të pushtetit autoritar u ndezën për të mbrojtur qeveritarët nga e vërteta e shpalosur nga ana e opozitës”¹⁷⁴.

Ajo që mbase nuk ishte vlerësuar mirë, vlerëson Neziri, është pranimi i korrupsionit në opinionin publik si një aktivitet normal i pushtetit, me ç’rast lufta bëhej jo për ta

¹⁷² Ibid

¹⁷³ Ibid

¹⁷⁴ Ibid, fq.20

çrrënjosur këtë dukuri por për të marrë pjesën më të madhe të plaçkës. Sipas tij, partnerët e koalicionit ndanin paratë dhe pronën publike, sekserët përqindjet, mediat reklamat, biznesmenët privilegjet joligjore kurse votuesit kalkulonin përfitimin konkret nga vota.

“Protesta e organizuar më 17 maj 2015 pritej të ishte fillimi i fundit të Gruevskit, ndërsa mendohej që grushti vendimtar do t’i jepej nga qytetarë të bashkësive të ndryshme etnike dhe religjioze. Do të ishte ky një revolucion atipik për Maqedoninë, e cila është e ndarë në realitetin etnik maqedonas dhe shqiptar, apo atë religjioz ortodoks e mysliman. Ngjarjet e Kumanovës vetëm një javë para protestës, kur një grup i armatosur zhvilloi një luftë dyditore në brendi të qytetit që solli 18 të vrarë, duket se e minuan këtë tentim. Protesta kaloi në hije të luftimeve që rikthyen luftën e vitit 2001, kur u zhvilluan përplasje etnike të armatosura midis maqedonasve dhe shqiptarëve”¹⁷⁵.

Neziri në trajtimin e tij mbi këtë krizë do të vendosë edhe paralele teorike, të cilat i gjen te autorë eminent botërore. Ai sjellë mendimin e ish-zyrtarit amerikan dhe shkrimtari Samuel Huntington, i cili në librin e tij “Vala e tretë”, thotë se një regjim autoritar mund të rrëzohet vetëm nëse i shkaktohet një padëgjueshmëri të forcave të sigurisë dhe institucioneve tjera të rëndësishme për ushtrimin e pushtetit. Në të kundërtën, vë në dukje Neziri, për të bindur të tërhiqet dhe të mundësojë tranzicionin në sistemin demokratik, bartësit të regjimit duhet garantuar të drejtën e garimit politik apo falje për veprat e bëra. Në Maqedoni, konstaton Neziri, opozita nuk arriti të bindë Gruevskin të dorëhiqet para publikimit të aferave (njëjtë si Sanaderi), e as të organizojë protesta masive që do të detyronte Gruevskin të largohet (njëjtë si Borisovi), por kjo erdhi pasi ai u ulë në tavolinën e bisedimeve me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian (BE) dhe SHBA-ve.

Marrëveshja që u nënshkrua në Shkup mbeti e pa implementuar në tërësi, për shkak të obstrukcioneve që bëheshin nga institucionet e kontrolluara nga tashmë ish-kryeministri Nikolla Gruevski. “Reforma e sferës mediale dhe pastrimi i listës zgjedhore ishin dy parakushtet e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, të cilat i kërkoi opozita e udhëhequr nga LSDM. Shkaku i vonësive të implementimit të marrëveshjes, zgjedhjet u prolonguan disa herë. VMRO-DPMNE dhe partitë e shqiptarëve etnik, BDI dhe PDSH këmbëngulnin që

¹⁷⁵ Ibid

data të mos ndryshojë edhe përsëri mospërbushjes së kushteve të kontraktuara paraprakisht.

Prokuroria Speciale, e formuar në bazë të Marrëveshjes së Përzahinës të hetojë aferat korruptive të publikuara nga opozita, në vitin e parë të funksionimit nuk mundi të bindë gjykatat e varura e të politizuara që të gjykojnë në bazë të dëshmive të grumbulluara¹⁷⁶. Publikimi i materialeve të përgjuara që ishte edhe kulminacioni i krizës politike të vitit 2015, do të trajtohet nga shumë publicistë, duke e analizuar këtë moment secili nga optika e veta. Këto vështrime tashmë janë edhe pjesë të librave të botuar, në të cilat gjerësisht analizohet kjo periudhë krize. Një punë të sistemuar mbi rrënjët e kësaj krize dhe mbi gjithë reflektimet e mëhershme politike dhe të mëpastajme ka bërë edhe organizata joqeveritare “Civil”.

Pikërisht në këtë temë shkruan edhe publicisti Sasho Ordanovski, enkas për një publikim të kësaj organizate. Sipas tij, gjithë kontraversat e mega skandalit me përgjimet e bisedave telefonike dhe ndjekjes së komunikimeve tjera të qytetarëve në politikën e Maqedonisë mund të lë shumë pyetje pa përgjigje në raport me rrethanat e komplikuar politike, të drejtësisë dhe institucionale të kësaj afere të turpshme. “Sidoqoftë, ky rikonstruim i detajuar i punës së paligjshme të “telekomunikimeve” të shërbimit sekret të policisë së Maqedonisë paraqet një rast të mirë për një shqyrtim të thellë në atë se si ndodhi demokracia në Maqedoni të kidnapohet dhe të zhvatet nga ana e një grupi relativisht të vogël në eshëlonin më të lartë të fuqisë shtetërore. Me mbi 400 biseda të publikuara, ku dominojnë funksionarë të lartë të qeverisë së liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, duke përfshirë edhe atë, opinionit në Maqedoni iu ofrua një rast i mirë ta mbikëqyr nëpërmjet “zërave origjinal” të aktorëve kryesor korupsioni i turpshëm, keqpërdorimi i funksionit, si dhe shmangia e përgjegjësisë publike nga ana e atyre funksionarëve, të cilëve iu ishte besuar mirëqenia e vendit në një kohë më të gjatë të dekadës që lëmë pas”¹⁷⁷. Ordanovski ndalet pikërisht te gjithë ai degjenerim i sistemit paraprak, që në një farë mënyre solli deri te kriza politike si një formë tashmë e dukshme e kalbjes dhe e kapjes së sistemit dhe pushtetit.

¹⁷⁶ Ibid

¹⁷⁷ СЛОБОДНИ ИЗБОРИ: УСЛОВ ЗА КОЈ НЕ СЕ ПРЕГОВАРА, ЦИВИЛ - Центар за слобода, (Скопје, 2016, fq. 55).

4.1 Kriza ekonomike

Kriza e stërgjatur politike, gjegjësisht ciklet e krizave politike të cilat kulminuan me krizën politike të vitit 2015, kanë ndikuar në masë të madhe edhe në sektorin e ekonomisë, në veçanti në sektorin e turizmit. Ky ndikim është pasqyruar në mediat me relevancë nga aktorët e jetës ekonomike të cilët kanë bërë thirrje që sa më shpejtë të gjendet zgjidhje për këtë situatë,

Në një analizë të Deutsche Welle në gjuhën shqipe, kjo krizë trajtohet gjerësisht, sidomos influcimi i krizës politike në zbehjen e investimeve të huaja, por edhe në paralizimin e ekonomisë së vendit si pasojë e pasigurisë dhe turbulencave tjera politike. Menderes Kuçi, kryetar i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore OEMVP, duke analizuar ndikimin e krizës politike në ekonominë e Maqedonisë vë në dukje se "gjendja e rëndë politike në vend, ka ndikim negativ. Rrezikohet dhe kthimi i mërgimtarëve tanë në periudhën e verës, e që janë stimul i veçantë për rritjen e konsumit të përgjithshëm në Maqedoni, si dhe në mënyrë shtesë dhe rreziku nga zvogëlimi i depozitave të tyre, që në masë të madhe kontribuojnë për stabilitetin makroekonomik të vendit dhe sigurojnë stabilitet të një pjesë të rezervave devizore"¹⁷⁸.

Sipas Kuçit, vazhdimi i krizës politike do të ketë ndikim negativ në ekonominë e vendit, e sidomos në investimet e huaja. "Pasojat e gjithë kësaj do t'i bartin kompanitë dhe qytetarët, ndërsa qeveria këtë do ta ndjejë pasi arka shtetërore do të jetë e zbrazur, indikacione të cilat tashmë dhe kanë filluar të ndjehen. Vazhdimi i krizës politiko-ekonomike do t'i zbeh mundësitë për ta mbrojtur Maqedoninë nga falimentimi"¹⁷⁹.

Përfaqësuesit e odave ekonomike që përfaqësonin interesin e komunitetit të biznesit, kishin paralajmëruar iniciativa të përbashkëta, të cilat do t'i dorëzoheshin qeverisë në drejtim të stabilizimit dhe normalizimit të krizës politike dhe ekonomike në vend. Vlerësimet e tyre ishin se kriza politike po reflektohet negativisht në sferën e ekonomisë, ndërsa pasojat më së shumti po i ndjejnë kompanitë e mëdha, por pa anashkaluar edhe konsumatorët e thjeshtë.

¹⁷⁸ Kriza politike paralizon ekonominë. Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/kriza-politike-paralizon-ekonomin%C3%AB-e-maqedonis%C3%AB/a-18465882>

¹⁷⁹ Ibid

Edhe ministri i financave, Zoran Stavreski, kishte pranuar se biznesmenëve u nevojitet stabilitet i qëndrueshëm që të mund të realizojnë projektet e planifikuara. Sipas tij, një zgjidhje e krizës politike do të ishte e mirëseardhur për bizneset vendase, por edhe për kompanitë e tjera që hezitojnë për të investuar në Maqedoni.

“Pres që rezultatet në ekonomi tani për tani nuk do të përkeqësohen, por gjithçka varet nga ajo se sa shpejtë do të tejkalohet kriza politike. Vlerësoj se është mirë që të dilet nga kjo situatë dhe bizneset të fillojnë me realizimin e parashikimeve të tyre në ekonomi”¹⁸⁰

Po në këtë analize të DW-es, profesori i ekonomisë në Universitetin e Shkupit, Zoran Ivanovski, kishte vlerësuar se për shkak të uljes së aktiviteteve ekonomike si pasojë e krizës politike, është reale që të pritët rritja e deficitit buxhetor, apo të mos realizohet mbushja e buxhetit sipas parashikimeve të qeverisë. “Vlerësoj se nuk do të ketë ndryshime të theksuara sa i përket politikës ekonomike në krahasim me periudhën e deritanishme. Konsideroj se është reale që të presim rritje të deficitit buxhetor”¹⁸¹.

Tashmë dukej qartë se kriza politike po e fuste Maqedoninë në një krizë të padiskutueshme ekonomike e cila po analizohej nga përfaqësuesit e institucioneve, por edhe nga ekspertët e kësaj fushe të cilët paralajmëronin për një zgjidhje të shpejtë, sepse në të kundërtën kriza politike do ta paralizonte edhe ekonominë e vendit. Sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë në muajin shkurt të vitit 2015 ishin regjistruar vetëm 12.6 milionë euro investime të huaja, investimet e huaja mesatarisht kanë qenë mbi 30 milion euro në vitet paraprake.

Një pasqyrë shumë më të detajuar dhe gjithëpërfshirëse mbi ndikimin e krizës politike në ekonomi kemi mundur ta gjejmë në analizën e Bankës Popullore të Maqedonisë të titulluar “Efektet e krizës politike në vitin 2016 mbi ekonominë e vendit”. Në këtë analizë në mënyrë të detajuar analizohen të gjitha pasojat e krizës politike mbi të gjitha sektorët e ekonomisë. “Në dy vitet e fundit ekonomia në Maqedoni karakterizohej me vazhdimin e tensioneve politike, të cilat paraqesin faktorët kyç të rrezikut në bilancin e ekonomisë. Këto rreziqe kanë qenë gjatë tërë kohës të pranishme dhe kanë pasur efekte të caktuara

¹⁸⁰ Kriza politike paralizon ekonominë. Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/kriza-politike-paralizon-ekonomin%C3%AB-e-maqedonis%C3%AB/a-18465882>

¹⁸¹ Ibid

ekonomike, sidomos kanë qenë të dukshme në kursimet e qytetarëve, ndërsa në periudha të caktuara edhe në ofertën për deviza”¹⁸².

Sipas kësaj analize, më tepër presione në këto segmente janë ndjerë në maj të vitit 2015, ndërsa me rreziqet e krizës së borxheve në Greqi në fund të qershorit janë shfaqur presione plotësuese mbi depozitet në banka. Megjithatë, shikuar përmes parametrave ekonomik, deri në prill të vitit 2016 pasojat ishin të ekuilibruara. Kah mesi i prillit erdhi deri të përkeqësimi i gjendjes politike në vend dhe bashkë me këtë erdhi edhe deri te shfaqja e spekulimeve për stabilitetin e denarit dhe të sistemit bankar të vendit që nxiti thirrje publike për tërheqjen e depozitave. “Në rrethana të këtilla, në sistemin bankar erdhi deri te tërheqja e jashtëzakonshme e depozitave nga qytetarët. Njëkohësisht, duke marrë parasysh prirjen e subjekteve ekonomike për të poseduar deviza, personat fizik i konvertuan këto mjete në deviza të gatshme. Kjo krijoi presion të madh në pazarin e këmbimeve si dhe në pazarin devisor të bankave në transaksionet me personat fizik. Si pasojë e këtyre ndodhive Banka Popullore intervenoi me shitjen e shumave të caktuara të devizave nga rezervat devizore si dhe me ndryshimin e instrumenteve monetare”¹⁸³.

Sipas kësaj analize segmenti i parë ku u manifestuan efekte të fuqishme të krizës ishte kursimi i popullatës në kuadër të sistemit bankar. Edhe pse të dhënat që nga viti 2015 tregoni se ambienti politik i tensionuar vepron mbi kursimet, megjithatë efektet me tërë fuqinë u manifestuan në prill-maj të vitit 2016. Tërheqja e devizave filloi në pjesën e dytë të prillit, pas thirrjeve publike për t’i tërhequr. Në kohën e këtij shoku, zvogëlimi i përgjithshëm i depozitave të popullatës ishte i theksuar dhe kapte shumën prej 8 miliard denarësh, ose 3.7% nga gjendja në fund të 2016.

Përgjithësisht, siç kishin vënë në dukje ekspertët e ekonomisë, por edhe nga kjo analizë e Bankës Popullore të Maqedonisë mund të vërehet se kriza politike kishte ndikuar ndjeshëm edhe në ekonominë e vendit, ndërsa pasojat e saj mund të vëreheshin në mosbesimin e popullatës në valutën e vendit, tërheqjen e kursimeve nga bankat dhe konvertimet valutore.

¹⁸² Ана Митреска, Султанија Бојчева-Терзијан & Тања Јакимова *Ефектите од политичката криза во 2016 година врз домашната економија*. НБРМ, Gusht, 2017

¹⁸³ Ibid

Një dimension tjetër i pasojave vihej në dukje nga subjektet ekonomike, të cilat theksonin reflektimin e krizës politike në dinamikat ekonomike dhe në punën e kompanive të cilat tashmë po shënonin rënie në punën e tyre.

Një pasqyrë më të saktë mbi ndikimin e krizës politike në ekonomi dhe mbi projeksionet ekonomike për vitet e ardhshme e jep edhe raporti tre mujor Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në të cilin analizohen të gjitha implikimet e krizës politike, por edhe parametrat që mund ta stabilizojnë gjendjen e përkeqësuar ekonomike.

“Sipas kësaj dinamike të aktiviteteve ekonomike, në vitin 2016 hendeku i prodhimit do të ngelte në zonën negative dhe do të shkaktohte trysni ndaj çmimeve në teposhtë kundrejt një pritshmërie të rritjes së moderuar të inflacionit në skenarin bazik. Në aspekt të komponentëve të veçanta të kërkesës, besimi i reduktuar i popullatës do të ris nivelin e përmbajtjes ndaj konsumit të madh. Kundrejt përmbajtjes së përgjithshme nga aspektet psikologjike, ndaj konsumit privat do të ndikonin edhe rritja e ngadalësuar e të ardhurave të disponueshme, ndërsa në një skenar të këtillë supozohen zhvillime të pakta të volitshme të tregut të punës dhe efekte përkatës ndaj të ardhurave të disponueshme. Me atë konsumi privat do të kishte efekt neutral ndaj rritjes, ndërsa në skenarin bazik kjo komponentë është një nga burimet e rritjes së PBB. Rritja e mosbesimit pritet edhe te investitorët, si pasojë e së cilës do të mund të vije gjer në përmbajtje të investimeve të reja. Që do të thotë se ekziston mundësia që investitorët e huaj dhe ato vendor ti shtyjnë vendimet investuese në vend”¹⁸⁴.

Nga ana tjetër, thuhet në këtë raport, edhe pse në këtë skenar sigurisht është e përcaktuar ngadalësimi i projekteve infrastrukturore të shtetit, megjithatë një pjesë e këtyre projekteve për të cilët janë siguruar burime të financimit do të realizoheshin edhe më tej, veçanërisht projektet në infrastrukturën rrugore. “Prej këtui, në skenarin alternativ edhe më tej pritët rritje të investimeve, por në nivel të theksuar më të ulët në raport me skenarin bazik. Skenari alternativ nuk parashikon efekte më të mëdha ndaj gjithsej aktiviteteve eksportuese, e cila në masë më të madhe rrjedh nga kapacitetet e rreja të orientuar kah eksporti, planet afariste e së cilit do të realizoheshin në pajtueshmëri me dinamikën e supozuar në skenarin bazik.

¹⁸⁴ Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Raporti tre mujor, Maj, 2016.

Nga ana tjetër, dinamika më e zbehtë e kërkesës vendore do i zvogëlonte presionet importuese, me çka rritja e importit do ishte më e ngadalësuar në krahasim me skenarin bazik”¹⁸⁵.

Në këtë raport jepet një pasqyrë shumë më e gjerë e implikimeve ekonomike globale, sidomos në nivel europian, pa e anashkuar edhe krizën politike, e cila tashmë drejtpërdrejtë po ndikonte në ekonomi duke sjellë pasoja jo vetëm në reagimin e popullatës dhe subjekteve të ndryshme financiare, por edhe në projeksionet ekonomike, të cilat mbeteshin me shumë të panjohura.

Në këtë drejtim në këtë raport vihet në dukje se ”jo siguria nga intensiteti i rikuperimit të ekonomisë globale, a në veçanti të ekonomisë evropiane edhe më tej ekziston dhe mund të ndikoj në trajektoren e projektuar të treguesve të ekonomisë vendore”. Sipas këtij raporti, rreziqet për shkaqe të faktorëve vendor, të lidhur me krizën politike vendore edhe më tej janë të pranishëm, e kanë të bëjnë me jetëgjatësinë e krizës e cila në masë të madhe e kushtëzon realizimin e të dy skenarëve.

¹⁸⁵ Ibid

4.2 Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në prag të zgjedhjeve

Në Maqedoni gati se të gjitha krizat paraprake politike janë përcjellë edhe me destabilizime në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale. Kriza e vitit 2015 që kulmoi në vitin 2016, nuk është një përjashtim, përkundrazi tregon se në situatë të tensionit politik marrëdhëniet ndëretnike lëkunden. Por, për dallim nga krizat e më hershme politike, gjatë kësaj krize, në prag të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare ishte krijuar një bazament pak më i fort rezistence qytetare që pamundësonte që kjo krizë të kalojë në ndëretnike edhe pse rreziqet gjithmonë ishin aty. Në një analizë të tyre të përbashkët reale dhe objektive, autorët Lura Pollozhani dhe Dane Taleski kishin analizuar kronologjikisht përsëritjet e krizave politike, në të cilat ishin manifestuar edhe tendenca të skajshme përkeqësimi të marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale.

Këta dy autorë theksonin se “politika etnike” është qendrore në Maqedoni. Shembuj nga qeveria e parë multi-etnike në 1992, protestat ndëretnike në 1997/8, konflikti që gati eskaloj në luftë civile në 2001, shpërthime të ndryshme të konflikteve më pak ose më shumë të dhunshme mes 2004 dhe 2016, duke përfshirë luftën e fundjavës në Kumanovë në 2015, tregojnë rëndësinë e marrëdhënieve të mira ndëretnike për stabilitet dhe për zhvillimin e demokracisë. Nëse kriza politike vazhdon, atëherë demokracia në Maqedoni do të vazhdojë të gërryhet dhe do të pengojë marrëdhëniet ndëretnike. Humbja e vlerave demokratike përkeqëson marrëdhëniet ndëretnike dhe hap mundësitë për instrumentalizimin e identiteteve etnike. Do të nevojitet shumë punë për të rindërtuar demokracinë në vend, dhe një strategji e qartë për të integruar grupet e ndryshme etnike dhe për të thyer ndarjen e fushave të pushtetit në vija etnike, do të jetë e nevojshme”¹⁸⁶. Në këtë analizë shtrohet dilema nëse kriza politike do t’i përkeqësojë marrëdhëniet ndëretnike, apo do të shërbej si një moment shndërrimi për të krijuar një hapësirë tjetër mirëkuptimi etnik.

¹⁸⁶ A mundet kriza politike të jetë një mundsi për tejkalimin e ndarjeve etnike në Maqedoni. Marrë nga: <https://portalb.mk/269344-a-mundet-kriza-politike-te-jete-nje-mundes-per-tejkalimin-e-ndarjeve-etnike-ne-maqedoni/>

“Në 2016, derisa shteti po përjeton pranverën e dytë, shpresat për ndryshim të sistemit janë në rritje. Kriza politike ofron një mundësi për të tejkaluar ndarjet etnike në Maqedoni dhe për të ndërtuar një shoqëri më të integruar. Deri më tani, shumica e partive politike kanë përdorur mobilizim etno-nacionalist dhe kanë stimuluar emocione për të fituar vota, ndërkohë duke anashkaluar çështje si papunësia dhe tharja e trurit (brain drain) që rezultojnë nga kjo, korrupsioni, dhe rënien e vazhdueshme të demokracisë. Pyetja është nëse partitë etnike maqedonase dhe partitë etnike shqiptare janë gati për t’u ofruar alternativa qytetarëve të tyre, apo nëse individë, me veprat e tyre, mund të stimulojnë reformulimin e marrëdhënieve ndëretnike”¹⁸⁷.

Por, pavarësisht nga një ambient jo shumë acarues ndëretnikë, në sferën publike ruheshin diskursi etnik. Në brendi të krizës politike vërehej diskursi etnik që vinte nga partitë politike të dy blloqeve politike atij shqiptar dhe atij maqedonas. Kjo analizë vë në dukje pikërisht këto tendenca politike që krijojnë një momentum politik para zgjedhjeve, por që në esencë luante me marrëdhëniet ndëretnike, të cilat shfaqeshin të lëndueshme dhe me potencialitet për t’u përkeqësuar.

“Konkurrenca mes partive politike ka mbetur kryesisht brenda bllokut etnik shqiptar dhe etnik maqedonas, dhe jo mes tyre. Ekziston një zonë gri në mes ku ka përprjekje për të mbyllur ndarjen etnike. Edhe pse ka parti të reja etnike shqiptare të cilat janë ndarë nga dy partitë më të mëdha, si Uniteti (parti e ndarë nga BDI) dhe Lëvizja për Reforma në PDSH (parti e ndarë nga PDSH), ato po ashtu kanë mbajtur kritikën e tyre brenda bllokut etnik shqiptar dhe ndonjëherë kundër Kryeministrit të vendit. Për më tepër, ka një ndarje të fortë në diskursin politik mbi interesat etnike shqiptare dhe ato etnike maqedonase, e cila i përforcon ndarjet etnike. Ky dallim mes interesave etnike bëhet i qartë nëse shqyrtojmë krizën politike”¹⁸⁸.

Realisht, marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale gjatë periudhës para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 shfaqen të brishta dhe me mundësi të vazhdueshme për t’iu nënshtruar agjendave politike, të cilat nëpërmjet përkeqësimit të tyre kërkonin mbijetesën politike, ose fuqizimin politik. Dhe, në këtë drejtim kjo analizë saktësisht po e

¹⁸⁷ Ibid

¹⁸⁸ A mundet kriza politike të jetë një mundsi për tejkalimin e ndarjeve etnike në Maqedoni. Marrë nga: <https://portalb.mk/269344-a-mundet-kriza-politike-te-jete-nje-mundes-per-tejkalimin-e-ndarjeve-etnike-ne-maqedoni/>

detektonte dilemën se nga cila rrugë do të lëvizet e që në fakt do ta përcaktonte më pastaj fatin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale.

“E ardhmja e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni nuk duket e qartë. Ka dy drejtime dhe dy aktorë të rëndësishëm. Drejtimet janë ruajtja e ndarjeve etnike dhe tejkalimi i të njëjtave. Aktorët janë qytetarët dhe partitë politike. Në këtë moment, duket se janë qytetarët ata që kanë fuqinë të krijojnë marrëdhënie të reja ndëretnike dhe të ridefinojnë hapësirën dhe retorikën publike. Mënyra për të arrirë këtë rezultat është duke marrë pjesë në protesta dhe duke krijuar një të tashme -nëse jo një të ardhme- ku të gjithë qytetarët e Maqedonisë ndajnë fatin e shtetit dhe punojnë së bashku në ndërtimin e të ardhmes demokratike të tij si qytetarë të barabartë”¹⁸⁹.

Nuk do të mungojnë tendencat gjatë kësaj periudhe që kriza politike të konvertohet në krizë ndëretnike. Por, implikimi i madh i bashkësisë ndërkombëtare, por edhe i protagonistëve të tjerë të jetës publike në vend do ta pamundësojnë një skenar të tillë, i cili ishte promovuar me “Rastin e Kumanovës”. Pavarësisht nga këto tendenca dhe tensionimi që kishte për bazë ruajtjen e pushtetit nga “regjimi i Gruevskit” siç e quante opozita, marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale nuk do të pësojnë tronditje të madhe, sepse kriza politike tashmë iu adresohet vetëm partive politike dhe ishte bërë dallimi në perceptim.

Në fakt kjo krizë më tepër ishte atak ndaj vlerave dhe institucioneve demokratike dhe rrugës së promovuar me kohë për anëtarësim në BE. Pikërisht, në këtë drejtim, do ta shoh kulmimin e krizës, por edhe gjithë backgroundin politik një debat i realizuar nga European Policy Institute-Shkup.

“Veç kësaj, standardet demokratike të vendit, të cilat përbëjnë bazën e anëtarësisë në BE, janë përkeqësuar. Shumë faktorë relevantë, si dhe raportet e KE-së për përparimin e vendit drejt BE-së, treguan tendenca jo liberale dhe ekzistencën e një “shteti të pushtuar” në Maqedoni. Interesat private, kryesisht partiake ndikuan ndjeshëm, pra privatizuan punën e institucioneve shtetërore si qeveria, administrata publike, autoritetet gjyqësore, agjencitë rregullatore dhe mediat. Si rezultat i kësaj, u shtua polarizimi politik në vend. Në disa vite të fundit, trazirat civile dhe protestat e vazhdueshme kanë mbushur hendekun

¹⁸⁹ Ibid

demokratik. Marrëdhëniet ndëretnike ishin gjithashtu të vëna në pyetje, ndërsa u rritën dhe përçarjet politike të thella brenda-etnike. Antagonizmi partiak arriti nivele të papara gjer më tani dhe paraqiste lajmërim për ngjarjet e 27 prillit 2017, kur një turmë e mllefosur sulmoi parlamentin, duke plagosur një numër të madh të deputetëve të opozitës”.¹⁹⁰

4.3 Thellimi i krizës së gjithëmbarshme dhe nevoja për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme

Kronologjia e krizës politike e vitit 2015 në Maqedoni nga shumë autorë është shikuar edhe në rrafshin diakronik, gjegjësisht në rrafshin e ndërvarësive politike dhe të një krize institucionale që po shfaqej si pasojë e dekodimit të funksionimit të ish pushtetit të udhëhequr nga kryeministri Nikolla Gruevski. Ky shikim diakronik i kësaj krize që kulminoi në vitin 2016 me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme na jep një tablo më të qartë të degjenerimit të pushtetit, gjegjësisht të një kontrolli partiak dhe familjar të institucioneve të pushtet.

Në aspektin kronologjik, kjo krizë filloi të manifestohet në formën e protestave qytetare. Nëpër një numër të madh qytetesh që nga fillimi i vitit 2015 filloi të zhvillohet një valë e pakënaqësisë qytetare, që përfshinte një pjesë domethënëse të shoqërisë civile, që kulminoi me protestën më të madhe që organizuar deri atëherë në Shkup, më 17 maj 2015. U tubuan dhjetëra organizata qytetare multi etnike, të prira nga LSDM-ja. Vetëm në atë ditë, më shumë se 60.000 njerëz kërkuan dorëheqje nga qeveria, zgjedhje të parakohshme dhe pasoja juridike për të gjithë që qenë të kyçur në skandalin e bisedave të përgjuara. Kriza tashmë nuk mundej të shpërfillej.

“Më tej, procesi i bisedimeve për tejkalim të krizës politike, që u mbajt në rezidencën e ambasadorit të BE-së në lagjen shkupjane Përzhinë rezultoi me marrëveshje politike, që u nënshkrua më 2 qershor dhe plotësuar më 15 korrik 2015, e menduar si platformë politike për zgjidhje të krizës. Të tri palët që qenë kyçur në procesin e bisedimeve – koalicioni maqedonaso-shqiptar në pushtet; LSDM-ja opozitare; dhe ndërmjetësit euro-amerikanë ndërkombëtarë, të udhëhequr nga komisar i Komisionit

¹⁹⁰ Marrë nga: http://epi.org.mk/docs/EPI_InfoMaterijali_Nov2017_ALB.pdf

Evropian – Johanes Han – në fakt, kanë agjenda të ndryshme dhe korniza të ndryshme kohore për zgjidhje të krizës”¹⁹¹.

Në analizën e tij për OJQ Civil, Sasho Ordanovski, vë në dukje se “në atë kohë, koalicioni në pushtet ishte i interesuar të bëhen sa më shpejt që është e mundur zgjedhjet, me ç’gjë do të përtërihej legjitimiteti i tyre politik, me minimalizim të çfarëdo reforme politike që eventualisht do të rezultonte në qeverisje më të madhe të së drejtës dhe në institucione kredibile në shtet, me ç’gjë do të vihej pushteti i tyre në pikëpyetje”. Në anën tjetër, thekson ai, opozita ishte e interesuar për reforma gjithëpërfshirëse politike, për ç’gjë duhej një tempo më e ngadaltë e ndodhive, me qëllim që të instalohet sundim i së drejtës i duhur për ta ndërprerë trendin e edhe një palë zgjedhjesh të falsifikuara.

Në këtë analizë gjithashtu theksohet se bashkësia ndërkombëtare donte reforma politike që do të shpijnë në zgjedhje për të formuar qeveri, që do të ishte sa më legjitime dhe e cila do të vazhdonte me reformat politike në vend në përputhje me sundimin e së drejtës, por pa kushtuar mjaftueshëm kohë dhe resurse të kërkuara nga opozita. “Me qasje të këtilla të pa sinkronizuara, filloi garë ndërmjet parimeve juridike dhe politike në zgjidhjen e krizës, kurse frustracionet nga ai proces rriteshin në të gjitha anët e kyçura. Duke shpejtuar, koalicioni qeverisës, që nuk donte ta rrezikojë përtëritjen e besueshme të listës zgjedhore, e as ta ngadalësojë kontrollin mbi mediumet dhe sërish të vërë pavarësi të institucioneve kyçe nga kontrolli i madh partiak, duhej dy herë ta shtyjë datën e zgjedhjeve, të cilat patën qenë njëanshmërisht të caktuara prej tyre më 24 prill dhe më 5 qershor 2016”¹⁹².

Qeveria u përball me bojkotimin e zgjedhjeve të caktuara ashtu nga të gjitha partitë opozitare në vend dhe me mospajtimin e fortë nga ana e shoqërisë civile, duke i përfshirë edhe kërkesat e shumta të CIVIL-it të bazuara në raportet nga terreni dhe analizat gjithëpërfshirëse për mosgatishmërinë e një procesi të drejtë zgjedhor. Ordanovski në këtë analizë gjithashtu thekson se “opozita vendosi të bëjë rezistencë të vazhdueshme, po të qetë ndaj qeverisë, duke u thirrur në përkrahjen e qindra qytetarëve maqedonas që panë mundësi për t’u marrë kontrolli nga duart e koalicionit qeverisës në të cilin ata tashmë nuk

¹⁹¹ ZGJEDHJE TË LIRA: KUSHT PËR TË CILIN NUK KA NEGOCIATA, Botues: CIVIL, Shkup, Korrik 2016, f. 55.

¹⁹² Ibid

kishin besim. Për atë duhej shumë kohë dhe nerva, ashtu si edhe resurse. Gjithashtu, e gjithë kjo shpiu edhe në shumë moskuptime me aktorët ndërkombëtarë, të cilët këmbëngulnin në atë se është më së miri institucionet zyrtare ta udhëheqin këtë proces – institucionet e njëjta që u zbuluan se janë tërësisht të korruptuara dhe joefikase. Gjithçka bëhej me tempon e valleve popullore maqedonase: tri hapa përpara, dy mbrapa... Disi, të gjitha ndodhitë po sillen rreth punës së zyrës së prokurorisë publike speciale, që u bë institucioni i vetëm në vend që, pas themelimit të saj në fund të vitit 2015, vazhdimisht ka rejting publik më të madh se cilado parti politike, politikan apo ndonjë organ tjetër shtetëror”.¹⁹³

Realisht kriza politike po komplikohet në raport me zhvillimin e ngjarjeve dhe në raport më taktizimet e bartëseve të funksioneve publike që vinin nga partia në pushtet VMRO-DPMNE. “Imazhi i kësaj zyre edhe më shumë u forcua me pamaturinë politike të presidentit maqedonas Gjorge Ivanov, i cili harxhoi dy muaj të shtrenjtë të kohës së duhur për zgjidhje të krizës, me faljen e 56 personave, pjesa më e madhe prej tyre ishin funksionarë qeveritarë (duke e përfshirë edhe vetë Nikolla Gruevskin) dhe ndihmësit e tyre joqeveritarë, për të cilët bëhej hetim apo për të cilët presidenti kishte supozuar se janë të dyshuar nga ana e prokurorisë publike speciale – që pastaj atë vendim të vetin presidenti do ta shfuqizojë gjithashtu befasisht, ashtu siç ishte marrë! Me këtë gjest të tij, u duk se presidenti tërësisht e humbi legjitimitetin e vet modest dhe përkrahjen për disa aspekte nga opinioni i gjerë maqedonas, me ç’gjë u bë pjesë e problemit politik, e jo pjesë e zgjidhjes”.¹⁹⁴ Përveç kësaj, këtë incident të ri politik e mbolli prokuroria publike speciale në zemrat dhe vetëdijet e qytetarëve, si institucion i vetëm që e teston fuqinë e formuar të pushtetit.

Kriza politike në Maqedoni, përveç që kishte një dimension të totalitarizmit ideologjik, që përpiquej sa më shumë ta vonon zgjidhjen, në sfond kishte edhe mobilizimin e shume shoqatave civile, të cilat tashmë i kishin adresuar problemet dhe e kishin bërë të pamundshme një zgjidhje gjysmake që do t’i shkonte për shtati pushtetit të atëhershëm, që me çdo mjet përpiquej ta vonojë procesin e zgjidhjes dhe të mbajë zgjedhje pa u përmbushur

¹⁹³ Ibid, faq.57

¹⁹⁴ Ibid

kriteret minimale të cilat ishin afishuar nga shoqëria civile dhe aktorë tjerë progresiv shoqëror.

Ordanovski në analizën e tij vë në dukje se “përgjatë vitit 2015 u shfaq mobilizim i fortë në kuadër të sektorit civil në Maqedoni. Plenumet studentore dhe të shkollave të mesme organizoheshin me një numër të madh profesorësh të vet. Me ta bashkëngjiteshin gazetarë dhe organizata mediumore, organizata të ndryshme joqeveritare, një pjesë e sindikatave zyrtare, një numër i madh individësh nga bota e artit dhe shkencës, si dhe aktivistë politikë, të gjithë së bashku të tubuar në rrugë në protesta më të vogla e më të mëdha në kryeqytet, ashtu si edhe në një varg qytetesh të tjera në vend – përditë¹⁹⁵.

Frika dominuese e dikurshme dhe shqetësimi që mbretëronte te qytetarët shpejt u ndërrua me pa dëgjueshmëri qytetare dhe mospajtim i hapur me politikat dhe praktikat qeveritare.

Në pjesën e parë të vitit 2016, këto protesta morën domethënie ideologjike, kur mblihdeshin rreth lëvizjes që veten e quajti Revolucioni i Larmë. Lëvizja u ngre nga aktivistë qytetarë me përkrahje të aktivistëve juridikë të prokurorisë publike speciale, punë e të cilëve vazhdimisht sabotohej nga ana e regjimit. Revolucioni i Larmë ishte lëvizje e organizuar horizontalisht që i koordinon aktivitetet e veta përmes rrjeteve sociale, pa ndonjë lidhshmëri të dukshme apo strukturë organizative të pashme. Në qendër të vëmendjes së Revolucionit të Larmë janë thirrjet për përgjegjësi juridike për të gjithë ata që janë të kyçur në aktivitete të paligjshme në shoqëri. Sipas analistit Ordanovski, aparati propagandistik shtetëror nuk kurseu kohë, përpjekje a resurse, për të “dëshmuar” se kjo lëvizje është rezultat i “konspiracionit perëndimor”, të udhëhequr nga Xhorxh Soros, me qëllim të mposhtjes së “qeverisë legjitime” në Maqedoni. “Pohohej se ajo paraqet lëvizje në stilin e Revolucionit të Portokalltë, tipike për nisma të ngjashme qytetare që po shpërndahen në vitet e fundit në Tunizi, Egjipt dhe Ukrainë. Përmes aparatit propagandues shpërndaheshin teori të marra konspirative e spekulime, ashtu si edhe sulme personale ndaj pjesëtarëve më aktivë të lëvizjes me qëllim që të diskreditohej Revolucioni i Larmë”¹⁹⁶. Megjithatë, këta aktivistë qytetarë nuk i zmbrapsi propaganda e regjimit, e as që u shkurajuan nga ana e forcave policore masive në rrugët apo përmes arrestimeve të shumta

¹⁹⁵ ZGJEDHJE TË LIRA: KUSHT PËR TË CILIN NUK KA NEGOCIATA, Botues: CIVIL, Shkup, Korrik 2016, f. 58.

¹⁹⁶ Ibid

e akuzave të parashtruara nga ana e autoriteteve: nga 12 prilli i vitit 2016 e kësaj thuajse çdo pasdite mijëra njerëz përpara ndërtesës ku gjendet prokuroria publike speciale në Shkup, fillojnë marsh protestues nëpër qendër të qytetit; gjuhet me bojë nëpër fasadat e ndërtesave të institucioneve shtetërore dhe përmendoret që dolën në kuadër të projektit të ashtuquajtur “Shkupi 2014”, që e simbolizon fuqinë politike të korruptuar të regjimit të korruptuar të Gruevskit. Ajo që filloi me disa qindra njerëz, përgjithësisht të rinj, që protestojnë në Shkup, shpejt u rrit në mijëra njerëz që marshojnë përditë nëpër kryeqytet, ashtu si edhe në nja njëzet qytete nëpër gjithë Maqedoninë. Dalëngadalë, edhe opozita e tregoi praninë e vet më të fortë në protesta, edhe pse ajo këmbëngul të mos përfshihet shumë në agjendën e aktiviteteve konkrete në protestat e Revolucionit të Larmë. Ky sezon i protestave qytetare pranverore në Maqedoni kulminoi më 20 qershor, me protesta të mëdha me rreth 30.000-40.000 njerëz në Shkup, duke i stërmbytur rrugët dhe sheshet para ndërtesave të Qeverisë dhe Kuvendit. Protestuesit kërkonin rënie të regjimit, shfuqizim të të gjitha obstrukcioneve të prokurorisë publike speciale dhe zbatim të së drejtës së të gjithë atyre që janë të kyçur në aktivitete kriminale në dekadën e fundit të pushtetit demokratikisht të deformuar të Gruevskit.

Kriza politike ishte thelluar në të gjitha dimensionet e saj dhe tashmë ishte e qartë që duhej një transformim i madh shoqëror për ta kthyer atë drejt vlerave demokratike dhe drejt etablimit institucional. Përpjekjet e pushtetit të atëhershëm dukeshin të zbehta përballë këtij momentumit të krijuar demokratik dhe qytetar që kërkonte një zgjidhje për gjithë atë situatë krize politike. Dhe zgjidhja me kohë ishte ravigjzuar me Marrëveshjen e Përzahinos, e cila strukturonte gjithë transformimet e mundshme elektorale dhe institucionale për t’iu përgjigjur një realiteti të ri politik, një krize të thellë sistimore, e cila nuk mund të mos kalonte përmes një procesi zgjedhor korrekt dhe demokratik.

Me Marrëveshjen e Përzahinos të nënshkruar nga liderët e katër partive më të mëdha parlamentare në Maqedoni, vendosej suaza e obligimeve dhe procedimit me krizën politike, e cila tashmë ishte thelluar në të gjitha sferat e jetës institucionale, por edhe të jetës publike përgjithësisht, me tendencë për ta shndërruar atë edhe në një krizë ndëretnike.

Në këtë marrëveshje të nënshkruar më 2 qershor të vitit 2015, thuhej se: “Partitë pajtohen ta vëndojnë interesin e shtetit në vend të parë dhe e konfirmojnë përkushtimin e tyre për proceset euro-atlantike dhe për respektimin e parimeve demokratike;

Në interes të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve në vend, partitë u pajtuan që të ndërmarrin hapa për tejkalimin e krizës aktuale. Partitë obligohen se do të sigurojnë inkluzivitet në zbatimin e kësaj marrëveshjeje nëpërmjet konsultimeve dhe koordinimit me partitë kryesore politike në vend;

Partitë politike obligohen t'i respektojnë parimet demokratike të përgjegjësisë politike gjatë trajtimit të sfidave kryesore me të cilat ballafaqohet vendi;

Në këtë kohë të sfidave të mëdha shtetërore, partitë pajtohen se, duke vepruar në interes të të gjithë qytetarëve, duhet t'i trajtojnë sfidat kritike dhe të pashembullta me të cilat ballafaqohet vendi, me qëllim të konsolidohet zhvillimi ekonomik dhe demokratik, të përforcohen marrëdhëniet ndëretnike, të sigurohet implementim i plotë i Marrëveshjes kornizë të Ohrit, të përforcohen marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore dhe pozita ndërkombëtare e vendit, dhe në këtë mënyrë ta sjellin më afër qëllimit në rrugën e saj euro-atlantike;

Prandaj, partitë politike u pajtuan të caktojnë një “periudhë kalimtare (tranzicioni)” e cila do të fillojmë menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, dhe do të përfundojë me zgjedhje të lira dhe të drejta, që do të zbatohen në përputhje të plotë me standardet evropiane deri në fund të prillit të vitit 2016”¹⁹⁷.

Pavarësisht nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, kriza politike do të vazhdojë dhe do të thellohet akoma më tepër me taktizime politike nga ana e partive, sidomos partisë në pushtet VMRO-DPMNE. Të ndodhur në një situatë të këtillë, pa një rrugëdalje nga kriza, bashkësia ndërkombëtare, sidomos përfaqësuesit e SHBA-së dhe BE-së do të kërkojnë zgjidhje të shpejtë pa humbur kohë. Në këtë drejtim partitë politike do të mbliidhen edhe njëherë në Përzhino dhe do të arrijnë një marrëveshje tjetër politike të afatizuar, e cila përfundimisht do ta caktojë mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare në dhjetor 2016.

“Për dallim nga [Marrëveshja e Përzhinos](#) (02. 06. 2015), në të cilën data e zgjedhjeve u caktua që në fillim, këtë herë partitë janë marr vesh që deri me **31 gusht** të vlerësojnë ndryshimet në marrëveshje, që më pas të saktësojnë datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Dhe, nëse partitë japin dritën jeshile, 100 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve

¹⁹⁷ Marrë nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

(një prej datave të mundshme mendohet të jetë 11 dhjetori i vitit 2016), do të formohet qeveria teknike e cila do të zbatojë gjithë procesin zgjedhor”¹⁹⁸.

Kjo marrëveshje iu jepte zgjidhje shumë çështjeve për të cilat partitë politike vazhdonin të konfrotoheshin dhe ta mbanin të bllokuar procesin politik, i cili duhej të rrumbullaksohej me zgjedhje të lira dhe të ndershme, duke respektuar të gjitha rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo marrëveshje tashmë parashikonte ndryshime në kodin zgjedhor, gjegjësisht pastrimin e listave, rregullimin e përfaqësimit në media të partive politike, datën për mbajtjen e zgjedhjeve, formimin e qeverisë teknike si dhe funksionimin normal dhe të papenguar të Prokurorisë Speciale Publike.

Me angazhimin permanent të bashkësisë ndërkombëtare, kriza politike e cila tashmë ishte thelluar në të gjitha sferat e jetës institucionale dhe publike, po futej në koordinatat e zgjidhjes. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të duhej t’i jepnin fund kësaj krize shumëdimensionale, e cila po refleктоhej në parametrat ekonomik dhe bashkë me këtë edhe në jetën e përditshme të qytetarëve.

¹⁹⁸ Marrëveshja e Përzhinos episodi i tretë, plani ambicioz për zgjedhje të drejta dhe kredibile. Marrë nga: <http://vertetmates.mk/marrevshja-e-perzhinos-epizodi-i-trete-plani-ambicioz-per-zgjedhje-te-drejta-dhe-kredibile/>

4.4 Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 sfidë për tejkalimin e situatës së krijuar dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtim të Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit European dhe strukturave të NATO-s

Kriza politike sistemore rrënjët e së cilës, sipas shumë analistëve dhe studiuesve të vëmendshëm shkonin para më se një dekade, kishte kaluar në ndërkohë edhe nëpër një kontekst tjetër, atë të zhagitjes dhe fajësimeve politike. Por, Marrëveshja e Përzghinos dhe marrëveshja plotësuese për çështjet e debatueshme tashmë kishin krijuar suazën e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat vlerësohej se do t'i jepnin fund krizës së thelluar politike.

Më datë 11 dhjetor 2016 u mbajtën zgjedhjet e teta parlamentare të radhës nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, të cilat njëkohësisht ishin zgjedhjet e katërta të radhës të parakohshme parlamentare. “Në këto zgjedhje të drejtë vote patën gjithsej 1.784.416 votues prej të cilëve 20.573 votues nga diaspora. Personat e sëmurë, të pamundur, personat në arrest shtëpiak dhe të burgosurit në institucionet ndëshkuese-korrektuese votuan një ditë më herët, përkatësisht më datë 10 dhjetor. Votimi në përfaqësitë diplomatike-konsullore u mbajt më datë 7 dhjetor. Dalja në zgjedhje ishte 66,79% ose 1,191,852 votues në krahasim me 63% dalje në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Në diasporë dalja ishte 40% ose 8,232 votues”¹⁹⁹.

Sipas autores së këtij manuali “në këto zgjedhje morën pjesë 11 subjekte politike, përkatësisht pesë koalicione dhe gjashtë parti politike me 58 lista të kandidatëve, edhe atë: Koalicioni “Për një Maqedoni më të Mirë” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, “Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë”, Koalicioni “VMRO për Maqedoninë”, Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët”, Partia Demokratike e Shqiptarëve, Bashkimi Demokratik për Integrim, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Liberale, Lëvizja BESA dhe Levica”.

Sipas KSHZ, zgjedhjet parlamentare u monitoruan nga gjithsej 7,605 vëzhgues të akredituar vendor dhe të huaj dhe 642 vëzhgues të huaj, 354 përkthyes dhe 98 gazetarë të huaj. Vlerësimi i përgjithshëm i vëzhguesve ishte se zgjedhjet ishin të qeta, megjithatë, gjatë

¹⁹⁹ Veljanova, H. *Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016*. Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci “Societas Civilis” –(Shkup, 2016, f. 88).

procesit zgjedhor u regjistruan disa parregullsi të caktuara. Vërejtjet kryesore të vëzhguesve kishin të bëjnë ushtrimin e presionit mbi votuesit, mosrespektimin e fshehtësisë së votimit, votimit grupor etj.

“Zgjedhjet rezultuan me ndryshime drastike sa i përket shpërndarjes së mandateve midis pjesëmarrësve. Koalicioni “Për një Maqedoni më të Mirë” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE në përbërjen e ardhshme të Kuvendit do të ketë 51 deputetë për dallim nga 61 deputetët e deritanishëm, ndërsa BDI do të ketë 10 deputetë për dallim të 19 deputetëve në përbërjen e fundit. Në llogari të dobësimit të partive në pushtet, partitë/koalicionet opozitare, pas këtyre zgjedhjeve, do të jenë më shumë të përfaqësuara në Kuvend sesa në përbërjen e fundit. Koalicioni i LSDM fitoi 49 vende të deputetëve, përkatësisht 15 vende më shumë se në legjislaturën e fundit parlamentare kur kishte 34 deputetë. PDSH tani ka 2 deputetë, përkatësisht 5 më pak sesa në përbërjen e fundit kur kishte 7 vende të deputetëve. Risi në këto zgjedhje ishin partitë dhe koalicionet e formuara të reja shqiptare - Lëvizja BESA dhe Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët”, të cilat për herë të parë do të hynë në Kuvend. Lëvizja BESA fitoi 5 mandate, ndërsa Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët” 3 mandate. Partitë dhe koalicionet e tjera pjesëmarrëse në këto zgjedhje, përkatësisht Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Liberale, Koalicioni “VMRO për Maqedoninë” dhe Levica nuk fituan vota të mjaftueshme për të siguruar përfaqësues të vet në Kuvend. Në këto zgjedhje, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të votave, asnjë kandidat për deputetë nga diaspora nuk siguroi mandat në Kuvend. Në diasporë numër më të madh të votave fitoi Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE - 5,044”²⁰⁰.

Në vazhdim të këtij Manuali vijon vështrimi i detajuar i fushatës zgjedhore, i të ardhurave dhe shpenzimeve të partive dhe koalicioneve gjatë kohës së fushatës zgjedhore, raportimit të mediave, rezultateve të zgjedhjeve, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të zgjedhësve, vlerësimit të zgjedhjeve nga vëzhguesit dhe partitë politike, si dhe konkluzionet e përmbledhura për ciklin e përgjithshëm zgjedhor.

“Në fokus të fushatës ishte çështja e krizës politike në Maqedoni, federalizimi i Maqedonisë dhe dygjuhësia, shpërngulja e të rinjve, hapja e vendeve të reja të punës, ekonomia.

²⁰⁰ Ibid

Sipas Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR, gjatë fushatës zgjedhore partitë kishin mundësi lirshëm t'i zhvillojnë fushatat e tyre, me ç'rast u respektua liria e shoqërimit, tubimit dhe e shprehjes. Megjithatë edhe krahas kësaj konkluzionet janë se gjatë kohës së fushatës u regjistrua një numër i caktuar i incidenteve si pretendime për frikësimin e votuesve, presion mbi nëpunësit shtetërorë, mbi individë dhe familjet e tyre, keqpërdorim të resurseve administrative, blerja e votave në bashkësinë rome. Në bllokun shqiptar fushata zhvillohej në mënyrë akoma më intensive me një retorikë të ashpër. Vëzhguesit e OSBE, mes tjerash, vërejtën edhe raste të sjelljes së dhunshme, siç është vandalizmi i shtabeve partiake, shkatërrimi i bilbordeve, dëmtimi i automjeteve të anëtarëve të partive politike”²⁰¹.

Mbetet me interes të theksohet se këto zgjedhje nuk i dhanë zgjidhje përfundimtare krizës politike, e cila do të vazhdojë edhe pas mbajtjes së tyre, sidomos gjatë krijimit të shumicës së re parlamentare, kur edhe eskaloj në një dhunë të paparë në parlament, në një ngjarje të përgjakshme, e cila përfundimisht e bëri kthesën e madhe, sepse nga ky moment forcat destruktive nacionaliste tashmë duhej të përballeshin me forcën e ligjit.

Me zgjedhjet e reja parlamentare, Maqedoni fitoi qeveri të re proevropiane, ndërkohë që kapacitet demokratike të institucioneve filluan ngritjen e tyre në drejtim të proceseve integruese. Gjithë ngjarjet e mëpastajme do të jenë në funksion të proceseve integruese, të vizionit për të qenë pjesë e Bashkimit European. Maqedonia, gjegjësisht gjithë aktorët e jetës civile dhe partitë politike progresive iu përgjigjen kësaj sfide zgjedhore, por edhe ftesës së bashkësisë ndërkombëtare dhe pritjeve të qytetarëve për të ndërtuar institucione që do të jenë në funksion të kësaj rruge euro-atlantike, anëtarësimit në BE dhe NATO.

²⁰¹ Ibid, faq.89

Kapitulli V: Analizë ose shpalosje e rezultateve të analizës empirike me qytetarë të komunave të Pollogut

1. Përshkrimi i metodës hulumtuese
2. Rezultatet e hulumtimit
3. Përfundime dhe rekomandime
4. Literatura
5. Shtojcë

5. Përshkrimi i metodës hulumtuese


Gjatë hulumtimit janë përdorur metoda dhe teknika bazë të studimit shkencorë: analiza dhe sinteza, induksioni dhe deduksioni, metoda historike, metoda komparative, metoda statistikore si dhe pyetësi si një nga teknikat bazë dhe më gjerësisht të përdorura në hulumtimet e shkencave sociale. Metoda që është përdorur gjatë këtij hulumtimi shkencor për mbledhjen e të dhënave është anketimi i cili është realizuar kryesisht “online” nëpërmjet “google forms”, ku më pas janë përpunuar me ndihmën e programit statistikor Exel.

Pyetësi është realizuar me një gamë të gjerë të qytetarëve kryesisht banorë të komunave të Pollogut me gjithsej 515 qytetarë gjatë periudhës së vitit 2018, ndërsa 30% e ekzemplarit është realizuar personalisht në teren me qëllim që të bëhet një balancim sa i përket të dhënave demografike. Në bazë të përqindjes së popullsisë në baza etnike, maqedonasit që jetojnë në regjionin e Pollogut apo thënë ndryshe njësia e gjashtë zgjedhore sipas të dhënave statistikore rezultojnë të jetë 15% e popullatës së përgjithshme. Që domethënë se në po të njëjtën mënyrë kemi selektuar edhe përqindjen e të anketuarve sa i përket strukturës etnike. Të anketuarit e nacionalitetit maqedonas gjithashtu janë anketuar personalisht në teren me qëllim që të shihen edhe reagimet e tyre emocionale sa i përket çështjes në fjalë ngaqë kompromiset me Greqinë për palën maqedonase s’do mend se ishin më të dhimbshme. Por gjithsesi si çdo herë pa dyshim se kemi rezervat tona sidomos sa përket strukturës etnike sepse jemi të vetëdijshëm se nuk disponojmë të dhëna të sakta statistikore për shkak të manipulimeve të ndryshme dhe se tani më një kohë të gjatë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë në Maqedoninë Veriore. Gjithashtu kemi parasysh dhe faktin se gjatë hulumtimeve kuantitative shpesh paraqiten anomali, e që janë të zakonshme sa i përket hulumtimeve në shkencat shoqërore sepse të dhënat asnjëherë nuk mund të jenë absolutisht të sakta siç ndodh rëndom në shkencat ekzakte.

5.1 Rezultatet e hulumtimit


Pyetësonin së bashku me rezultatet e nxjerra në mënyrë grafike i cili ishte i përbërë nga gjithsej 20 pyetje jua paraqesim më poshtë si vijon:

Grafikoni 1. Struktura e grupmoshave të të anketuarve




Pasi që anketën e zhvilluam me të gjithë ata persona fizik që kishin të drejtë vote e të cilët sipas ligjit detyrimisht duhet të jenë mbi moshën 18 vjeç, sipas paraqitjes grafike të anketuarit ishin të grup moshave të ndryshme ku 34.9% të anketuar ishin të moshës prej 18-29, në grupmoshën 30-45 përbënin 41.5% të anketuar, 14.2% kemi grupmoshën prej 46-59, si dhe mbi 60 përbëjnë 9.4%, të anketuarve. Siç shihet dominojnë grupmoshat më vitale, kjo sipas mendimit tonë ndikon dukshëm në cilësinë e hulumtimit për shkak se këto janë gjithashtu edhe përgjegjëse dhe bartëse të proceseve shoqërore.

Grafikoni 2. Struktura gjinore e të anketuarve



Sipas grafikunit të dytë, 54% e të anketuarve ishin të gjinisë mashkullore kurse 45% të asaj femërore. Sa i përket strukturës gjinore në një përqindje jo shumë të madhe dhe atë prej 9% dominon gjinia mashkullore, në përgjithësi për shkak se sipas të gjeturave gjinia mashkullore paraqiten si më aktiv dhe më të interesuar jo vetëm sa i përket daljes në votim por gjithsesi se ata janë edhe politikisht më të angazhuar dhe më aktiv në jetën shoqërore dhe politike në vend. Ndërsa gjinia femërore në realitetin tonë përgjithësisht nuk është dhe aq e kyqur në çështjet publike, gjë që reflekton edhe me rezultatet e fituara në anketim sepse disa prej tyre edhe hezitonin që të përgjigjeshin në pyetësonin tonë.


Grafikoni 3. Struktura demografike e të anketuarve



Qytetarë të anketuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim në fshat ishin 54.3%, dhe 45.7% përbënin ato me vendbanim në qytet.

E që rastësisht rezulton të jetë i njëjtë me paraqitjen grafike gjinore të mësipërme.


Grafikoni 4. Struktura etnike e të anketuarve



Paraqitja grafike tregon se në hulumtim u përfshijnë të gjitha grupet etnike, të përfaqësuara proporcionalisht me numrin e përgjithshëm të banorëve që jetojnë në rajonin e Pollogut, ku prej të anketuarve 82% ishin shqiptar, 15.6% maqedonas, 1.6% turq dhe 0.8% të tjerë. Struktura etnike është selektuar në atë mënyrë që është marrë për bazë përqindja e etniteteve në rajonin e Pollogut.

Megjithëse kemi rezervat tona sa i përket kësaj strukture sepse jemi të vetëdijshëm se nuk disponojmë të dhëna të sakta statistikore për shkak se tani më një kohë të gjatë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë në Maqedoninë Veriore.


Grafikoni 5. Struktura arsimore e të anketuarve



Me qëllimin që të arrimë rezultate sa më të mira dhe teoritikisht më të qëndrueshme në anketim kemi përfshirë qytetarë me nivel të ndryshëm të arsimit. Gjithashtu shihet një përfshirje e të gjithave kategorive arsimore, ku 8.6% e të anketuarve ishin me shkollë fillore, 29.5% të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm, 40.3% me nivel arsimor deri diplomik dhe 21% e të anketuarve ishin me nivel arsimor postdiplomik.


Nga tabela e lartë përmendur shihet se dominojnë personat me nivel arsimor deridiplomik ose me fakultet të kryer, gjë që na bën të shpresojmë se përgjigjet e dhëna në përgjithësi janë drejt të kuptuara nga ana e të anketuarve.

Grafikoni 6. Statusi socio-ekonomik




Sa i përket statusit social në grafikonin e sipërm mund të shohim se kemi 61.9% të anketuarve të punësuar dhe 38.1% të deklaruar si të pa punësuar. Edhe pse jemi të vetëdijshëm se statusin ekonomik të qytetarëve nuk e krijon vetëm punësimi zyrtar megjithatë përqindja prej 38% që rezulton të jetë e lartë e që është e zakonshme në shtetin tonë sepse papunësia na paraqitet si fenomen e sidomos tek të rinjtë që shumica po ashtu janë dhe me kualifikime përkatëse arsimore.

Grafikoni 7. Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake




Në pyetjen e parashtruar në grafikonin e më sipërm mbi 86% e të anketuarve janë deklaruar se bëjnë dallim mes demokracisë dhe demokracisë partiake. Kjo është inkurajuese nga njëra anë, por edhe vështirë e besueshme nga ana tjetër. Nuk mundemi të jemi edhe aq të sigurt se qytetarët e Pollogut kanë aq njohuri të avancuara në lidhje me partitë politike. Jemi të prirë të mendojmë se të anketuarit nuk e kanë kuptuar pyetjen si duhet.

Grafikoni 8. Qëndrimet e qytetarëve sa i përket nocionit të demokracisë




Sipas paraqitjes grafike të mësipërme edhe rezultatet e pyetjes në vazhdim vështirë mundën të llogariten si të sakta me vetë faktin se niveli i arsimimit dhe profesionet e të anketuarve nuk na japin të drejtë që përgjigjet e marura ti llogarisim si valide pa kurrfarë rezerve.

Grafikoni 9. Demokracia pluraliste dhe zhvillimi i kapaciteteve demokratike në vend.




Rezultatet apo përgjigjet në pyetjen e radhës pa dyshim janë shumë më korrekte dhe përputhen me shumë hulumtime të bëra nga kjo sferë. Është më se e saktë se demokracia pluraliste vetvetiu nuk nënkupton zhvillimin e kapaciteteve demokratike të një vendi. Një matematikë e thjeshtë bën të qartë se të anketuarit që janë përgjigjur me „jo„ dhe që dakordohen pjesërisht janë përafërsisht sa ata që janë përgjigj me „po„.

Grafikoni 10. Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion




Në pyetjen në vijim qytetarët e anketuar kanë treguar një pjekuri më të madhe politike. Një përqindje shumë e vogël dakordohen se Republika e Maqedonisë së Veriut ka ecur përpara me demokratizimin e vendit. Qytetarët që pjesërisht pajtohen paraqesin një shumicë shumë të madhe dhe atë me 35% e tyre.

Grafikoni 11. Zgjedhjet dhe zhvillimi demokratik i një vendi.




Në pyetjen e parashtuar më lartë të priturat kanë qenë që të anketuarit në përqindje shumë më të madhe të pohojnë se zgjedhjet janë komponentë e rëndësishme për zhvillimin demokratik. Ajo se vetëm 56,4% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht mundet të interpretohet si një zhgënjim i të anketuarve nga ajo që premtohet gjatë fushatave zgjedhore nga subjektet që garojnë për marrjen e pushtetit dhe ajo që ata ju ofrojnë qytetarëve pasi që vijnë në pushtet.

Grafikoni 12. Identifikimi i zgjedhjeve me demokracinë




Në pyetjen e radhës shihet qartë se të anketuarit janë përgjigjur instiktivisht, pa mos e lodhur shumë kokën. Të identifikohen zgjedhjet me demokracinë i anketuari duhet të ketë shumë njohuri nga veprimi i partive politike dhe të jetë njohës shumë i mirë i zgjedhjeve dhe sistemeve elektorale.

Grafikoni 13. Zgjedhjet në shoqëritë me demokraci të zhvilluar dhe zgjedhjet e vendeve në tranzicion




Sipas këtij grafikoni, në pyetjen e radhës befason fakti se 26,3% e të anketuarve nuk kanë pas përgjigje. Nga ana tjetër shihet qartë se të anketuarit e kuptojnë esencën mes demokracisë në vendet e zhvilluara dhe atyre në tranzicion.

Grafikoni 14. Republika e Maqedonisë së veriut dhe progresi në zgjedhje.




Përgjigjet e marra nga pyetja e radhës në një mënyrë janë dëshpëruese. Mbi 41% e të anketuarve të mendojnë se „pjesërisht„ për një çështje që është aq e dukshme duket e pa kuptimtë. Megjithatë gëzon fakti se nga të anketuarit një përqindje bukur e madhe janë përgjigjur me „jo„ në pyetjen e parashtruar.

Grafikoni 15. Republika e Maqedonisë së veriut dhe ndryshimi i modelit zgjedhorë



Në pyetjen e parashtruar të anketuarit pa rezervë e kanë përkrahur ndërimin e modelit zgjedhorë. Kjo duhet të kuptohet se qytetarët mbajnë llogari për demokratizimin e votës së lirë. Ndryshe thënë ata preferojnë një lidhje më të ngushtë të votuesve me të zgjedhurit e tyre.

Grafikoni 16. Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore .




Ende më qartë qëndrimet e të anketuarve demokratizimit të votës së lirë kanë ardhur në shprehje në pyetjen e radhës, në ç'rast afro 57% të tyre kanë preferuar listat e hapura të cilat e zvogëlojnë pushtetin e liderëve dhe bërthamave partiake në favor të qytetarëve të cilët si pas kushtetutës janë mbartësit e vetëm të pushtetit shtetërorë. Pra modeli i listave të hapura e largon shtetin nga partiokratia dhe e orientojnë drejtë demokracisë.

Grafikoni 17. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016 dhe fillimi i reformave demokratike




Nga pyetja në vijim bëhet e qartë se të anketuarit i identifikojnë qartë krizën politike dhe reformat e domosdoshme. Zgjedhjet e vitit 2016 si të parakohshme dhe jashtëzakonshme paraqesin jo vetëm krizë të sistemit qeverisës por edhe krizë të institucioneve shtetërore, pra krizë sistemore. Shumë e drejtë është të anketuarit në këta zgjedhje të shohin një fillim të ri në ndërtimin e shtetit.

Grafikoni 18. Ndikimi i Zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend




Sa i takon relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike që është një çështje shumë e ndjeshme, qëndrimet e të anketuarve janë të ndara. Domethënë ata shprehin rezerva të caktuara. Këtu rezerva më të mëdha kanë shprehur të anketuarit shqiptarë të cilët janë numerikisht më të përfaqësuar në anketim. Sa u përket atyre maqedonas në Maqedoninë e Veriut problemet ndëretnike janë vetëm shpifje e „nacionalizmit,, shqiptarë.

Grafikoni 19. Kriza gjithëpërfshirëse, zgjedhjet parlamentare 2016 si dhe ndërtimi i kapaciteteve demokratike për integrim në strukturat euroatlantike



Në përgjithësi të anketuarit janë optimist sa i përket zgjedhjeve parlamentare 2016 si zgjedhje që ndikuan në tejkalim të krizës dhe ndërtim të kapaciteteve demokratike. Po të ishte bërë anketimi në nivel të shtetit me siguri do të merrnim përgjigje më ndryshe. Kjo përsëri ndërlidhet me shqiptarët e anketuar të cilët ardhjen e forcave majtiste e shiqonin me shumë shpresa si për ardhmërinë e shtetit ashtu dhe për ardhmërinë e tyre.

Grafikoni 20. Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë si zgjidhje e vetme e mundshme.




Po thuajse gjysma e të anketuarve me një përqindje prej 47% pajtohen se nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë, është zgjedhje e vetme e mundshme për zhvillim të qëndrueshëm të RM si në planin socio-ekonomik ashtu edhe në planin politik? Si dhe 23% shprehen se pajtohen pjesërisht me një mendim të tillë. E në përgjithësi na len të kuptojmë se qytetarët e Pollogut janë optimist sa i përket këtij rrugëtimi ato besojnë se nuk ka zgjidhje tjetër dhe se ato përkrahin iniciativa dhe procese politike të kësaj natyre. Megjithatë nuk mund të jemi të sigurt se do ti kishim po të njëjtat përgjigje nëse në anketim përfshiheshte i tërë territori i vendit.

Sa i përket opsionit aspak nuk pajtohem e që janë një përqindje prej 9.6% e që sigurisht se i tangonin përkatësisë etnike maqedonase haptas shprehnin mllefin për nënshkrimin e kësaj marrëveshje që nënkuptonte edhe ndryshimin e emrit të shtetit, mllef të cilin po ashtu ja adresonin partisë në pushtet e sidomos kryeministrit aktual. Gjë që len të kuptojmë se ata gjithashtu janë militant të partisë në opozitë por kishte nga ata që shprehnin sentimentalizma nacionaliste pa marrë parasysh pozicionimin partiak, Ndryshimi i emrit për ta në përgjithësi dhe për faktorë të tjerë emocional rezultonte të ishte kompromis shumë i dhimbshëm i cili nuk ja vlente të ndodhte në asnjë mënyrë.

5.2 Pyetje të kryqëzuara

Grafikoni 21. Struktura arsimore & Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake

- Niveli arsimor
- A mund të bëni dallimin në mes demokracisë dhe demokracisë partiake si nocione?




Tek të gjitha nivelet arsimore kryeson opsioni se po ato munden të bëjnë një dallim të tillë apo se ne përgjithësi kanë një ide sa i përket dallimit mes demokracisë dhe demokracisë partiake. Sipas paraqitjes grafike shihet se të anketuarit me nivel më të lartë arsimor po ashtu janë shprehur më së shumti pozitivisht sa i përket kësaj pyetje.

Grafikoni 22. Statusi socio-ekonomik & Qëndrimet e qytetarëve mbi dallimet mes demokracisë dhe demokracisë partiake

✚ Statusi socio- ekonomik


✚ A mund të bëni dallimin në mes demokracisë dhe demokracisë partiake si nocione?



Sa i përket pyetjes së njëjtë si në grafikonin e më sipërm në kryqëzim me statusin social kryesisht personat e punësuar pohojnë se mund të bëjnë një dallim të tillë.

Grafikoni 23. Struktura etnike & Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion


- ✚ Përkatësia etnike
- ✚ Republika e Maqedonisë ka hapëruar në kuptimin e demokratizimit me vendet tjera në tranzicion?



Sa i përket pyetjes se Republika e Maqedonisë ka hapëruar në kuptimin e demokratizimit me vendet tjera në tranzicion në kryqëzim me përkatësinë etnike, tek të dy etnitë në përgjithësi kryeson opsioni pjesërisht pajtohem por gjithashtu një numër i konsiderueshëm gjithashtu mbajnë qëndrim se aspak nuk pajtohem dhe pjesërisht nuk pajtohem. Pyetja në përgjithësi rezulton pozitive sepse ata janë të vetëdijshëm sa i përket zhvillimit demokratik të vendit duke mos qenë të kënaqur në përgjithësi sidomos etniteti shqiptar.

Grafikoni 24. Struktura arsimore & Demokratizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në krahasim me vendet tjera në tranzicion

- Niveli Arsimor
- Republika e Maqedonisë ka hapëruar në kuptimin e demokratizimit me vendet jera në tranzicion?




Kryesisht tek të gjitha nivelet arsimore dominon përgjigja pjesërisht pajtohem në lidhje me atë se Maqedonia e Veriut në kuptimin e demokratizimit është në hap me vendet tjera të tranzicionit dhe më pastaj sipas të dhënave vijon dominimi i opsionit aspak të kënaqur tek të gjitha nivelet arsimore gjithashtu.

Grafikoni 25. Struktura arsimore & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimi i modelit zgjedhorë

■ Niveli arsimor

■ A mendoni se Republika e Maqedonisë duhet ta ndryshon modelin zgjedhor?




Në lidhje me këtë grafikon shihet shumë qartë se pothuajse të gjithë të anketuarit e të gjitha niveleve arsimore dëshirojnë që një gjë e tillë domosdoshmërisht të ndodh në Republikën e Maqedonisë Veriore. Kemi përshtypjen se edhe pse masa e gjerë nuk i kupton modelet zgjedhore dhe se një gjë e tillë është normale nga shkakut se të tillat kërkojnë njohuri profesionale megjithatë ata e ndjenë se ndonjë ndryshim patjetër duhet që të bëhet, përderisa nuk janë të kënaqur me gjendjen momentale në vend. Reformat në sistemin zgjedhor të cilat do i përshtateshin më shumë vendit tonë me qëllim që qytetarët të përfaqësoheshin më denjësisht e që në përgjithësi është qëllim kryesor i demokracisë. E që gjithmonë duke pasur parasysh se zgjedhjet sigurisht se kanë ndikim shumë të madh në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve demokratike të një vendi.

Grafikoni 26. Struktura e grupmoshave & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

✚ Moshë

✚ A mendoni se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e RM-së?




Sa i përket pyetjes se a mendoni se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e RMV-se? Të gjitha grupmoshat në përgjithësi po thuhetse gati në mënyrë unanime konsiderojnë se një gjë e tillë duhet të ndodh, si dhe një pjesë e tyre gjithashtu shprehen se pjesërisht pajtohen për një gjë të tillë. Edhe pse siç përmendëm më lartë se për një reflektim të tillë nevojiten dije të detajuara profesionale dhe studimore sepse modelet zgjedhore janë çështje të komplikuar sidomos për masën e gjerë, mirëpo llogarisim si përgjigje pozitive në përgjithësi sepse domethënë që qytetarët me çdo kusht duan që të bëhen ndryshime esenciale sa i përket procesit zgjedhor që si rrjedhojë do të ndikoj edhe në zhvillimin demokratik të vendit.

Grafikoni 27. Struktura demografike & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

✚ Vendbanimi


✚ A mendoni se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e RM-së?



Edhe nga ky grafikon mund të kuptojmë se të anketuarit e të dy vendbanimeve janë pro këtij ndryshimi. Gjithashtu kemi përshtypjen se listat e hapura mund të ndryshojnë edhe sjelljen elektorale të votuesve duke e rritur numrin e atyre që do ta shfrytëzonin të drejtën e votës sepse ato tani do të kishin mbase motiv shtesë nga shkaku se do të kishin edhe më të qartë se kush është kandidati që ata pretendon që ti i përfaqësojë gjë që automatikisht besohet se do të rriste kërkesën për meritokraci. Megjithatë është më se e nevojshme që paraprakisht të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe serioze sa i përket ndryshimeve të tilla shoqëruar me një debat të hapur dhe konstruktiv. Ku dimë se demokracia në vend dhe rajon, sidomos demokracia brenda partiake, niveli komunikimit, dhe kultura politike, ndryshon shumë me vendet e zhvilluara. Sepse në transparencë dhe meritokraci duhet pasur parasysh se edhe liderët partiak do jenë të sfiduar gjithashtu.

Grafikoni 28. Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimi i modelit zgjedhorë & Republika e Maqedonisë së Veriut dhe modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore

- ✚ A pajtoheni se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e Republikës së Maqedonisë?
- ✚ A mendoni se Republika e Maqedonisë duhet ta ndryshon modelin zgjedhor?




Pothuajse në mënyrë unanime qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut pajtohen se modeli zgjedhor duhet ndryshuar në këtë shtet. Si dhe gjithashtu ato pothuajse një zëri shprehen se pajtohen se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut? Gjë e cila jemi të vetëdijshëm se nuk ju konvenon edhe aq shumë partive të mëdha në vend për shkak se ky model zgjedhor s'do mend se preferon apo len hapësirë më të madhe për partitë më të vogla në garat zgjedhore. Por një gjë e tillë nuk do të thotë se nuk mund të ndodhë edhe nëse partitë e mëdha nuk shprehin vullnetin për të bërë ndryshime të tilla për shkak se në këtë rast mund të marrim si shembull shtetin Zvicëran ku ndryshimi i modelit zgjedhor u mundësua me anë të referendumit.

Grafikoni 29. Struktura etnike & Ndikimi i Zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend

🚩 Përkatësia etnike

🚩 A pajtoheni se zgjedhjet parlamentare te vitit 2016 kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale?




Të anketuarit me përkatësi etnike shqiptare në përqindje më të madhe kryesisht janë shprehur se pjesërisht pajtohen dhe se pajtohen se zgjedhjet parlamentare te vitit 2016 kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale. Ndërsa qytetarët me përkatësi etnike maqedone shprehin të kundërtën e asaj që shprehën shqiptarët sepse ata kryesisht aspak nuk pajtohen dhe pjesërisht nuk pajtohen se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale, sepse ata nuk besonin se partia në pushtet ka ndikuar në relaksim e faktorë të tillë dhe se gjendja është e njëjtë si më parë. Por gjithmonë duhet pasur parasysh faktin se sa u përket maqedonasve në Maqedoninë e Veriut problemet ndëretnike janë vetëm shpifje e „nacionalizmit“, shqiptarë.

Grafikoni 30. Struktura etnike etnike & Kriza gjithëpërfshirëse, zgjedhjet parlamentare 2016 si dhe ndërtimi i kapaciteteve demokratike për integrim në strukturat euro-atlantike

✚ Përkatësia etnike

✚ A mendoni se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ndikuan në tejkalimin e krizës gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtimin e RM-së për në BE dhe në strukturat e NATO-s ?




I njëjti reagim kontravers mes dy etniteteve më të mëdha ndodh edhe me pyetjen se a mendoni se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ndikuan në tejkalimin e krizës gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtimin e RMV për në BE dhe në strukturat e NATO-s ku shqiptarët shprehen pozitivisht sepse ato kryesisht pajtohen dhe pjesërisht pajtohen. Ndërsa maqedonasit shprehën qëndrim të kundërt kryesisht duke mos u pajtuar aspak si dhe pjesërisht duke mos u pajtuar në lidhje me këtë çështje.

Merret si një përgjigje jo vetëm pozitive nga ana e shqiptarëve por edhe si shenjë optimizmi dhe një reflektimi mbi këto zgjedhje sepse kriza e cila ishte permanente ndër vite me qeverinë e kaluar tani më nuk do thellohej por do të merreshin hapa konkret nga qeveria e ardhshme për reformat që vendi ishte i kushtëzuar që ti bëj në vend dhe marrëveshjet me vendet fqinje për nxjerrjen e vendit nga kriza gjithëpërfshirëse.

Qeveri të cilën dhe faktori ndërkombëtarë dhe vendorë e pagëzoi si qeveri “*Reformatore*.”

Grafikoni 31. Kriza politike në vigjilje të vitit 2016 dhe fillimi i reformave demokratike & Ndikimi i zgjedhjeve parlamentare 2016 në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend

- ✚ A pajtoheni se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend?
- ✚ A mendoni se kriza politike në vigjilje të zgjedhjeve të vitit 2016 qe një nxitëse për fillimin e reformave demokratike në Republikën e Maqedonisë?




Sa i përket rezultateve të përgjithshme të pyetjes se; A mendoni se kriza politike në vigjilje të zgjedhjeve të vitit 2016 qe një nxitëse për fillimin e reformave demokratike në Republikën e Maqedonisë së Veriut 40.3% e të anketuarve shprehen me po, dhe 30.8% pjesërisht. Ndërsa sa i përket pyetjes së radhës se; A pajtoheni se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend, 26.9 % e të anketuarve shprehin mendimin e tyre me po, dhe 34.1% zgjedhën optionin pjesërisht. Që domethënë se në përgjithësi qytetarët mendojnë se kriza politike para zgjedhjeve përkatëse qe një nxitëse sa i përket fillimit reformave si dhe ato po ashtu kontribuan në relaksim e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend, ndërsa sa i përket mendimeve si aspak nuk pajtohem dhe nuk pajtohem kryesisht sipas analizave të bëra më lartë me përkatësinë etnike na del se përkatësia maqedonase është më pesimiste në këtë aspekt për mos thënë se ato kanë mendim krejtësisht të kundërt në krahasim me shqiptarët.

Grafikoni 32. Struktura etnike & Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë si zgjidhje e vetme e mundshme.

✚ Përkatësia etnike

✚ A pajtoheni se nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë, është zgjedhje e vetme e mundshme për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë si në planin socio-ekonomik ashtu edhe në planin politik?



Përderisa shqiptarët shprehen mjaft optimist duke u pajtuar plotësisht me këtë mundësi si zgjidhje e vetme për rrugëtim të vendit drejt strukturave euro-atlantike pala etnike maqedonase paraqet një përqindje të kundërt duke u shprehur se aspak nuk pajtohen kundrejt kësaj marrëveshje. Mirëpo kemi parasysh gjithashtu se rezultati me siguri se do të ndryshonte sa i përket maqedonasve nëse anketa do të ishte zhvilluar dhe do kishte përfshirë tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sepse jo të gjithë maqedonasit kanë një mendim të tillë dhe se jo të gjithë janë kundër integriteteve apo kompromiseve për rrugëtim të Maqedonisë Veriore në strukturat e BE-së dhe Natos.

5.3 Përfundime dhe rekomandime

1. Shiquar në përgjithësi hulumtimi i bërë i ka vërtetuar në përqindje të pëlqyeshme hipotezat e parashtruara. Sa i përket pjesës empirike do të kishte qenë më e plotë sikurse analiza kuantitative të kishte pasur një shtrirje më të gjerë gjeografike dhe të ishte plotësuar edhe me një analizë kualitative.
2. Pluralizmi politik në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej fillimi nuk u kuptua si luftë programesh as në kuptimin ideologjik e aq më pak në kuptimin ndëretnik.
3. Elitat politiko-partiake në përgjithësi shiquar më shumë kanë mbajtur llogari për perspektivat e tyre se sa për një zhvillim të qëndrueshëm të shtetit.
4. Partitë politike në RMV fort pak kanë mbajtur llogari për emancipimin e qytetarëve, në këtë drejtim kanë avancuar partitë shqiptare.
5. Partitë politike nuk kanë qenë të interesuara për ndërtimin e kapaciteteve demokratike dhe funksionimin e mirëfilltë të institucioneve të sistemit.
6. Partitë politike më shumë e kanë përhapur gjuhën e urrejtjes se sa të bashkëpunimit si në rrafshin ideologjik ashtu dhe në rrafshin ndëretnik.
7. Zgjedhjet në princip janë kuptuar si garë „gladiatorësh,, e jo si luftë programesh.
8. Zgjedhjet janë ndjekur nga një sërë aktivitete antidemokratike, vjedhje e votave, blerje e votave, nxitje urrejtje, kërcënime të votuesve etj.
9. Në rrafshin ndërkombëtarë shumë pak është mbajtur llogari për inkuadrim të vendit në strukturat euro-atlantike edhe pse nuk kanë munguar deklaratat përplot me demagogji se NATO dhe BE janë opsion i vetëm për shtetin.

10. Pas vitit 2006 filluan të zhvillohen ambicie të ndërtimit me çdo kusht të partive dominante.
11. Partitë politike filluan ta ndërtojnë konceptin jodemokratik „fituesi me fituesin,, që garantonte monopol por jo edhe zhvillim demokratik të vendit.
12. Partitë e minoriteteve e humbën kuptimin politik duke krijuar koalicione parazgjedhore me dy partitë më të mëdha të bllokut maqedonas.
13. Demokratizimi i shtetit u fut thellë nën kthetrat e partiokracisë. Shtetin e së drejtës e zëvendësonte „shteti i partive të koalicionit qeveritar,,.
14. Sektori civil u shëndërrua në „bisht,, të partive politike në pushtet, më saktë partive që e bënë pushtetin ekzekutiv.
15. Njëra nga shtyllat kryesore të pushtetit, pushteti gjyqësor ra nën hijen e plotë të pushtetit ekzekutiv dhe si i tillë nuk mundte të reflekton drejtësi as për institucionet e as për qytetarët e rëndomtë.
16. Prej vendosjes së sistemit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura deputetët si të zgjedhur të popullit u shndërruan në vegël të partive politike.
17. Kriza e rëndë politike dhe ekonomiko-sociale „tentohej,, të tejkalohet përmes zgjedhjeve të parakohshme dhe zgjedhjeve të jashtëzakonshme.
18. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 në të njëjtën kohë për shtetin dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqisnin shpresë dhe sfidë.
19. Punimi nxori në pah edhe dobësi tjera të funksionimit të sistemit politik. E nxori në pah domosdoshmërinë e ndryshimeve në kodin zgjedhor.

20. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut më shumë e preferojnë një sistem zgjedhor me lista të hapura.
21. Qytetarët preferojnë ndërprerjen e migrimit të të rinjve drejt vendeve të Evropës Perëndimore, sidomos kuadrove me shkollim të lartë.
22. Qytetarët preferojnë inkuadrimin me çdo kusht të vendit në NATO dhe BE, por para se gjithash ndërtimin e kapaciteteve të brendshme demokratike që është një ndër kushtet kryesore për integrim euro-atlantik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

5.4 Literatura

- Aziri, E. (2015). *Partitë Politike Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore*. Tetovë: SEEU.
- Aziri, E. (2004). *Partitë politike dhe demokracia*. Shkup: Logos A.
- Aziri, E. (2007). *Sociologjia*. Tetovë: Arbëria Design.
- Agani, F. (2002). *Demokracia, Kombi, Vetëvendosja*. Prishtinë: Dugagjini.
- Aziri, E. (2004). *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*. Shkup: Logos A.
- Aziri, E. (2008). *Shpirti i konsensusit dhe integrimi në një shoqëri multietnike*. “Ndarja e pushtetit dhe zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”, Shkup: Friedrich-Ebert-Stiftung.
- Aziri, E. (2004). *Sociologjia e Partive Politike*. Tetovë: Arbëria Design.
- Aleksis Dw Tokvild, (1998) *Mbi demokracinë në Amerikë*. Fryma. Pejë: Dugagjini.
- Ademi, Gj. (2019). *Zgjedhjet dhe apatia politike në Republikën e Maqedonisë*. Përmbledhje kumtesash të konferencës së katërt shkencore të FShSHB, Fillet e pluralizmit Politik në Maqedoni dhe Post – Komunizmi. Shkup: SEEU.
- Agushi, M. (2017). *Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën E Shqipërisë - Analizë Krahësuese*. Disertacion Doktorature i pa publikuar, SEEU, Tetovë.
- Bufi, Y. (2010). *Tempulli i demokracisë*. Tiranë: Ombra gvg.
- Bajrami, A. (2010). *Parlamentarizimi*. Prishtinë: Kolegji Fama.
- Bajrami, A. (2005). *Demokracia parlamentare*. Prishtinë: botimi i katërt.
- Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Raporti tre mujor, Maj, 2016.
- Billanxhiq, D. (1987). *Kthesat historike në zhvillimin e Jugosllavisë*. Prishtinë.
- Cipelius, R. (2012). *Teoria e përgjithshme për shtetin*. Shkup: Ars Lamania.
- СЛОБОДНИ ИЗБОРИ: УСЛОВ ЗА КОЈ НЕ СЕ ПРЕГОВАРА, ЦИВИЛ - Центар за слобода, Скопје, 2016.
- Emurllai, E. (2019). *Fillet e pluralizmit në Ish Shtetet Socialiste të Evropës – Rasti i Maqedonisë*. Përmbledhje kumtesash të konferencës së katërt shkencore të FShSHB, Fillet e pluralizmit Politik në Maqedoni dhe Post – Komunizmi. Shkup: SEEU.
- Fromm, E. (2012). *Shoqëria e shëndoshë*. Tiranë: Fan Noli.

- Fuga, A. (2003). *Republika e Dhjetë*. Tiranë: Panorama.
- Giddens, A. (1997). *Sociologjia*. Tiranë: Çabej.
- Heywood, A. (2008). *Politika*. Prishtinë: Brezi '81.
- IAN MECLAIN. (2010). *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press, Tiranë: Shtëpia e librit dhe komunikimit.
- Jashari, H. (2010). *Ese të filozofisë politike*. Tetovë: Arbëria Design.
- Jean-Marie Denquin. *Hyrje në Shkencat Politike*. Tiranë: UET Press.
- Kval-Mellbye-Tarnoy. (2006). *Politika dhe Demokracia*. Tiranë, Onufri.
- Kasapoviq, M. (1997). *Demokratska tranzicija i politicke stranke*. Vol. 34 No. 5.
- Krasniqi, E. (2008). (MBI) *Pushteti i Partive*. Tiranë: Gjergj Fishta.
- Latifi, V. (2009). *Konceptet e demokracisë*. Shkup: Academic press.
- Latifi, V. (2007). *Teoritë e shkencave politike*. Shkup: Academic press.
- Latifi V. (2008). *Politikologjia*. Shkup: Academic press.
- Linkoln, (1996). *Presidentët amerikan*. Tiranë: Botimi shqip.
- Lee, Cameron. McDonald. (2006). *Teoria Politike Perëndimore*. Tiranë: Ideart.
- MECLAIN, I. (2010). *Fjalor përmbledhës i politikës*. Oxford University Press. Tiranë: Shtëpia e librit dhe komunikimit.
- Митреска, А. Султанија Бојчева-Терзијан & Тања Јакимова (2017). *Ефектите од политичката криза во 2016 година врз домашната економија*. НБРМ.
- Mircev, D. *Ndërmarrjet Participizimi dhe Elitizimi* (Universiteti Fon) "Instituti për demokraci dhe Zhvillim", Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja Politike në Maqedoni, (Skena Politike e Maqedonisë 1990-2010).
- Neziri, Xh. (2017). *Kohët e eklipseve*. Tetovë.
- Pajaziti, A. (2009). *Fjalor i Sociologjisë*. Tetovë: Logos A.
- Pango, Y. (2000). *Pakti i Stabilitetit*. Tiranë: ISHSN.
- Qosja, R. (1997). *Fjalor Demokratik*. Tiranë: Tonea.
- Rapi, Gj. (1997). *Sociologjia*. Prishtinë.
- Sartori, G. (2006). *Edhe një herë për teorinë e demokracisë*. Tiranë: Dituria.
- Sartori, G. (1998). *Ç'është demokracia*. Tiranë: Dituria.

- Stiven, Boueres "Революцијаво Источна Европа" Programi i tretë i Radios së Maqedonisë. nr 47-48.
- Saliaj, O. (2014). *Ndikimi i Zgjedhjeve dhe Sistemi Zgjedhor në Demokratizimin e Sistemit Politik të Republikës së Shqipërisë*. Tetovë: SEEU.
- Veljanova, H. (2016). *Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016*. Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis".
- Xhaferi, A. (2017). *Kombi, Identiteti, Shteti*. Pejë:Dugagjini.
- ZGJEDHJE TË LIRA: KUSHT PËR TË CILIN NUK KA NEGOCIATA, Botues:CIVIL, Shkup, korrik 2016.
- Bajrami, A. *E drejta kushtetuese – II*, f. 1, Marrë nga: <http://valonhasani.do.am/EdrejtakushtetueseII.pdf>
- Petričušić, A. (2013) *Democracy without Citizens: Inadequate Consolidation in Two Decades of the Western Balkans Democracy*, Croatia: University of Zagreb. Marrë nga: https://bib.irb.hr/datoteka/645738.EQPAM-Antonija_Petricusic-Vol2No4October2013CCR.pdf
- Hasani, V. *Sistemi i zgjedhjeve*, Marrë nga: http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/910210014/Article-SISTEMI-I-ZGJEDHJEVE-nga-Valon-R-Hasani-.aspx
- Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet presidenciale 2014, Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>
- Komisioni shtetëror zgjedhor. Marrë nga: <http://www.sec.mk/izbori-arhiva/>
- Kriza politike paralizon ekonomin. Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/kriza-politike-paralizon-ekonomin%C3%AB-e-maqedonis%C3%AB/a-18465882>
- A mundet kriza politike të jetë një mundesi për tejkalimin e ndarjeve etnike në Maqedoni. Marrë nga: <https://portalb.mk/269344-a-mundet-kriza-politike-te-jete-nje-mundesi-per-tejkalimin-e-ndarjeve-etnike-ne-maqedoni/>
- Marrë nga: http://epi.org.mk/docs/EPI_InfoMaterijali_Nov2017_ALB.pdf

- Marrë nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf
- Marrëveshja e Përzhinos, episodi i tretë, plani ambicioz për zgjedhje të drejta dhe kredibile. Marrë nga: <http://vertetmates.mk/marreveshja-e-perzhinos-epizodi-i-trete-plani-ambicioz-per-zgjedhje-te-drejta-dhe-kredibile/>
- Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet presidenciale 2014. Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>
- Komisioni shtetëror zgjedhor. Marrë nga: <http://www.sec.mk/izbori-arhiva/>
- Zgjedhjet Presidenciale 2019. Marrë nga: <https://rezultati.sec.mk/mk-MK/1/r>
- Botimi i dytë i plotësuar. *Manual për zgjedhjet presidenciale 2019 në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Fondacioni Konrad Adenauer Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup. Marrë nga: http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Belegexemplar_2019_The_Public_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf
- <http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/>
- Raporti përfundimtar: THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS 11 December 2016 OSCE/ODIHR Election Observation Mission Final Report. Marrë nga: <https://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/302136?doenload=true>
- OSBE/ODIHR: *Zgjedhjet në Maqedoni të administruara dhe pa incidente të mëdha*. Marrë nga: <https://www.evropaelire.org/a/28171943.html>
- Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë RAPORTI I PËRKOHSHËM 31 mars – 19 prill 2016 22 prill 2016. Marrë nga: <https://www.osce.org/sq/odihr/elections/fyrom/235706?doenload=true>
- *Zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë*, Publikuar nga Instituti Parlamentar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 11 Tetor 10, 1000 Shkup Përgatitur nga Njësia për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar, nëntor 2014. Marrë nga: <https://www.sobranie.mk/content/Парламентаре>

5.5 Shtojcë

Pyetësor

“Ndikimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 në ndërtimin e kapaciteteve demokratike në Republikën e Maqedonisë”

Të nderuar qytetarë,

Ky hulumtim realizohet për arsye shkencore dhe informacionet e marra do të jenë anonime
Ju faleminderit paraprakisht!

1. Mosha

a) 18 – 29 b) 30 – 45 c) 34 – 41 d) 46-59 e) 60 e më shumë

2. Gjinia

a) Mashkull b) Femër

3. Vendbanimi

a) Fshat b) Qytet

4. Përkatësia Etnike

a) Shqiptar b) Maqedonas c) Turk d) Tjetër_____

5. Niveli arsimor

a) Fillor b) Mesëm c) Deridiplomik d) Postdiplomik

6. Statusi social

a) I punësuar b) I papunësuar

7. A mund të bëni dallimin në mes demokracisë dhe demokracisë partiake si nocione?

a) Po c) Jo d) Nuk kam qëndrim

8. A mendoni se demokracia si nocion në rrethanat bashkëkohore e ka humbur kuptimin?

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo d) Nuk kam qëndrim

9. A pajtoheni se demokracia pluraliste nënkupton zhvillimin e kapaciteteve demokratike të një vendi?

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo d) Nuk kam qëndrim

10. Republika e Maqedonisë ka hapëruar në kuptimin e demokratizimit me vendet tjera në tranzicion?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem
c) Pjesërisht nuk pajtohem d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam qëndrim

11. Zgjedhjet janë komponentë e rëndësishme për zhvillimin demokratik të një vendi?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem
c) Pjesërisht nuk pajtohem d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam qëndrim

12. A mund të identifikohen zgjedhjet me demokracinë?

- a) Po b) Jo c) Nuk kam qëndrim

13. A mendoni se ekziston një diskrepancë e theksuar sa u përket zgjedhjeve në shoqëritë me demokraci të zhvilluar dhe zgjedhjeve me demokraci të vendeve në tranzicion?

- a) Po b) Jo c) Nuk kam qëndrim

14. A ka shënuar një progres në kuptimin e zgjedhjeve Republika e Maqedonisë ndër vite?

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo d) Nuk kam qëndrim

15. A mendoni se Republika e Maqedonisë duhet ta ndryshon modelin zgjedhor?

- a) Po b) Jo c) Nuk kam qëndrim

16. A pajtoheni se modeli proporcional me lista të hapura me një njësi zgjedhore do të ishte më i favorshëm për qytetarët e Republikës së Maqedonisë?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem c) Pjesërisht nuk pajtohem
d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam qëndrim

17. A mendoni se kriza politike në vigjilje të zgjedhjeve të vitit 2016 qe një nxitëse për fillimin e reformave demokratike në Republikën e Maqedonisë.

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo d) Nuk kam qëndrim

18. A pajtoheni se zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kontribuan në relaksimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërkonfesionale në vend?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem c) Pjesërisht nuk pajtohem
d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam qëndrim

19. A mendoni se zgjedhjet parlamentare 2016 ndikuan në tejkalimin e krizës gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e kapaciteteve për rrugëtim të RM në BE dhe në strukturat e NATO-s?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem
c) Pjesërisht nuk pajtohem d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam qëndrim

20. A pajtoheni se nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë, është zgjedhje e vetme e mundshme për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë si në planin socio-ekonomik ashtu edhe në planin politik?

- a) Pajtohem b) Pjesërisht pajtohem
c) Pjesërisht nuk pajtohem d) Aspak nuk pajtohem e) Nuk kam

Partitë politike

VMRO-DPMNE- VMRO Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas

GROM – Opsioni Qytetar për Maqedoni

LSDM- Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

DOM – Rimëkëmbja Demokratike e Maqedonisë

BDI- Bashkimi Demokratik për Integrim

LS- Lidhja Demokratike

PDSH – Partia Demokratike Shqiptare

PSDR – Partia Socialdemokrate e Re

PLD - Partia Liberal Demokratike

PL- Partia Liberale

PSM – Partia Socialiste e Maqedonisë

PDM – Partia Demokratike e Maqedonisë

PAE – Partia për Ardhmëri Evropiane

LDB – Liga Demokratike e Boshnjakëve

PPD – Partia për Prosperitet Demokratik

PADM– Partia për Aksion Demokratik e Maqedonisë

RDK – Rilindja Demokratike Kombëtare

PDTM – Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë

AD – Alternativa Demokratike

PDSM- Partia Demokratike e Serbëve të Maqedonisë

PURM – Partia e Unitetit të Romëve të Maqedonisë

PEPR – Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve

PSDM – Partia Socialdemokrate e Maqedonisë

PAD – Partia për Aksion Demokratik

VMRO-PP –VMRO Partia Popullore

LB- Lëvizja Besa

ASH- Aleanca për Shqiptarët

Uniteti